

**APLIKIMI I METODOLOGJIVE BASHKËKOHORE TË
MËSIMDHËNIES SË GJUHËS SHQIPE NË NIVELIN
PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË
(Rast studimi-Arsimi i Mesëm i Ulët në Komunën e Gjakovës)**

Afërdita Nimani

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
(Shkenca Sociale), me profil (Pedagogji), për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor:
Numri i fjalëve: 51600
Tiranë, Janar, 2021

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim, është shkruar nga unë dhe nuk është prezantuar asnjëherë askund, dhe as para ndonjë institucioni të vlefshëm. Po ashtu, ky punim nuk është botuar as si i fragmentuar, dhe as si i tërë. Ky punim, pasqyron vetëm autorësinë time origjinale, kurse referencat janë të cituara.

ABSTRAKT

Lënda e Gjuhës shqipe aktualisht është ndër lëndët më të rëndësishme në sistemin parauniversitar në Kosovë. Prandaj është me rëndësi studimi i metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies.

Ekzistojnë një sërë metodologjish në procesin e mësimdhënies së gjuhës shqipe, por mbetet të hulumtohet më tepër për nivelin e zbatimit të tyre dhe mënyrën se cilat nga këto metodologji rezultojnë të jenë më efikase.

Kompleksi i mësimdhënies nuk parakupton vetëm përdorimin e metodologjive, por është shumë e rëndësishme të shohim se sa ata janë pjesë e procesit të mësimdhënies. Në shtjellimin e mëtejshëm, është me rëndësi të shohim dhe të kuptojmë se si zbatohen metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies.

Gjuhësia, si specifike e procesit mësimor, që nga fillimi i procesit, nënkupton lëndën e Gjuhës në kuadër të lëndëve të tjera mësimore. Gjuha, s'ka dyshim, që përbën një prej elementeve bazë të mësimdhënies sepse ajo është bazike edhe përgjatë edukimit dhe arsimimit të secilit nxënës.

Duke ndjekur kriteret dhe metodat e studimit, objektivi ynë fokusohet në rolin e gjuhës si një prej kërkesave prioritare të edukimit dhe të procesit të arsimimit. Çështjet e gjuhës, kanë qenë gjithmonë preokupim i studiuesve duke qenë se gjuha kërkon vazhdimisht jo vetëm njohjen dhe studimin e saj, por edhe mbikqyrjen teorike dhe shkencore. Ajo ndjek linjat tona të zhvillimit dhe standardet e saj që vazhdimisht ndikohen nga ambienti në të cilin jetojmë. Këto standarde kanë të bëjnë me faktorë të cilët ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik, si dhe nga ndikimet dhe “sulmet” që vijnë nga gjuhët e tjera.

Lënda e gjuhës shqipe, si asnjë lëndë tjetër, ndikohet sot nga procese të shumta dhe ndikime të terminologjisë politike, ekonomike dhe sidomos të teknologjisë informative. Format e ndikimit të rrjetit social, si dhe të faktorëve të tjerë informativë dhe medialë shkaktajnë detyrime në mënyrë që metodologjitë e mësimdhënies në këtë lëndë të jenë sa më të përshtatshme me nevojat ambientale, por edhe me hapësirat globale. Në kontekst, kërkohet qasje e vazhdueshme në planprograme (sillabusëve).

Natyrisht, parësore ka qenë dhe mbetet forcimi i metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies, kundrejt aplikimit me sukses të çdo lënde, me theks të veçantë atë të gjuhës shqipe.

Ky punim shkencor kërkon studim dhe hulumtim mbi këto pyetje kërkimore:

- *Cilat metodologji bashkëkohore aplikohen gjatë procesit mësimor në lëndën e gjuhës shqipe?*
- *Sa zbatohen metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies në mësimin e lëndës së gjuhës shqipe?*
- *A ndikojnë metodologjitë e mësimdhënies të përdorura në mësimin e gjuhës shqipe në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies?*

Theksojmë që fokusi i punimit janë shkollat e arsimit të mesëm të ulët në komunën e Gjakovës, ndërsa konkluzionet dhe përfundimet përfshijnë gjendjen dhe disa aspekte të mësimdhënies në Kosovë.

Fjalë kyçe: Gjuha shqipe, metodologji, arsimit të mesëm i ulët, niveli i përdorimit, metodologji bashkëkohore, vështirësi.

FALENDERIME

Punimi im “Aplikimi i metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës shqipe në nivelin parauniversitar”, (Rast studimi-Arsimi i Mesëm i Ulët në Komunën e Gjakovës) pasqyron studimin e çështjeve thelbësore që lidhen me metodologjitë e mësimdhënies së Gjuhës shqipe. Paraprakisht, dua të konstatoj se nuk ka qenë aspak e lehtë puna dhe angazhimi për realizimin e këtij punimi, mirëpo duke pasë përvojën akademike të ligjëratarave dhe të profesorëve, dhe ndihmën e personave të tjerë relevantë, shfrytëzimin e literaturës etj., besoj kam arritur t’i vendosë idetë dhe objektivat e këtij punimi në shkallë dhe cilësi të duhur.

Në rend të parë, kam privilegjin që ta falnderoj me respekt të veçantë udhëheqësin doktoral Prof. i as Dr. Ilir Yzeiraj që më ka dhënë sugjerimet e duhura, mbështetjen e pakursyeshme, por edhe vërejtjet e nevojshme në mënyrë që ky punim studimor të arrijë qëllimin paraprak.

Falnderoj po ashtu, edhe personelin e shkollave lidhur me çështjet hulumtuese, miqtë, kolegët dhe të gjithë ata që më kanë përkrahur që unë t’ia mbaroj me sukses studimin tim.

Natyrisht, në fund falënderoj familjen për përkrahjen morale dhe materiale gjatë gjithë kohës që jam angazhuar në përfundimin e këtij punimi shkencor.

Përmbajtja

KAPITULLI I.....	11
HYRJE	11
1.1 Përkufizimi i koncepteve kyç të studimit	12
1.1.1 Koncepti i metodologjive në procesin e mësimdhënies	12
1.1.2 Koncepti i metodologjive të mësimdhënies së lëndës së Gjuhës shqipe.....	13
1.2 Prezantimi i situatës apo problemit	16
1.2.1. Sistemi i punës dhe strategjia e organizimit të mësimit të gjuhës shqipe.....	16
1.2.2. Në programe të gjuhës shqipe, Kosovë	19
1.2.3. Roli polidimensional i lëndës së gjuhës shqipe	20
1.3. Përcaktimi i variablave.....	24
1.4. Pyetjet kërkimore, hipotezat dhe objektivat	24
1.4.1. Objektivat e punimit.....	26
1.5 Struktura e punimit.....	26
1.6 Rëndësia e punimit	28
1.7 Teoritë dhe literatura bazë	30
KAPITULLI II	32
HISTORIKU I MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE	32
2.1. Fillimi i shekullit XX.....	39
2.2. Vitet 60`-70` deri vitet 2000.....	41
2.3. Pas vitit 2000	43
2.4. Abetarja, libri bazë i mësimit të gjuhës shqipe, fillimet e saj dhe Abetarja e përbashkët Shqipëri – Kosovë.....	44
2.4.1 Abetarja e përbashkët Shqipëri – Kosovë	45
2.4.2 Abetare të përdorura në shkollat shqiptare.....	47
2.5 Planet e ndryshme mësimore të përdorura në Kosovë.	50
2.5.1. Programi i gjuhës shqipe sot në Kosovë	50
2.6. Studime të huaja mbi Gjuhën Shqipe	52
Kapitulli III.....	53
SKELETI TEOTIK DHE MODELI ANALITIK I TEZËS	53
3.1 Teoritë bazë.....	53
3.2. Format didaktike të mësimit	54

3.3.	Roli i mësimdhënsit	56
3.4	Metodologjitë e mësimdhënies.....	57
3.4.1	Metodologjia e mësimdhënies e Gjuhës shqipe.....	59
3.4.2	Metodologjia e vlerësimit të nxënësit	68
3.4.3	Metodologjia e punës praktike	72
3.4.5	Metodologjitë motivuese	74
3.4.6.	Metodologjitë tradicionale dhe bashkëkohore të mësimdhënies	77
3.4.6.1.	Metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies	78
3.4.6.2	Sistemi ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe leximit efektiv	80
3.4.6.5	Realizimi – kuptimi.....	82
3.4.6.6	Diskutimi në çifte dhe në grup.....	82
3.4.6.7	Shqyrtimi kategorizues	83
3. 4. 6.8	Drita	83
3.4.6.9	DLTA (Dëgjim dhe mendimi i detajuar)	84
3.4.6.10	Pesëvargëshi	84
3.4.6.11	Mendo, puno në dyshe, thuaja grupit... ..	85
3.4.6.12	Ditari dypjesësh dhe trepjesësh.....	85
3.6	Roli dhe funksioni i metodologjive,	86
3.5.1.	Çka synohet me aplikimin e metodologjive bashkohore në procesin mësimorë ?	87
3.6	Krahasime të metodologjive të mësimdhënies	91
3.7.	Metodologjia e kërkimit	96
3.7.1	Popullata dhe kampionimi	97
3.7.2.	Instrumentet e kërkimit	102
3.7.3	Dizenjimi i pyetësorit	106
3.7.4.	Procesi i mbledhjes së të dhënave.....	107
	KAPITULLI IV	110
	TË GJETURAT DHE REZULTATET E HULUMTIMIT.....	110
4.1	Analiza sistematike e të dhënave	110
4.2	Të dhëna të përgjithshme	117
4.2.3	Përgjigjet e mësidhënësve	117
4.3	Të dhëna mbi hipotezën e parë	123
4.4	Të dhëna mbi hipotezën e dytë të studimit	127
4.5	Të dhëna në funksion të hipotezës së tretë të studimit.....	134

4.6 Të dhënat nga intervistat e zhvilluara me drejtues shkollash në komunën e Gjakovës	144
4.7 Përgjigje nga fokus grupi	155
KAPITULLI V	157
DISKUTIME.....	157
5.1 Diskutimi i të dhënave mbi hipotezën e parë të studimit tonë	157
5.2. Diskutimi i të dhënave mbi hipotezën e dytë të studimit.....	163
5.3 Diskutimi mbi të dhënat në funksion të vërtetimit të hipotezës së tretë	167
5.4. Diskutim mbi të dhënat e intervistave me drejtues shkollash.....	168
KAPITULLI VI.....	170
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	170
6.1 Konkluzione	170
6.2 Rekomandime.....	174
SHTOJCA	181
Shtojca A. Pyetësi për mësimdhënës	181
Shtojca B: Formati (transkripti) i intervistave të zhvilluara me drejtorin, pedagogun dhe psikologun.....	188
Shtojca C: Çështje për diskutim.....	189
Shtojca D: Marrëveshje mirëkuptimi me drejtorët e shkollave.....	190
REFERENCAT	195

Lista e tabelave dhe figurave

Lista e tabelava

Tabela 1. Abetaret e shkollave shtetërore shqiptare

Tabela 2. Abetare të përdororë në Kosovë, në periudha të ndryshme

Tabela 3. Abetaret që përdoren në diasporën shqiptare

Tabela 4. Numri i shkollave të AMU dhe mësimdhënësve të Gjuhës shqipe sipas gjinisë në Gjakovë

Tabela 5. Të dhënat sipas Gjinisë

Tabela 6. Të dhënat mbi përvojnën e mësimdhënësve

Tabela 7. Numri i nxënësve në Arsimin e Mesëm të Ulët në komunën e Gjakovës sipas klasave dhe gjinisë

Tabela 8. Të dhëna përmbledhëse mbi frekuencën e trajnimit të mësimdhënësve

Lista e figurave

Figura 1. Planet mësimore të ndryshme mbi lëndën e Gjuhës shqipe

Fig. 2 Faksimile të Abetares së Matija Logorecit.

Fig. 3 Koncepti strukturorë teorik dhe praktikë i metodologjisë së mësimdhënies

Figura 4: Shumëllojshmëria e modaliteteve të mësimdhënies: “Dimension of Teaching and Learning Branch”

Figura 5. Forme testi në lëndën e Gjuhës shqipe

Fig. 6 Skemë lidhur me mësimdhënien ndërvepruese

Figura 7. Skemë analize në lëndën e Gjuhës shqipe

Figura 8. Të dhëna mbi gjininë e mësimdhënësve në zonat urbane

Figura 9. Të dhëna mbi gjinia e mësimdhënësve në zonat rurale

Figura 10. Niveli i përgatitjes së mësimdhënësve

Figura 11. Frekuenca e trajnime të mësimdhënësve në komunën e Gjakovës

Figura 12. Mbi njohuritë e mësimdhënësve mbi metodologjitë

Figura 13. Të dhëna nga mësime dhënë mbi nivelin e përdorimit të disa prej metodologjive adekuate në orën e mësimit.

Figura 14. Të dhëna nga nxënësit mbi nivelin e përdorimit të disa prej metodologjive adekuate në orën e mësimit.

Figura 15. Të dhëna nga mësime dhënë mbi përdorimin e mjeteve mësimore

Figura 16. Të dhëna nga nxënësit mbi përdorimin e mjeteve mësimore

Figura 17. Të dhëna nga mësime dhënë dhe nxënësit mbi përdorimin e punës me grupe dhe punës praktike gjatë procesit mësimor

Figura 18. Të dhëna mbi shkallën e aplikimit të metodologjive nga mësime dhënë

Figura 19. Përdorimi i metodologjive të mësime dhënë në krahasim me lëndët e tjera

Figura 20. Përgjigjet e mësime dhënëve mbi pyetjen: “ Sa janë motivuese metodologjitë e mësime dhënë?”

Figura 21. Të dhëna nga mësime dhënë mbi format e vlerësimit

Figura 22. Të dhëna nga nxënësit mbi format e vlerësimit

Figura 23. Përgjigjet e mësime dhënëve mbi pyetjen: Kush duhet të jetë në qendër, mësuesi apo nxënësi ?“

Figura 24. Të dhëna nga mësime dhënë mbi pyetjen: ”A është në përputhje me procesin bashkëkohor të zhvillimit shkalla e vlerësimit të nxënësit?”

Figura 25. Të dhëna mbi interesimin e nxënësit në orën e mësimit të Gjuhës

shqipe Figura 26. Faktorët që shkaktojnë pengesa në procesin e mësimit

Figura 27. Të dhënat nga mësime dhënë mbi nevojën e aplikimit të metodologjive

Figura 28. Të dhëna nga mësime dhënë mbi nevojën e funksionalizimit të lëndës së Gjuhës shqipe

KAPITULLI I

HYRJJE

Procesi i zhvillimit të arsimit është një nga shtyllat më themelore të zhvillimit shoqëror dhe kombëtar, i cili përbën vlerat serioze të edukimit dhe emancipimit. Ky proces nuk ka të ndalur, duke qenë se zhvillohet krahas nevojave dhe ndryshimeve që shprehen në sfera të tjera, të tilla që ndikojnë në këtë proces. Reforma arsimore asnjëherë nuk konsiderohet e përfunduar. Brenda procesit mësimor kërkohen metodologji të ndryshme në mënyrë të tillë që ndihmojnë në zhvillimin e këtij procesi.

Kompleksi i mësimdhënies nuk ka të bëjë vetëm me aplikimin e metodologjive, por edhe me përzgjedhjen e tyre në funksion të specifikave të procesit mësimor.

Gjuha shqipe, në çdo nivel që përdoret, është lëndë bazike e edukimit dhe e procesit të arsimit. Çështja e gjuhës sot, si edhe në të kaluarën, ka qenë vazhdimisht preokupim i studiuesve sepse gjuha kërkon jo vetëm nxënien dhe studimin e saj, por edhe mbikqyrjen, përkujdesen, trajtimin shkencor etj. Gjuha, në përgjithësi, zhvillohet sipas standardeve të përcaktuara teorike dhe shkencore. Mirëpo, ajo ndikohet vazhdimisht nga ambienti në të cilin jetojmë. Pikë së pari nga niveli i zhvillimit ekonomik dhe teknologjik, nga ndikimi i kulturave dhe dhe i sistemit ekonomik, si dhe nga ndikimi i gjuhëve që janë mbizotëruese në përmasa ndërkombëtare, si psh., gjuha e anglishtes.

Objektivi ynë tematiko-studimor, na shtyn që t'i qasemi me përkushtim metodologjisë së mësimdhënies; qoftë për rolin që ajo ka, po ashtu, edhe për mënyrën e zbatimit, për shkallën dhe cilësinë e zbatimit, për rezultatet që mundëson etj.

Bazuar në rëndësinë dhe shkallën tonë përkushtuese kundrejt këtij studimi, objekti i trajtimit të metodologjisë së mësimdhënies së lëndës së gjuhës shqipe në teori dhe praktikë duhet të evidentohen me kujdes të gjitha ato çështjet metodologjike të mësimdhënies që e bëjnë procesin mësimor të suksesshëm dhe me perspektivë. Në anën tjetër, është e rëndësishme, gjithashtu, që të evidentohen edhe çështjet që janë penguese dhe të dëmshme, ato çështje që shfaqen si dobësi e theksuar e procesit të mësimdhënies së gjuhës shqipe. Thënë ndryshe cilat janë vështirësitë në aplikimin e metodologjive efikase në procesin mësimor.

Në këtë mënyrë, i gjithë studimi ngrihet mbi nivelin e aplikimit të metodologjive të mësimdhënies, llojin e metodologjive që përdoret si dhe në evidentimin e vështirësive të hasura gjatë këtij procesi.

Gjithashtu mundësohet edhe një krahasim mes metodologjive bashkëhore dhe tradicionale, si një përpjekje për gjetjen e metodologjive më të suksesshme.

1.1 Përkufizimi i koncepteve kyç të studimit

1.1.1 Koncepti i metodologjive në procesin e mësimdhënies

Pikë së pari është me rëndësi të përkufizojmë termimin *Metodologji*. Referuar përkufizimeve në fjalor fjala Metodologji – do të thotë një sistem metodash të përdorura në një fushë të caktuar studimi apo veprimi.

Kështu, kur themi metodologji e mësimdhënies së gjuhës shqipe, i referohemi metodave apo aktiviteteve që përdoren apo kryhen në procesin e mësimdhënies, në mënyrë që të arrihen rezultate maksimale.

Nga ana tjetër, mësimdhënia si proces kompleks, është një raport marrëdhëniesh shumë dimensionale fillimisht mes pedagogëve apo mësimdhënësve dhe nxënësve, më pas mes shumë dimensionesh ndërmjet nxënësve, mësuesve, prindërve, administratës së shkollës, komunitetit, institucioneve arsimore etj. Procesi i mësimdhënies, kërkon një numër veprimesh profesionale, aftësi dhe sjellje të qëndrueshme mes mësuesit dhe nxënësit; cilësi në zbatimin e planeve mësimore, të mësimin etj. Përveç faktit se mësuesi duhet të jetë profesionalisht i përgatitur dhe kompetent lidhur me lëndën e tij, ai duhet t'i ketë të qartë objektivat që dëshiron t'i arrijë sepse, “*sa më të qartë që t'i kesh objektivat që synon të i arrish, aq më lehtë do të gjesh dhe zbatosh mënyrat dhe format e të nxënit produktiv për secilin individ dhe rast*” (Grup autorësh, 1996, f. 6).

Në procesin e mësimdhënies së gjuhës shqipe, dallohen tre nivele të procesit të mësimdhënies si proces:

1. *Niveli i mësimimit teorik shkencor i mësimdhënies*
2. *Niveli profesional i zbatimit të njohurive teorike (hartimi i projekteve, planeve, programeve, i udhëzime metodike, i tekste dhe mjete mësimore),*
3. *Niveli i mësimimit të praktikave apo metodologjive*

Niveli i parë mund të quhet nivel didaktik, ndërsa niveli i dytë dhe i tretë mund të quhet metodike (mësimdhënie). (Gjoshi, 1998)

Institucionet e larta shtetërore të arsimit, në rend të parë mësimdhënësit, sipas planeve shtetërore, janë të detyruar që në organet e shkollës (drejtoritë), t'i dorëzojnë planet vjetore, mujore, javore dhe ditore (Plankonspekti) në kontekst të zhvillimit të procesit mësimor (PO aty, 66). Nuk ka dyshim që mësimdhënia, veç fokusimit të saj si shprehje e efikasitetit në mësim, ajo kushëzohet edhe nga shkencat e ndryshme, si: historia, filozofia, didaktika, psikologjia, gjuhësia, sociologjia, pedagogjia, por edhe sferat e tjera kulturore, si edhe puna praktike.

1.1.2 Koncepti i metodologjive të mësimdhënies së lëndës së Gjuhës shqipe

Praktika e mësimdhënies nënkupton jo vetëm përdorimin e mjeteve të ndryshme, por edhe shkathtësitë e ndryshme të mësimdhënësit, aplikimin e metodologjive që ndikojnë në arritjet dhe nxëniet e mësimimit nga nxënësit, përvojen etj. Kur është fjala për përvojen e mësimdhënësit, secili mësues me me përvojë më të gjatë në procesin mësimor, e vlerëson më shumë rolin e një lënde, me këtë rast, rolin e gjuhës në procesin edukativ krahasuar me mësimdhënësit me përvojë më të shkurtër në procesin mësimor.

Çdo orë mësimi ka qëllimet dhe objektivat e caktuara mësimore. Secila orë e mësimimit kërkohet që të përgatitet dhe të zhvillohet në përputhje me planprogramin shkollor në përgjithësi, dhe në përputhje me përgatitjen e lëndës mësimore në veçanti. Në kontekstin tonë hulumtues dhe studiues, edhe lënda e gjuhës shqipe fokusohet në korniza të një strukture substanciale të mësimdhënies: si “vëllim” i përmbajtjes së gjerë që ajo ngërthen më vete!

Gjuha shqipe, bazuar në programin zyrtar shkollor përfshinë këto përmbajtje: *Të leksikologjisë, të morfologjisë, të fonetikës, të sintaksës etj.* Kurse, shtrirja e saj programore, përfshinë: *Diktimet, ushtrimet, detyra e shtëpisë etj.*

Orët mësimore, nisur nga struktura e tyre përmbajtësore, përcaktohen nga faktorë pedagogjik –metodikë. Pra, procesi i zhvillimit të planprogramit lidhur me lëndën e caktuar mësimoree kalon nëpër faza të caktuara.

Në kontekst, fazat e caktuara për çdo orë të lëndës së Gjuhës shqipe janë si me poshtë: Keto objekte i ka paraqitur edhe Ragip Gjoshi studiuese i gjuhës dhe që i referohet, studimit të Mehemt Gjevorit e ato janë: *“Kontrollimi i detyrave të shtëpisë, kontrollimi i njohurive të mëparshme, paraqitja e lëndës së re, ushtrimet përforcuese, shpjegimi i detyrave të shtëpisë“ (Gjoshi, 1998).*

Tipologjia e zhvillimit tradicional të orës së lëndës së gjuhës shqipe: - Po t’i referohemi mësimin tradicional të procesit arsimor , mësimi në lëndën e gjuhës shqipe (zakonisht, kjo lëndë njihet si “Gjuhë dhe letërsi shqipe”), në varësi të përmbajtjes së programit dhe qëllimit të orës së mësimin të kësaj lënde, janë zbatuar disa tipe të orëve për lëndën e gjuhës shqipe. Tipet substanciale të orëve të mësimin tradicional të gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Kosovë, konsistonin në paraqitjen dhe fitimin e njohurive të reja gjuhësore.

Në çdo orë mësimi duhet të trajtohen si lëndë risitë që paraqiten dhe diskutimet argumentuese nga fusha letërsisë së gjuhës shqipe apo e gjuhësisë, njohuritë gjuhësore, nocionet dhe dukuritë e gramatikore të pamësuara më parë. Ky tip ore kishte ngjashmëri me tipin e orëve të kombinuara si dhe ndihmonte nxënësit nga lënda e mësuar më parë, me njohuritë e reja në vijim të të njëjtës lëndë. Kështu, siguroheshin njohuri më të plota rreth një fakti apo rreth një dukurie gjuhësore. Ndërkaq, “kur kishte përpunim (analizë) të pjesës së leximit, si lëmi themelore pune, në të cilën bazoheshin dhe prej së cilës rridhnin edhe format e përmbajtjet e tjera të mësimin të gjuhës amnore në shkollën fillore tregohet kujdes i veçantë” (Po aty, f. 6).

Përgjatë mësimin tradicional, ekspertët pajtoheshin rreth faktit se përpunimi i tekstit letrar në shkollën fillore, ishte një prej formave themelore për studimin sistematik¹ të gjuhës. Nga këndvështrimi i mësimin të gjuhës shqipe, si edhe për çdo lëndë tjetër, kjo formë e mësimin, i shtynë nxënësit që të mendojnë me logjikë në lidhje me dukuritë dhe fenomenet gjuhësore, dhe i shtynë ata në njohuri dhe dije të suksesshme. Pra, kjo formë, i shtynë nxënësit jo vetëm në mësimin e gjuhës, por edhe në të folurit dhe në të përvetësuarit e saj të arrirë, dhe mbi bazën e standardeve të gjuhës. Në kontekst të lëndës, orët e gjuhës kalonin nëpër këto faza sipas profesorit Esat Hoxha: *1. Pjesa hyrëse (introduktive). 2. Leximi shprehës (ekspresiv). 3. Analizë ideoartistike. 4. Përfundimi. 5. Detyrat e shtëpisë.*

Përgjatë realizimit të orëve të mësimin, mësuesi gjurmonte njohuritë e nxënësve, ngarkimi i tyre me detyra të shtëpisë. Secila pjesë e orës së mësimin, përmbante karakteristikat e veta, rëndësinë e përmbajtjes së lëndës, vështirësitë, qëllimin e mësimin etj. Në traditën e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë, një tip tjetër i orës ishte shpjegimi i njohurive të reja me përsëritjen dhe me thellimin e njohurive të mësuara më parë. Nxënësit, kontrolloheshin dhe pasatj ushtroheshin më shumë se në orët kur zhvillohej në fakt, vetëm tema e re mësimore. Po ashtu, një vend të rëndësishëm zinte puna e pavarur e nxënësve dhe kontrolli rreth përvetësimit të lëndës së shpjeguar në orët e mëparshme.

Nisur nga objektivat mësimor, shpjegimi i lëndës së re mësimore ishte në fakt, një lloj themeli i gjithë punës. Por, po ashtu, zhvilloheshin edhe orë mësimi të përziera, kryesisht duke pasur si objektiv, zhvillimin e temave, si: lakimi i emrave dhe i rasave, formimi i emrave dhe i mbiemrave, gjinia e mbiemrave, lakimi i përemrave, lakimi i numërorëve, emërimi i mbiemrave dhe probleme që lidheshin me drejtshkrimin e tyre, zgjedhimin e foljeve, formimin e foljeve, llojet e shkallët e ndajfoljeve, fjalëformimi, kryefjala, kallëzuesi, fjalitë me pjesë të nënrenditura vendore, kohore, shkakore, qëllimore etj.

¹ Semantikë, A (gr. Sema – shenja; gjerm.semantik; fr.semantique; ang.semantics) – shkencë për shenjat dhe domethënien e tyre; njëra ndër tri degët e semiotikës (së bashku me sintaksën dhe pragmatikën). Brenda shkencave gjuhësore, semantika është një disiplinë , e cila merret me studimin e domethënies së fjalëve e të shprehjeve gjuhësore, përkatësisht me studimin e raportit ndërmjet fjalive dhe objekteve që emërtohen sikurse me evoluimin historik të domethënies së fjalive dhe shprehjeve gjuhësore; si disiplinë e logjikës modern, veçanërisht e logjikës matematike dhe asaj simbolike etj. Ky pershkrim dhe fjalore që përdora është autorit të njohur Ekrem Murtezai, Fjalor i Filozofisë I botuar në Prishtinë , dhe kjo problematike gjerësisht trajtohet në paqen. 416.)

Metodologjia e mësimdhënies bazohej në parapërgatitjen e nxënësve për ta kuptuar sa më qartësisht temën e re në vijim, përmes kontrollimit të dijes dhe ushtrimeve, zbërthimi i lëndës së re së bashku me kontrollimin e detyrave, ushtrimi dhe përforcimi i lëndës, puna e pavarur e përgjithëshme. Përgjatë mbajtjes së orës mësimore, përpunimi i tekstit letrar zhvillohej mbi këto mënyra: Leximi me zë të lartë, shprehimor dhe ekspresiv i tekstit; Lokalizimi i tekstit; Përmbajtja e shkurtër e tekstit – rezymeja; Plani i fragmentit që lokalizohet; Vërejtja dhe caktimi i idesë, ndjenjës kryesore; Shqyrtimi i idesë kryesore, analiza e ideve dhe personave; Analiza e formës (kompozicionit, stilit, versifikimit dhe gjuhës); Përfundimi.

1.2 Prezantimi i situatës apo problemit

1.2.1. Sistemi i punës dhe strategjia e organizimit të mësimi të gjuhës shqipe

Reformimi dhe modernizimi i vazhdueshëm i arsimit, përfshirë edhe arsimin parauniversitar paraqet bazën e forcimit të vazhdueshëm të sistemit modern arsimor, si dhe ngritjen e vazhdueshme të cilësive në mësim. Kjo ka të bëjë me sistemin shkollor në përgjithësi, që do të thotë edhe me të gjitha ciklet shkollore. Njësoj kjo vlen edhe me lëndët mësimore veç e veç, përfshirë edhe lëndën e gjuhës shqipe.

Kur jemi te kjo lëndë, themi se si një lëndë kurrikulare siç është Gjuha Shqipe përbën bazamentin e procesit të të mësuarit shqip, por jo vetëm. Ajo përbën edhe bazamentin e procesit të komunikimit dhe të ndërkomunikimit, të formësimit të identitetit social, atij kulturor, letrar, muzikor etj.

Brenda avancimit dhe modernizimit të shkollës shqipe, lënda e Gjuhës Shqipe lypset të zhvillohet dhe të avancohet sa më shumë, megjithëse mund të konstatojmë se kjo lëndë ka qenë edhe në të kaluarën një lëndë që është trajtuar me dinjitet dhe që ka pasur shumë autoritet në gjithë sistemin fillor dhe parauniversitar.

Gjuha shqipe është sintezë dhe bashkëdyzim i komunikimit dhe shkrimit, dhe bazë integruese e mësimëve dhe e diturive të tjera. Në kuptimin më të gjerë, mësimdhënia e lëndës së Gjuhës Shqipe është qëllim dhe objektiv i të mësuarit, ajo që bart thelbin e dijeve dhe

njohurive që prej mësimin të gërmave, e deri te historia e lëndës, gramatika etj. Mësimdhënia e lëndës së gjuhës shqipe, nënkupton këtë thelb të aplikimit të procesit mësimor :

1. Një proces paraveprues të marrjes së vendimeve për planifikimin, skicim dhe përgatitje të materialeve për mësim dhe nxënie, për identifikim të nevojave të nxënësve, krijim të mjedisit mësimor të duhur dhe efikas, shfrytëzim të teorisë dhe praktikës mësimore.
2. Zhvillim të procesit bashkëveprues, bashkëpunim të drejtpërdrejtë mësues-nxënës, përdorim të metodave të mësimdhënies.
3. Proces pasveprues, i cili përmbledhet në dimensionet: vlerësim, vetëvlerësim, drejtim, caktim të procedurave vlerësuese të nxënësit (notim), vlerësim të programit mësimor – të materialeve mësimore.

Programi mësimor: duke u mbështetur në faktet historike, dhe konkretisht që nga periudha austro-hungarese, kemi disa plane dhe programe mësimore, veçanërisht në Kosovë, në të kaluarën jo të largët që nuk janë zhvilluar në gjuhën shqipe. Kosova ishte nën sovranitetin e regjimeve të ndryshme, kryesisht të huaja. Prandaj, shoqërisë shqiptare i janë imponuar programe dhe sisteme arsimore jo amtare, pra në gjuhë të huaja varësisht nga gjuha që e ka përdorë pushtuesi. Kurse në Shqipëri, pas vitit 1912 kur u shpall pavarësia filloi edhe pavarësia e shkollës në gjuhën shqipe. Kosova, mbeti jashtë kufijve të natyrshëm etnik. Gjendja e nderë në Kosovë, e cila zgjati gjatë gjithë shekullit XX-të, ndikoi që sistemi arsimor shkollor të kalojë në faza po ashtu të ndera, pothuajse tragjike. Sistemi kosovarë i arsimit, është zhvilluar detyrimisht: ose në gjuhën e pushtuesve, ose i motivuar prej ndikimeve politike dhe ideologjike, dhe më rrallë në mënyrë të pavarur.

Pas themelimit të Universitetit të Prishtinës më 1970, mund të flasim për një autonomi reale të shkollës shqipe, pavarësisht se shkolla ishte nën influencën politike dhe ideologjike komuniste, si dhe nën ndikimin e sistemit jugo – sllav. Pas shkatërrimit të Jugosllavisë në vitet e 90-ta, u flakën modelet e mësimin të integruar jugo – sllav, dhe shkolla shqipe në Kosovë filloi “t’i hartojë planprogramet mësimore në mënyrë të pavarur”(Gjoshi, 2015) .

Plani mësimor shkollor është një dokument shtetëror i cili aprovohet nga organi më i lartë zyrtar i arsimit. Në bazë të këtij dokumenti, përcaktohen lëndët mësimore me fonde të caktuara javore të orëve për secilën lëndë, veç e veç.

<i>Shembulli 1: Planit mësimor sipas sistemit sintetik austriak për mësim gjuhe</i>					
Planit mësimor sipas sistemit sintetik austriak për mësim gjuhe: 1915- 1918					
Klasët:	I	II	III	IV	V
1. Gjuhë mësimi:	12	10	8	8	6
2. Gjuhë gjermane:	0	2	4	5	5
Gjithsej:	12	12	12	13	11

Burimi: Ragip Gjoshi, Mesimdhënia e Gjuhës Shqipe në Kosovë, Tiranë 2015

<i>Shembulli 2: Planit mësimor i paraparë nga Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë</i>					
Planit mësimor i paraparë nga Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë, 1941-1945					
Klasët:	I	II	III	IV	V
Gjuhë shqipe:	14	14	14	13	13
Gjithsej:	14	14	14	13	13

Burimi: Ragip Gjoshi, Mësimdhënia e Gjuhës Shqipe në Kosovë, Tiranë 2015

Shembulli 3: Plani mësimor në Kosovë për gjuhë amtare dhe për gjuhë jo amtare

Plani mësimor në Kosovë për gjuhë amtare (shqip) dhe për gjuhë jo amtare (serbo-kroate), 1962

Klasët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
1. Gjuhë amtare	2	6	6	6	6	5	4	4
2. Gjuhë serbe			3	3	4	4	4	4
Gjithsej:	61							

Burimi: Ragip Gjoshi, Mësimdhënia e Gjuhës shqipe në Kosovë, Tiranë 2015

1.2.2. Në programe të gjuhës shqipe, Kosovë

Si në çdo vend të botës edhe tek ne në Kosovë mësimi i gjuhës amtare në shkollë është obligim zyrtar dhe kombëtar njekohesisht, duke mos lene anash edhe nevojën e një vetedijeje më të lartë në të mesuarit dhe shqiptuarit drejtë dhe bukur të gjuhës. Në këtë funksion është konceptuar dhe programi i kësaj lënde për klasën e dytë: “Sikurse programi i klasës paraprake edhe ky është organizuar në kuadër të kategorive të të dëgjuarit dhe të folurit; të lexuarit; të shkruarit dhe të nënkategorive: kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, kulturë e të lexuarit dhe kulturë e të shkruarit; tekste letrare dhe joletrare si dhe njohuri gjuhësore.” Dhe më tej: mësimi i gjuhës shqipe në klasën e dytë ka për qëllim që nxënësi:

- Të aftësohet në të kuptuarit dhe mënyrat e komunikimit.

- Të njohë hollsisht njohuritë themelore të gjuhës.

- Të njohë dhe të mund të ndaje tekstet letrare nga ato joletrare.

Për klasën e gjashtë, që në Kosovë i përket arsimit të mesëm të ulët, shënohet: “Qëllimi i mësimit të gjuhës shqipe në klasën e gjashtë është përforcimi dhe zhvillimi i njohurive të përvetësuara më parë, siç janë:

- Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit në situata të ndryshme.

- Zhvillimi i kulturës gjuhësore dhe formimi kulturor.

- Zhvillimi emocional, krijues dhe estetik përmes shkathtësive të komunikimit.

- Zhvillimi i vetëbesimit dhe të menduarit e pavarur.
- Zhvillimi i përdorimit të gjuhës letrare.
- Përgatitja e nxënësit për të mësuar gjatë gjithë jetës (IZHA, 2012, f.4).

Në klasën e nëntë që shënon mbarimin e arsimit të detyruar në Kosovë, lënda e gjuhës shqipe mësohet me qëllim që nxënësi:

- Të përforcojë, të zhvillojë dhe të zbatojë shkathtësitë e komunikimit në shkollë dhe në situata të ndryshme jashtë shkollës.
- Të rrisë shkallën e analizës, të vlerësimit dhe të kritikës për tekstet letrare dhe joletrare.
- Të zotërojë dhe të praktikojë drejt njohuritë e sistemit gjuhësor (IZHA, 2012, f.4).

Për klasën e trembëdhjetë, gjimnaz: “Qëllimi i mësimit të kësaj lënde në klasën e trembëdhjetë është që nxënësi:

- të rrumbullakojë përfundimisht të arriturat nga klasat e mëparshme të shkollës së mesme të lartë;
- të fitojë aftësinë për analizë kritike të pavarur të teksteve dhe të fenomeneve kulturore;
- të komunikojë në mënyrë të pavarur në përputhje me standardet, me tekste letrare e joletrare;
- të komunikojë duke arritur të artikulojë mendimin kritik me modele e kultura të ndryshme etj.”

Duhet të theksojmë se qëllimi dhe fokusi i këtij studimi është asimi i mesëm i ulët, që përkon nga klasa V- IX. Prandaj ne do të fokusohemi më shumë në këtë nivel arsimor.

1.2.3. Roli polidimensional i lëndës së gjuhës shqipe

Sistemi shkollor në Shqipëri dhe në Kosovë vazhdimisht ishte zhvilluar në binarë të ndarë dhe se në Kosovë sistemi arsimor në gjuhën shqipe pati vështirësi të jashtëzakonshme të zhvillimit. Në faza të ndryshme ishte i ndaluar, pastaj zhvillohej në gjuhën serbe, në periudha të tjera ndikohej nga ndërhyrjet politike dhe planprogramet e popujve sllavë, sidomos në periudhën e Jugosllavisë federale komuniste kur shqiptarët jetonin në Maqedoni, Serbi, dhe Mal të Zi.

Problemet e shkollës shqipe, si me asnjë lëndë tjetër, lidhen me lëndën e gjuhës shqipe, sepse ka qenë gjuha, e para, ajo që është gjendur vazhdimisht në shënjestër të cilitdo pushtues, dhe

në veçanti të pushtuesit serb. Në këtë kontekst misioni i lëndës së gjuhës shqipe ka qenë strategjik: mësimi i shkrimlexmit dhe historia e gjuhës. S'ka dyshim se lënda e gjuhës shqipe, veç shkrimleximit përmban njohuri për fonetikën, leksikologjinë, morfologjinë, fjalëformimin, sintaksën, historinë e gjuhës etj. (Sistemin fillor : V-VIII)

Programi mësimor i lëndës së gjuhës shqipe, nga klasa e V e deri në klasën e VIII ndahej në orë javore dhe vjetore. Për secilën klasë programi parashikonte që veç orëve mbi njohuritë e reja mësimore, të kishte edhe disa orë për përsëritjen e lëndës në fillim të vitit dhe gjatë vitit, disa orë për përsëritje sipas nevojës dhe gjendjes në klasë, dhe disa orë për detyra dhe diktme.

Mësimi i gjuhës shqipe në Kosovë pas viteve '70 përfshinte një fond më të gjerë orësh mësimi. Lënda përgatitëse si: leximi dhe shkrimi, përpunimi i tekstit, leximit dhe recitimit, të shprehurit me gojë e me shkrim, njohuri teorike dhe historike letrare, gramatikë. Sipas programit dhe planit mësimor për shkollën fillore të vitit 1977, miratuar nga Pleqësia e Arsimit e Kosovës në mbledhjen e datës 7 janar të vitit 1977, ishin bërë disa ndryshime: zvogëlimi i fondit të orëve të gjuhës amtare në tri orë më pak nga të gjitha orët e llogaritura për të gjitha klasat. Ky plan kishte një fond javor prej 64 orësh mësimore për të gjitha klasët e arsimit të detyruar.

Ndërhyrjet drastike në planprogramet mësimore, u bënë në vitin 1982. Plani dhe programi i vitit 1977 u ndryshua si rezultat i ndërhyrjeve politike për shkak të ngjarjeve në Kosovë të një viti më parë, 1981. Ndryshime konceptuale, plotësime dhe korrigjime pati në aspektin programor, kurse fondi i orëve nuk u prek. Nga programet mësimore u kërkua që të shkarkohen përmbajtjet të cilat u konsideruan me karakter të ashtuquajtur nationalist! Ndërsa lënda e Gjuhës Shqipe u sulmua dhe u dëmtua më së shumti. Nga kjo lëndë u hoqën disa tekste historike, shembuj të ndryshëm, autorë etj.

Kur analizojmë zhvillimin historik të sistemit tonë shkollor në të gjitha viset etnike, për shekuj me radhë gjuha shqipe ka vuajtur mungesën e thellë të zhvillimit dhe të unifikimit: që prej lirisë për t'u përdorur e shkruar lirshëm, e deri te ndërtimi i sistemit shkollor. Faktorë të ndryshëm politikë dhe historikë kanë ndikuar që gjuha shqipe të mos flitet si e lirë, dhe as

të mos shkruhet. Në disa periudha gjuha jonë është shkruar me alfabetë të ndryshme.

Një kohë të gjatë shkolla shqipe nuk e pati një abetare e përbashkët, meqë as nuk kishte një alfabet unik sipas të cilit do të shkruhej gjuha shqipe. Pas krijimit të alfabetit të gjuhës shqipe në Kongresin e Manastirit (1908), gjithsesi nuk u arrit që të botohej një abetare unike. Padyshim, nuk kishte as një standard të folurit të gjuhës meqë vendi përdorte dialekte dhe nëndialekte, krahinorizma etj. Veç në gjysmën e dytë të shek. XX-të, gjashtëdhjetë e katër vite pas kongresit të Manastirit, u sendërtua ideja shkencore në Tiranë që shqiptarët të kishin një gjuhë standarde: në të folur, dhe në të shkruar.²

Standardi gjuhësor vliente edhe për të gjithë shqiptarët kudo që ata jetonin. Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit u shndërrua në kodifikim gjuhësor dhe nisi të realizohej menjëherë në botimet e ndryshme publike, në gazetatat, në programet e radiove dhe të televizioneve, në shkolla, në institucione etj. Cilësia më historike e këtij akti lidhej me mësimin standard të gjuhës shqipe për të gjithë nxënësit, që prej arsimit fillor, të mesëm dhe atij akademik.

Të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit e gjuhës standarde, gjeti përkrahje të pakontestueshme në Shqipëri dhe në masë të konsiderueshme në Kosovë (veçanërisht, në të lexuar dhe shkruar). Rezultatet në përdorimin teorik dhe praktik të gjuhës standarde ishin padyshim historike. Duhet theksuar se për arsye politike dhe historike dhe sidomos në mungesë të shkollimit të dëshiruar të gjeneratave, po edhe për shkak të ndarjeve administrative dhe krahinore, në Kosovë dhe në viset e tjera etnike, ndryshe nga të shkruarit, të folurit standard të gjuhës nuk arriti të shtrihej në masën e dëshiruar.

Njohuritë e avancuara të gjuhës standarde, paraqesin ndryshimin thelbësor midis formës së shkruar dhe asaj të folur ku edhe sot e kësaj dite gjuha e shkruar dallon nga gjuha e folur në shumë vise etnike brenda dhe jashtë hapsires gjeografike që sot ndodhen në Shqipëri

² Projekti i Rregullave të Drejtshkrimit i Tiranës i vitit 1967, Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968), dhe pas pesë vitesh edhe Kongresi i Drejtshkrimit (1972), i dha fund ndarjes gjuhësore nëpër të cilën, kishin ecur në historinë e tij gjuhësore popullit shqiptar.

apo Kosovë. Koncepti dallues i të folurit qëndron në aspekt të sintaksës, të morfologjisë, por edhe në përdorimin e fjalorit.

Sfida gjuhësore në Kosovë ishte për mësimdhënësit dhe studiuesit e gjuhës shqipe të cilët u angazhuan dhe bënë përpjekje të vazhdueshme në ngritjen e shkallës dhe të cilësisë së mësimin, do të thotë në gjetjen dhe aplikimin e metodologjive të reja të mësimdhënies. Në kontekst, përmes reformave dhe modernizimit të sistemit shkollor, u krijuan kushte edhe për përhapjen dhe forcimin e standardit gjuhësor dhe letrar.

Një çështje tjetër që kishte rëndësi të veçantë lidhej me përmbajtjet e teksteve mësimore të gjuhës shqipe. Ndodhte që hartuesit e teksteve mësimore të leximit, nuk arrinin të përmbushnin nevojat e planprogramit të lëndës, ashtu si edhe fakti se botoheshin libra të leximit me përmbajtje jo adekuate, të mbingarkuara me tema dhe përmbajtje etj. Tekstet e këtilla shkaktonin problem në mësimin, përvetësimin dhe kuptimin e duhur të lëndës. Në periudhën kur Kosova ishte si pjesë e Federatës ish- Jugosllave, për shembull, libri i leximit për klasën e V-të i sistemit fillor, ishte botuar me përmbajtje të mbingarkuar, e madje përmbante edhe tekste plagjiaturë nga planprogramet mësimore të gjuhës së kombeve të tjera etj. Prandaj, ishte kërkuar që librat e leximit dhe tekstet e tjera për mësimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë të shkarkoheshin nga përmbajtjet e tepërta dhe që ato të pranoheshin dhe kuptoheshin më lehtë nga nxënësit! Defekte të tjera ishin vërejtur edhe në çështjet e leximit nga nxënësit, pastaj të shkrimit të hartimit, të vlerësimit etj.

Disa vërejtje, analiza dhe studime të bëra lidhur me mësimdhënien e gjuhës shqipe, lidhur me përdorimin e metodave mësimore të lëndës së gjuhës, ishin bërë në kontekst të faktit se në planprogramet mësimore, mësuesit e kësaj lënde favorizonin zbatimin e shpjegimit teorik, duke shmangur apo anashkaluar metodat praktike! Për shembull, në fushën e mësimin të drejtshkrimit dhe të gramatikës, i ishte kushtuar më shumë rëndësi përvetësimit mekanik të rregullave dhe të përkufizimeve gjuhësore, kundërjet ushtrimeve se si të përdoren rregullat në të folur dhe në të shkruar. Për t'i shmangur dobësitë dhe për t'i nxitur metodat e reja, kërkohej që në praktikën mësimore gjuhësore të rekomandoheshin qasje më bashkëkohore në mësimdhënie, si: që nxënësit të mishëroheshin më shumë me lëndën e gjuhës, trajtimi t'i jepej vend aspektit shkencor, të kishte një afërsi më të madhe në mes të

mësuesve dhe nxënësve në shërbim të mësimit dhe përvetësimit të lëndës, përgatitja profesionale e mësuesve të ishte adekuate etj.

Pasur parasysh çfarë u tha më lart, procesi i mësimit të gjuhës shqipe është një proces i rëndësishëm që ka njohur një sërë problematikash dhe barrierrash gjatë gjithë historisë së tij dhe si i tillë lypset të bëhet një studim i mirëfilltë në funksion të rezultateve sa më të larta të të nxënësve.

1.3. Përcaktimi i variableve

Variablat, siç dihet, quhen edhe ndryshore dhe paraqesin koncepte të matshme. Variabli na tregon se subjektet për të cilat ne po mbledhime të dhëna, kanë një numër të caktuar dallimesh. Variablat mund të jenë edhe rregulla për klasifikimin e njerëzve, qëndrimeve, besimeve dhe sjelljeve të tyre. Variablat mund të jenë edhe të mbyllura në kuptimin që një njeri mund të jetë edhe femër edhe mashkull. Por ato mund të jenë edhe të vazhdueshëm, në kuptimin e variacionit, brenda një serie mundësish. Variablat janë të pavarura dhe të varuara. Psh, zhvillimi ekonomik dhe i teknologjive është një variabël i pavarur që ndikon në zhvillimin e gjuhës. Ndërsa variablat e varura janë ndryshore të cilat studiuesi mund t'i parashikojë. Variabli i varur në një studim mund të shërbejë si një variabël i pavarur në një studim tjetër. Psh përdorimi i teknikave dhe mjeteve moderne të shpjegimit dhe të kontrollit, si teknikat audiovizuale, mund të shërbejnë si variabla të pavaruara në studimet e mëvonshme për metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës në shkollë.

Lidhja midis dy variablave shprehet në marrëdhëniet mes faktorëve të jashtëm siç janë zhvillimi ekonomik apo ai teknologjik që kanë ndikim në zhvillimin e gjuhës e kryesisht mbi ata që ne kemi subjekt studimi që janë nxënësit, mësuesit, prindërit (prindër me fëmijë me nevoja të veçanta dhe prindër me fëmijë normalë). Ky variabël është në lidhje me variablin e varur që është metodologjia moderne e përdorur për mësimdhënien. Kështu, për të matur shkallën e ndikimit të vështirësive në të nxënë në gjithëpërfshirjen ne do të mbajmë në vështrim raportin e këtyre dy variablave.

Variabli i pavarur – Metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies, zhvillimi teknologjik dhe ndikimi i gjuhëve të huaja, sidomos asaj angleze.

Variabli i varur – cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies, përdorimi i teknikave moderne të të nxënësve.

1.4. Pyetjet kërkimore, hipotezat dhe objektivat

Hulumtimi dhe identifikimi i një problemi tematik në dimensione të gjera teorike dhe shkencore nënkupton aplikimin e metodologjive dhe mjeteve shkencore në arritjen e nxjerrjeve të njohurive të caktuara. Mjetet e përdorura na ndihmojnë në kërkime dhe rezultate, bazuar në pyetjet që i parashtrijmë, në njohuritë që kemi dhe në përvojat e arritura. Metodatat e kërkimit shkencor, janë mjete të domosdoshme që shtrohen mbi objektiva për rritjen e njohurive dhe të kuptuarit e realitetit të caktuar. Parashtrimi i një e më shumë pyetjeve kundrejt qëllimit të caktuar, nënkupton faktin e të sfiduarit tonë përmes hipotezës kryesore, dhe që kjo pastaj, i nënshtrohet vlerësimit dhe matjes përmes testeve që rezultojnë me konkluzione e rekomandime të caktuara.

Kështu, bazuar në faktet dhe problematikat e përmendura më sipër, rrjedhin natyrshëm këto pyetje kërkimore:

- *A ndikojnë metodologjitë e mësimdhënies të përdorura në mësimin e Gjuhës Shqipe në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies?*
- *A sjellin vështirësi në mësimnxënien e nxënësve përdorimi jo i duhur i metodologjive bashkëkohore të përdorura në mësimin e Gjuhës Shqipe?*
- *Cilat metodologji bashkëkohore aplikohen gjatë procesit mësimor në lëndën e Gjuhës Shqipe?*
- *Sa zbatohen metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies në mësimin e lëndës së Gjuhës Shqipe?*

I gjithë studimi bazohet në tre pyetje të rëndësishme kërkimore, të cilat shërbejnë në ndërtimin e hipotezave.

Mbështetur në pyetjet kërkimore ndërtojmë hipotezat përkatëse. Për secilën pyetje kërkimore është ndërtuar një hipotezë e caktuar. Në këtë mënyrë, studimi bazohet në tre hipoteza.

Hipotezatë janë:

- Hipoteza 1. Metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies të përdorura në mësimin e Gjuhës Shqipe ndikojnë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Hipoteza nul 1. Metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies të përdorura në mësimin e Gjuhës shqipe nuk ndikojnë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Hipoteza 2. Zbatimi jo i duhur i metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies në mësimin e lëndës së Gjuhës shqipe sjell vështirësi tek nxënësit.

- Hipoteza nul 2. Vështirësitë që vihen re te nxënësit në mësimnxënie nuk vijnë nga zbatimi jo i duhur i metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies në mësimin e lëndës së Gjuhës Shqipe.

- Hipoteza 3. Lënda e gjuhës, për vetë specifikën që ka në kurrikulën e arsimit parauniversitar, kërkon aplikimin e metodave bashkëkohore nga mësimdhënësit.

- Hipoteza nul 3. Pavarësisht specifikës që ka në kurrikulën e arsimit parauniversitar, për lëndën e gjuhës shqipe, ajo nuk kërkon aplikimin e metodave bashkëkohore nga mësimdhënësit.

Hipotezat që kemi parashtruar këtu do t'i arsyetojmë në shtjellim të punimit për të vërtetuar se aplikimi i metodologjive të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies në Kosovë duhet të kthehet në një prioritet të domosdoshëm. Nga hulumtimet tona, ne do të tregojmë se hipotezat që kemi parashtruar kanë gjetur zbatim në ato subjekte që ne kemi intervistuar duke u mbështetur në analizën e variablave gjithashtu.

1.4.1. Objektivat e punimit.

Duke i përmbledhur, listojmë këto objektiva:

- Evidentimi i metodologjive të mësimdhënies së Gjuhës Shqipe që përdoren në arsimin e MU në Kosovë.
- Konstatimi i nivelit të aplikimit të metodologjive adekuate në mësimdhënie
- Evidentimi i vështirësive të hasura gjatë këtij procesi.

Gjithashtu mundësohet edhe një krahasim mes metodologjive bashkëkohore dhe tradicionale, si një përpjekje për gjetjen e metodologjive më të suksesshme.

Ne kemi zhvilluar intervista, kemi bërë matje dhe kemi hartuar pyetësorë me ata që i kemi përcaktuar si brendia e variablit të varur që janë nxënësit, administratorët dhe mësuesit e shkollave të Gjakovës. Kemi evidentuar po ashtu edhe planin kurikular të lëndës së Gjuhës Shipe në Kosovë dhe kemi arritur si objektiv që të eidentojmë se metodologjitë e reja të mësimdhënies në lëndën e Gjuhës Shqipe kanë dhënë rezultate të prekshme. Ndryshimet me metodat tradicionale janë evidente. Këtë e kemi konstatuar duke analizuar metodat adekuate të mësmdhënies dhe mësimnxënies që gjenden në kapitujt në vazhdim.

1.5. Struktura e punimit

Ky punim është ndarë në pesë kapituj.

Në **Kapitullin I** trajtohet *Hyrja*, e cila përfshin nën ndarje të tilla si: - Përmbledhja e punimit, pyetjet kërkimore, problematika, hipotezat, objektivat , teoria dhe literatura bazë, si dhe rëndësia e punimit.

Në këtë kapitull trajtohen konceptet kryesore të këtij punimi, të tilla si: *Përkufizimi dhe një përmbledhje e shkurtër e studimeve mbi procesin e mësimdhënies së lëndës së Gjuhës shqipe*. Më pas jepen studimet dhe kërkime të bëra dhe historiku në lidhje me metodologjitë dhe lëndë e Gjuhës shqipe.

Një çështje tjetër që trajtohet në këtë seksion është rëndësia e Gjuhës shqipe në sistemin arsimor.

Në këtë kapitull, më tej, vazhdojmë me prezantimin e problematikës së përgjithshme të punimit. Në faqet në vijim trajtohen objektivat e kërkimit si dhe arsyet pse është zgjedhur ky objekt. Më vonë jepen në mënyrë të detajuar pyetjet kërkimore dhe hipotezat si dhe mënyra e vërtetimit të hipotezave.

Sigurisht, në fund përmenden shkurtimisht disa nga teoritë bazë mbi të cilat ndërtohet ky hulumtim.

Literatura bazë është një tjetër çështje që përmedet shkurtimisht këtu, më saktë studimet ku mbështetet ky punim dhe në fund rëndësia apo impakti i tij.

Kapitulli II, trajton aspektin historik të subjektit tonë. Kështu jepen në mënyrë të përmbledhur disa nga pikat kyç në zhvillimin e mësimdhënies së Gjuhës shqipe. Fillimisht fokusohemi në Shqipëri, pasi themi me bindje si disa nga planprogramet e saj shërbyen si bazë për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe edhe përtej kufinjve.

Kapitulli III

Kapitulli i tretë trajton bazën teorike që lidhet me fushën e mësimdhënies së Gjuhës shqipe. Fillimisht, bëjme një shtjellim në detaje të literaturës bazë. I referohemi studiuesve të ndryshëm, të cilët kanë dhënë një kontribut të konsiderueshme në këtë fushë dhe në hipotezat që nxjerr kjo literaturë.

Në seksionin pasues përmendim shkollat e ndryshme teorike që ekzistojnë mbi këtë fushë studimi.

Kështu në këtë seksion të veçantë do të trajtohen këto praktika: *brainstormingu, klasteri, puna në grupe, puna praktike, etj.*

Ndërsa në pjesën e katërt të këtij kapitulli trajtojmë metodologjinë punës sonë kërkimore. Ky seksion ndahet në këto çështje: *metodologjia, skicimi i kërkimit, mostra e kërkimit, instrumentet e kërkimit, procesi i mbledhjes së të dhënave etj.*

Kapitulli IV është kapitulli bazë i punës sonë kërkimore. Këtu jepet një pasqyrë e analizës empirike e të gjithë punimit. Më pas bëhet përmbledhja e të gjithë të dhënave dhe punës kërkimore.

Kapitulli V ka të bëjë me diskutimin e të dhënave, ku behet krahasimi i rezultateve të punës sonë kërkimore me punime të tjera të ngjashme apo me teoritë kryesore duke dhënë edhe një arsyetim mbi rezultatet e përftuara.

Kapitulli VI është kapitulli i fundit dhe sigurisht ka të bëjë me konkluzionet dhe të rekomandime që dalin në bazë të dhënave.

1.6. Rëndësia e punimit

Është e logjikshme të theksojmë se roli i gjuhës, nuk zëvendësohet asnjëherë dhe prandaj, as nuk duhet të lejohet që kjo të ndodhë, sepse gjuha është një prej attributeve kryesore të

identitetit shoqëror dhe kombëtar. Në momentin që gjuha pëson shkarje të thella dhe injorohet nga komuniteti që e përdor, atëherë, vihet në dyshim e ardhmja e saj. Gjuha, është një mjet tejet i rëndësishëm komunikimi dhe identifikimi për individin dhe komunitetin e caktuar. Çdo gjuhë për secilin komunitet, konsiderohet si një prej elementeve strategjike shoqërore dhe nacionale, dhe se në plotë shtete, gjuha mbrohet me ligj. Prandaj fokusimin tonë tematik kundrejt lëndës së Gjuhës shqipe, duke pasur si bazë rolin e saj që e shpjegojmë më sipër, e konsiderojmë të rëndësishme që ta fillojmë pikërisht mbi korniza të lashta historike, e deri te historia jonë më e re.

Paralelisht me qëllimet dhe me objektivat e studimi, përdorimi i më shumë metodave në studimin e fushës së aplikimit të metodologjive të mësimdhënies së lëndës së Gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar, siq janë metoda historike, metoda logjike, e empirike, statistikore etj., nënkupton thellime kërkimore, ashtu si edhe arritje në konkluzione e rekomandime të caktuara në fushën e aplikimit të metodologjive në këtë lëndë. Këto pikëpamje e ngrisin nevojën dhe rëndësinë e këtij studimi. Në këtë mënyrë, jemi gjithnjë të fokusuar në kornizat përmbajtësore hulumtuese shkencore, kundruall problemit.

Për më tej, testimi i teorive dhe i hipotezave mbi bazën e analizës, duhet të bëhet konform vrotimit të realiteti subjektiv dhe objektiv si në lidhje me substancën e aplikimit të metodologjive të mësimdhënies së gjuhës shqipe, po ashtu edhe në lidhje me kriteret dhe kushtet e mësimdhënies sepse, vetëm në këtë mënyrë arrijmë deri te qëllimi i dëshiruar i njohjes dhe i zërthimit të thelbit të temës.

Në kontekst, jo vetëm aplikimi i metodologjive, shfletimi i literaturës dhe i aspekteve të tjera, e lehtëson apo e bën të mundshëm shtjellimin e duhur të problemit, meqë nuk është e lehtë të identifikohen faktorët që ndikojnë në shfaqjen e dukurive dhe të pengesave që po ndikojnë në rënje të interesimit të nxënësve kundrejt mësimin në përgjithësi, përfshirë edhe lëndën e gjuhës shqipe. Është fakt që nuk mungon literatura, kushtet mësimore nga pikëpamja objektive – materiale janë shumë më të volitshëm, krahasuar me të kaluarën, e po ashtu edhe faktorët teknologjik-metodologjik janë dukshëm më bashkëkohore dhe më ndihmues në mbarëvajtjen e procesit mësimor . Mirëpo, ka fakte që gjendja në arsim, e në këtë drejtim e marrim shembull shkollën kosovare, nuk është ajo që do ta dëshironim.

Me gjithë interesimin dhe angazhimin e personelit shkollor, sigurimin e literaturës mësimore, të kushteve materiale etj., problemet mësimore janë të pranishme dhe matjet e suksesit të shprehur përmes vlerësimit – notimit nga mësuesit, nuk përkojnë me nivelin dhe me cilësinë e dijeve që i shprehin nxënësit, pas mbarimit të shkollimit parauniversitar. Në këtë drejtim, dobësitë shprehen sidomos në lëndën e gjuhës shqipe, ngase, shumica e atyre që e mbarojnë shkollimin parauniversitar, kanë probleme të theksuara në formulim të fjalisë, në ndërtim të strukturës së shkrimit, madje në vetë mënyrën e shkrimit!

Pse shfaqen të këtilla probleme ? Sigurisht, ka arsye dhe faktorë të ndryshëm që ndikojnë në etabilimin e një gjendje të këtillë që, padyshim duhet shmangur sepse nuk ka arsye të qëndrueshme që kushdo që e mbaron shkollimin e mesëm, të ballafaqohet me probleme të këtilla, si bie fjala, mosdija e ndërtimit dhe e shkrimit të një fjalie të thjeshtë! Në kontekst, *“shtrohen çështjet e vlerësimit real të së kaluarës së shkollës, arritjet dhe dobësitë e shprehura, përcaktimi i qartë i vizionit të shkollës së ardhme, e cila duhet t’u përgjigjet kërkesave të shoqërisë: si të bësh shkollën shqiptare të komunikojë më atë evropiane e më gjerë”*. (Trëndafil, 2008, f. 5)

Nga hulumtimi dhe studimi ynë i problemit, nuk themi që kushtet objektive dhe materiale janë si faktorë koheziv ndikues për gjendjen e këtillë. Pavarësisht se, shfaqen probleme sidomos me grumbullimin e më shumë nxënësve në një klasë se sa që është e lejueshme, shfaqen probleme lidhur me aplikimin e disiplinës së nevojshme përgjatë zhvillimit të procesit mësimor , zbehja e imazhit të lëndës së gjuhës shqipe dhe pasojat e mos interesimit për këtë lëndë, për mendimin tim burojnë nga mungesa e respektit dhe e trajtimit të kësaj lënde si e rëndësishme, si strategjike në procesin mësimor . Përgjatë hulumtimit të problemit, e kuptojmë në masë të madhe se as nxënësit, as mësimdhënësit, as grupet e interesit etj., nuk e konsiderojnë lëndën e gjuhës shqipe aq të rëndësishme, krahasuar me lëndët e tjera.

1.7. Teoritë dhe literatura bazë

Kur flasim për mësimdhënien, natyrisht, na vijnë në mend shumë teori, por në këtë studim dy janë me rëndësi të përmenden:

1. Teoria Konstruktiviste

Kjo teori fokusohet në përgatitjen e nxënësve për të zgjidhur problemet në situata reale dhe shpesh të paqarta, nxënësit janë aktivë në mendimet e tyre. Në këtë proces të ndertimit të njohurive kanë rëndësi ndërveprimet sociale.

2. Teoria sociale e të mësuarit

Në lidhje me bihevizmin në shkollë, lidhet *teoria sociale e të mësuarit*. Kjo teori është përpunuar nga Albert Bandura. Nga njëra anë, kjo është një teori e pastër biheviziste e imitimit, që bazohet në parimin se shumë nga sjelljet njerëzore formohen përmes imitimit të modeleve të ndryshme.

KAPITULLI II

HISTORIKU I MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Bazamenti i ndërtimit të sistemit shkollor, kërkonte një angazhim didaktik-pedagogjik si nevojë e ndërtimit të koherencës historike të shkrimit dhe mësimin. Por, shkrimi i shqipes për shekuj me radhë, është bërë me alfabet të huaj. Letërsia shqipe, për shkak të ndikimit kishtar, e vendoste në krye të literaturës së çfarëdoshme përmbajtjen fetare. Humanistët dhe krijuesit shqiptarë të periudhës mesjetare (të shek. XV, XVI, XVII), veç predikimit fetar, përpiqeshin t'i kushtonin kujdes edhe përdorimit të gjuhës, shkrimit, etikës mësimore,

Rilindasit, u përpoqën të përgatisin dhe hartojnë shkrimin shqip. Dy shekuj më vonë, Naum Veqilharxhi, e botoi në vitin 1844 abetaren e parë.³ Është interesant të ceket fakti se, që nga ky vit, u përgatiten dhe u botuan 150 abetare, brenda dhe jashtë trojeve shqiptare. Rilindasi tjetër Kostandin Kristoforidhi, e botoi më 1867 një abetare në gegërisht, dhe një toskërisht. Alfabeti i Kristoforidhit, ishte me bazë latine, dhe kishte vetëm tri shkronja greke. Por, kur flasim për alfabetin e gjuhës sonë, në arkivin e Kosovës, në formë të fotokopjes eksiton një

³ Motoja e kësaj abetare: "Fort i shkurtër e i përdorshëm. Evëtar shqip për çdo sicillë që do të mposnjë të kënduarit e të shkruarit bukur shqip".

tekst prej 92-faqesh i marrë në arkivin e Bosnje dhe Hercegovinës që flet për alfabetin shqip, dhe për një abetare që është përgatitur nga austriaku, Dr. Ludvig von Thalloczy.⁴

Bazuar në kontributin e tij, Abetarja shqipe (pjesa I), u botua në 1000 kopje në shtypshkronjën Halzhausen të Vjenës, dhe pastaj u dërgua në konsullatën Austrohungareze në Shkodër. Kopje të kësaj abetare, arritën edhe në Kosovë. Në anën tjetër, një ndër figurat e shquara atdhetare, një nga historianët dhe pedagogët e shquar të kulturës dhe arsimit shqip, është padyshim Matija Logoreci. Ai, dha mësimë në Shkodër, Prizren, Tiranë. Autori Logoreci, hartoi disa tekste për shkollat në gjuhën shqipe si: Abetar botuar në Vlorë, Plotësori i Abetarit që përmban 50 faqe dhe Libër i mësuesit për përdoruesit e Abetarit që kishte gjithsejtë 55 faqe. Logoreci, “*ndryshe nga hartuesit e tjerë të abetareve, mësimin e gjuhës shqipe e fillon me dhënien e 2-3 zanoreve ose edhe të të gjithave dhe pastaj kalohej në formimin e rrokjeve. Madje përvetësimi i shkronjave të mëdha të dorës dhe të shtypit bëhet menjëherë pas përfundimit të shkronjave të vogla. Në tekstet e tij, krahas mësimëve mbi gjuhën shqipe dhe mësimdhënien, lexuesit i jep rol me rëndësi edhe edukimit moral dhe atdhetar*” (Gjoshi, 2016, f.175).



⁴ Dr. Ludvig von Thalloczy, projektin për një abetare në gjuhën shqipe, e kishte filluar në vitin 1894. Ai, ishte angazhuar zyrtarisht që siguronte financa për ta botuar një Histori të shqiptarëve në gjuhën shqipe. Sipas shkresës së Ministrisë së Punëve të Jashtme austrohungareze. Dr. Ludvig von Thalloczy, letra për ndihmë ishte dërguar më 22 Nëntor 1898.

Fig. 2 Faksimile të Abetares së Matija Logorecit.

Në periudhën e rilindjes kombëtare, u përhapën idetë e emancipimit dhe të aktivitetit të konsoliduar për çlirim. Dhjetëra kryengritje në fund të shek.. XIX-të kundër pushtimit osman, ishin të ndikuara nga idetë dhe bartësit e tyre rilindas. Përpyekjet për një alfabet të njësuar, nuk pushuan asnjëherë. Siç kemi vënë në spikamë më sipër, në mesin e shekekullit XIX-të në të gjitha trevat shqiptare, kishte filluar në njëfarë mënyre mësimi i gjuhës së shkruar në shkollat e kohës. *“Nga korespondenca e korçarëve me Veqilhaxhin (1845) mësohet se me tekstin e tij të abetares, mësimi i shqipes filloi të përhapej jo vetëm në Korçë, por edhe në Përmet, Berat e gjetkë.* Peridha e Rilindjes, la gjurmë të pashlyeshme në zhvillimin dhe në emancipimin e kombit shqiptar. Gjysma e dytë e shekullit XIX-të, i takon luftës pothuajse kolektive të popullit tonë për t’u çliruar nga perandoria osmano – turke, si dhe luftës për edukim dhe shkollim. Përhapja e ideve përparimtare, formimi i dhjetëra klubeve, shoqata, botimi i dhjetëra gazetave, por edhe hapja e shumë shkollave domodoshmërisht, qoi tek nevoja për hartimin e një alfabeti të vetëm.

Formimi i një alfabeti të njësuar, do t’i shërbente unifikimit të gjuhës dhe shkrimit, dhe do të shmangte përfundimisht ndikimin e mëtejshëm të alfabeteve turko-arabe, greke, sllave etj. Më 1908, me përpjekje gjithëkombëtare për një gjuhë dhe alfabet unik, u organizua kongresi i Manastirit. Që nga kjo kohë, çështjet gjuhësore dhe të letërsisë u zhvilluan në përpjekje të vazhdueshme për unifikim dhe standardizim për të gjithë shqiptarët. Ideja e unifikimit gjuhësorë, padyshim që ishte një përpjekje e hershme. Duhet të përmendim këtu se, bardi shqiptar Faik Konica, qysh më 1897 në revistën e famshme panshqiptare “Albania”, kishte shkruar për nevojën e unifikimit të gjithë shqipe, pra për nevojën e një gjuhe standarde që, do të vlente për të gjithë shqiptarët kudo që do të jetonin ata. Mirëpo, shumë vite më vonë, më 1972, pas shumë e shumë përpjekjeve dhe aktiviteteve, në Tiranë u organizua Kongresi i Drejtëshkrimit. Me këtë eveniment historik, praktikisht u kurorëzuan përpjekjet e gjata - shekullore në mënyrë që të gjithë shqiptarët kudo ku jetojnë, ta flasin dhe ta shkruajnë një standard shqipe.

Kongresi i Tiranës, një prej ngjarjeve kapitale në fushën e gjuhësisë dhe të kulturës, u konceptua me sintagmën: “Një komb – një gjuhë”. Prandaj, që pas vitit 1972 gjuha shqipe standarde, u fut në përdorim në jetën shoqërore dhe publike, pastaj në organizatat shoqërore

e politike, e madje ishte hartuar edhe infrastrukturë ligjore që e garantonte përdorimin e ligjshëm të gjuhës shqipe në të gjitha sferat e shoqësisë, si shkolla, administratë, kulturë sport, film etj.

Aktiviteti, proceset historike, formësimi kombëtar dhe lëvizjet për çlirim dhe arsimim të popullit tonë pa dallime krahinore dhe fetare, i paraprinë edhe hartimit të abetares së parë unike për të gjithë shqiptarët, e cila u aprovua nga Tirana dhe Prishtina në vitin 2012.⁵

Unifikimi i gjuhës shqipe, ishte një detyrim arsimorë dhe kombëtar për ta ndërtuar standardin e gjuhës unike, meqë shqipja përbëhet nga dy dialekte: nga dialekti toskë, dhe nga dialekti gegë. Sado që dialektet janë psuri gjuhësore, sidomos për shkak të ndajreve politike dhe administrative – shtetërore, kongresi i drejtëshkrimit, ishte një prej veprave me karakter kombëtar dhe që gjeti një përqafim të denjë, si për shqiptarët në Shqipëri, në Kosovë dhe në viset e tjera në ish Jugosllavi ku jetonin shqiptarët, madje edhe në diasporë.

Me kalimin e viteve, u ndërtua një sistemi edukativ – arsimor i pavarur, që funksionoi deri në vitin 1999. Në këtë rrethana të vështira për rreth një dekadë, u ngritën programore dhe plane të pavarura – profesionale, dhe ndryshe nga sistemi i kaluar që kishte ndikime të mëdha politike dhe ideologjike. Sipas të dhënave dhe statistikave të kohës, në Kosovë u riformuluan programe, plane dhe tekste të tjera, të cilat, u hartuan nga ekspertë të Kosovës dhe të Shqipërisë si në gjuhë dhe në letërsi shqipe, pastaj në gjeografi, histori, kulturë muzikore, në arte etj.

Rishikimi i programeve dhe i teksteve shkollore, ishte një çështje strategjike duke pasur parasysh, ndikimet që për rreth 50 vite, ishin bërë nga sistemi politik dhe arsimorë i Serbisë dhe i Jugosllavisë. Në kontekst, u hoqën përmbajtjet ideologjike dhe politike, dhe sistemi arsimorë shqip në Kosovë, u vu në shërbim të qartë të gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Ngritja e cilësisë në arsim, reformimi i shkollës dhe i përmbajtjeve mësimore, zhvillimi sa më efikas i procesit mësimorë, u shoqërua edhe me procese e aktivitete që do t'i shërbenin ngritjes së vetëdijes, si dhe avancimit të shkollës shqipe. Pavarësisht se Kosova, në këtë kohë ishte e okupuar, aktivitetet u zhvilluan në fushën e organizimit të kurseve të gjuhëve, të formimit të

⁵ Abetarja e përbashkët, është hartuar nga një grup autorësh nga Shqipëria dhe Kosova: Mimoza Gjokutaj-Çano, Islam Krasniqi, Shezai Rrokaj, dhe Saranda Kumnova-Pozhegu.

grupeve të ndryshme të diturisë në lëndë të ndryshme, u themluan grupe recituesish, revista arsimore dhe shkencore, u organizuan gara të ndryshme sportive etj. Në këto rrethana tejet të jashtëzakonshme, u arritë që të ndërtohet një sistem i mirëfilltë fillorë, i mesëm dhe universitar. Në Kosovë, vepronin 480 shkolla fillore dhe të mesme, me mbi 339.000 nxënës dhe me 18250 mësimdhënës. Vepronte po ashtu, edhe Universiteti i Prishtinës me 14 fakultete aktive. Në verë të vitit 1994, Qeveria e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe të Kulturës, si dhe institucionet e tjera relevante, aprovuan Dekretligjin për zhvillimin e përkohshëm të veprimtarisë edukativo – arsimore në Republikën e Kosovës.⁶

Po ashtu, edhe në vitin shkollor 1996/97, u bënë ndryshime dhe korrigjime substanciale të planeve e të programeve mësimore. Për rrjedhojë, në këtë kohë Enti Pedagogjik i Republikës së Kosovës, kishte përgatitur programe të reja mësimore për shkollën fillore dhe për shkollën e mesme. Dy vite më vonë, në mars të vitit 1999 për shkak të përhapjes së luftës Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë (LASH), mori vendim për ndërprerjen e mësimin në territorin e Kosovës.

Konstatime:

- 1. Etepa e parë (1944 – 1966). Sistem arsimor socialist me përfshirje gjithë popullore për zhdukjen e analfabetizmit. Mësimi teorik me bazë ideologjinë komuniste. Forcimi i besimit në socializëm dhe vëllazërim – bashkim si rend politik e ekonomik Jugosllav. Në Kosovë orientimet programore të arsimit qonin deri në përfundimin e një shkolle të mesme gjimnaz apo normale dhe në vitin 1958 themelohet Shkolla e parë e Lartë Pedagogjike dhe më 1960 Fakulteti Filozofik në Prishtinë.*
- 2. Etepa e dytë (1966–1980). Shënohet një demokratizim i sistemit të arsimit dhe fillojnë punën edhe shkollat e mesme profesionale apo prodhuese, por nuk investohej në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies ku 91% e buxhetit arsimor i dedikohej vetëm pagave. Pas vitit 1970 proceset arsimore marrin një hovë të lartë të zhvillimit, depolitizohet sistemi i arsimit në një masë të madhe, planprogramet arsimore*

⁶ Për herë të parë në Republikën e Kosovës, sipas sistemit të ligjësuar mbi rregulla të njësuara nga organet kompetente arsimore (Kumtari 1), që të bëhet zgjedhja e organeve udhëheqëse të institucioneve arsimore, si dhe e drejtorëve të shkollave në shtetin e pavarur të Kosovës.

zhvillohen nga ekspertët kosovar, arsimit merr një dimension të ri shoqëror dhe kombëtar në luftë për dije dhe liri nga okupimi serb.

3. *Etapa e tretë (1981–1991). Paraqet një ri dizajnim të shovenizmit në arsimin shqui, hamendja dhe çorientimit i institucioneve të arsimit, përjashtimi nga puna dhe arrestimet e shumta të ekspertëve dhe mësimeve, duke u orjentur në politika arsimore jo normale dhe diskriminuese. Kjo etapë shënohet zhvillime edukocidiale deri në ndalimin e arsimit dhe dëbimin me dhunë të nxënësve, studentëve dhe mësimeve nga institucionet arsimore.*
4. *Etapa e katërt (1991–1999). Pavarsohet sistemi arsimor në Kosovë nga ai Jugosllav. Sistemi i arsimit vëhet në lëvizje të themelimit të shtetit të ri të Kosovës dhe pengimin e shpopullimit të Kosovës nga populli i saj. Zhvillimi i planprogrameve dhe botimi i teksteve mësimore të reja pa ndikime ideologjike dhe politike dhe me platëformë të arsimit kombëtar. Nuk është zhvilluar ndonjë filozofi e veçantë orientuese arsimore, por është shënuar një vullnet i paparë për punë të mësimeve, në kushte të rënda të okupimit, në “Shtëpitë Shkollë”.*
5. *Etapa e pestë (1999 e deri sot). Reformimi dhe orjentimi standardet më të larta ndërkombëtare. Qëllimet arsimore në ndërtimin e aftësive mendore, shkathësitë profesionale, kulturën qytetare dhe mirëqenien individuale e shoqërore të qytetarëve të Kosovës. Zbatimi i metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të bazuara në standarde dhe objektiva mësimore. Zgjerimi i sistemit të arsimit të obligueshëm për një klasë dhe organizimi i arsimit privat si alternativë dhe konkurrues në zhvillimin e arsimit në Kosovë.”⁷*

Është evident fakti se njeriu mëson, dhe i rritë kapacitetet e dijes qysh në ditët e para të hyrjes në ciklin shkollë fillorë, e deri në fund të jetës së tij. Kur është fjala për sistemin e organizuar të mësimin, praktikës mësimore në klasë, u janë shtuar eksperiencat dhe përvojat e nxënësve, mënyrat për t'i ngritur kapacitetet e dijes, vlerësimet, mjetet, debati interaktiv, puna në grupe etj. Në proces e mëtej, janë diktuar e shfaqur teori dhe mjete të shprehjes, të komunikimit,

⁷ Këto shënime kronologjike, i kemi marrë nga studimi monografik i Prof. dr. Ragip Gjoshit me titull: “Mësimdhënia e Gjuhës Shqipe në Kosovë” (aspekte historike dhe didaktike), të botuar më 2016, në Prishtinë.

teknologji të ndryshme informative, mjete që lidhen me vijueshmërinë apo me ndjekjen e sistemit modernë shkollorë mbi bazën e reformave të vazhdueshme etj. Mësimi i lexim - shkrimit fillestar, i ka ndjekur ecuritë didaktike që lidhen me respektimin e tri fazave:

1.Faza e parë: Periudha përgatitore për lexim-shkrimin

2.Faza e dytë: Fitimi i shprehive elementare të teknikës së lexim-shkrimit

3.Faza e tretë: Përforcimi i teknikës së lexim-shkrimit (Grup autorësh, 2012, f. 6)

Në fokus, dimensionin e mësimdhënies përfshinë përmbajtjen, kontekstin dhe procesin se: “mësuesit në klasë janë lehtësuesit e diskutimit mësimorë, lektor dhe mentor, që nxënësit janë pjesëmarrës dhe dëgjues; që objektivi i metodës së mësimdhënies, është që të ketë një impact mbi cilësinë e komunikimit në këmbim të informacionit.” IF (Interactivity Fundation, f. 4)

1. Mësimdhënia, agrivohet nga një varg kompetencash që kryesisht kanë të bëjnë me ato të komunikimit dhe të shprehurit, të menduarit, të mësuarit, përgatitja për jetë, për punë për mjedis, personale si dhe ato qytetare.

Format dhe përmbajtjet mësimore, metodat e mësimdhënies, mjetet mësimore, teoritë dhe praktikën e procesit të të mësuarit etj., mbështeten në filozofinë e komunikimit dhe të të shprehurit të sinkronizuar dhe të sistemuar mësimorë.

2. Komunikimi si metodologji e mësimdhënies përbëhet nga: 1. Komunikimin nëpërmjet gjuhës amtare. 2. Komunikimin nëpërmjet gjuhëve të huaja. 3. Të shprehurit kulturorë nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. 4. Komunikimin nëpërmjet teknologjisë informative. 5. Angazhimin dhe kontributin për dialog produktiv. 6. Respektimin e rregullave të komunikimit.

Pse janë të rëndësishme metodologjitë e mësimdhënies ? Reformimet mbi baza institucionale të sistemit të arsimit në Shqipëri dhe Kosovë, janë indikator të fuqishëm në ndërtimin e një sistemi të moderuar të arsimit. Dhe kështu, çështjet e ndryshimeme tematike të lëndëve dhe literaturës mësimore, përshtatjet dhe planprogramet e reja në në relacion me sistemin e moderuar të arsimit ndërkombëtar, rritja e kapaciteteve kadrovike dhe materiale, investimi

dhe ndërtimi i objekteve të reja etj., i kanë shtyrë përpara edhe idetë e ndërtimit të strategjive të reja të metodologjive të mësimdhënies.

Mësimdhënia, është proces kompleks që përfshinë një gamë të madhe të detyrave dhe të përgjegjësisë, dhe të cilat, janë të ndërvarura mes vete. Lënda e gjuhës shqipe, e njohur edhe si letërsia shqipe, është një lëndë mjaft parësore, do të thoshim strategjike në sistemin parauniversitar. Prandaj, “gjuha shqipe, luan rol të veçantë edhe në zhvillimin mendor të nxënësve, ndikon në veçoritë psikologjike të tyre dhe, në dashurinë për gjuhën amtare, ndjenjën e përgjegjësisë dhe qëndrimin e ndërgjegjshëm ndaj saj”. (Ajëti,1980- 15)

Roli i saj, është i patjetërsueshëm. Gjuha, si tek secili komunitet dhe popull, përbën kuptimin themelor të organizuar dhe bazamentin e edukimit dhe arsimimit. Në këtë fokus, zhvillimi dhe avancimi i sistemit të arsimit, mbështetet në procesin e reformimit të sistemit, në kursin e ndryshimit dhe të modernizimit etj. Funksionalizimi i duhur dhe i qartë i metodave të mësimdhënies në procesin mësimorë në lëndën e gjuhës shqipe, ndikon në ngritjen e nivelit dhe të cilësisë së mësimimit, ndikon pastaj edhe në formimin e personalitetit të nxënësve etj. Komplexiteti përmbajtësor dhe didaktik i mësimdhënies së gjuhës shqipe si lëndë mësimore, shkakton disa shtresime didaktike.

Më poshtë japen të dhëna mbi historikunë e mësimimit të Gjuhës shqipe për secilën periudhë.

2.1. Fillimi i shekullit XX

Në gjysmën e parë e shekullit XX, përafërsisht në vitet '20 të shekullit të kaluar burojnë fillesat për mësimin e gjuhës shqipe në mënyrë të programuar, ndryshe nga më parë, kur shkolla dhe mësuesit bazoheshin në tekstet e gramatikës dhe ato të këndimit. Programet e para mësimore të gjuhës shqipe kishin si veçori vënien e theksit në edukimin e nxënësve me dashuri për gjuhën, në ushtrimin e tyre për të folur e shkruar drejt, në kapërcimin e gabimeve dialektore etj.: “Detyra e mësuesit të gjuhës shqipe është t’u ushqejë nxënësve dashuri për gjuhën... t’u jepet më shumë rëndësi mësimimeve të gjuhës sesa gramatikës.”¹⁰

Pak vite më vonë synohej që “Të aftësohen nxënësit që të kuptojnë qartë mendimet e të tjerëve dhe të tregojnë mendimet e veta drejt e qartë... Me anën e ushtrimeve të gjuhës të mësohen nxënësit që të flasin e të shkruajnë drejt gjuhën.”

Nga fundi i viteve '20, çështja shtrohej mbi nevojën që “Mësimi i gjuhës shqipe duhet t’u sigurojë nxënësve shijen për gjuhën dhe ndjenja të bukura e të pëlqyeshme dhe t’i nxitë ata që të mendojnë drejt e arsyeshëm... Të stërviten nxënësit me gjuhën e përbashkët duke ndrequr gabimet dialektore.”

Referuar studiuesit (Rama 2013), tradita e krijuar dhe mbështetja në përvoja të vendeve të tjera i kishin lënë më shumë vend gramatikës sesa harmonizimit të raporteve ndërmjet gjithë disiplinave të gjuhës. Sipar tij kjo karakteristikë ishte vënë re nga didaktët dhe gjuhëtarët e kohës, të cilët, jo vetëm që e njohën si problem, por shtruan nevojën për trajtimin e gjuhës amtare në shkollë në të gjitha aspektet dhe funksionet e saj si mjet komunikimi.

Më vonë, në mesin e shekullit XX, u shfaq nevoja për mjetet të re për arritjen e qëllimit të gjuhës, qëllimi i cili ishte që nxënësi të bëhet zoti “që t’a përdorë mirë gjuhën si në të folurit, ashtu edhe në të shkrojturit.

Thënë ndryshe, nxënësi duhej të mësonte gjuhën në mënyrë të tillë që të mund të kuptojë fjalët dhe kuptimet e të tjerëve, të mundë t’i komunikojë tjetrit bukur e mirë mendimet dhe ndjenjat e tij, të mund të këndojë dhe të kuptojë një libër dhe të jet’ i zoti t’i çfaqë mentimet e tij me shkrim. Mjete për t’i arrirë këtij qëllimi janë libri i këndimit, gramatika, ushtrimet e ndryshme të gjuhës dhe hartimet.”

Ajo që vihet re qartazi në mësimin e gjuhës shqipe në këtë periudhë është fakti që theksohej jo vetëm zotërimi i gjuhës amtare prej nxënësit, por dhe në përdorimi i kësaj gjuhë prej tij me gojë e me shkrim në kontekste të ndryshme. Për t’u realizuar ky qëllim u bë e mundur shtimi i mjeteve, të tilla si tekstet mësimore, si dhe pasurimi i tyre me informacion e trajtime didaktike në përshtatje me moshën e nxënësve.

Duhet të theksojmë që ajo që vihet re në programet mësimore të viteve '40, është fakti se zgjerohet qëllimi i mësimin të gjuhës amtare, duke e vlerësuar gjuhën si mjet komunikimi me të gjitha format e saj në situata reale: “Gjuha është mjet komunikimi dhe marrëdhëniesh shoqërore. Ajo nuk mund të shkëputet nga jeta, prandaj dhe mësimi i saj duhet të lidhet me botën reale që e rrethon nxënësin.” Duke cituar një program të mësimin të gjuhës shqipe të atyre viteve, ndër të tjera thuhet:

1. Programi i gjuhës shqipe, 1921
2. Programi i gjuhës shqipe, 1925
3. Programi i gjuhës shqipe, 1928

“Mësimi i gramatikës ka për qëllim që t’i bëjë nxënësit të zotë të shkruajnë e të flasin gjuhën amtare mirë, drejt, pa gabime” “...që të përdorin gjuhën me të gjitha format e saj” Më tej, në lidhje me këtë periudhë i jemi referuar studiuesit Rama (2013), i cili ndër të tjera thekson se vlerësimi i rolit të gjuhës në marrëdhëniet shoqërore shtroi detyrën e lidhjes së mësimimit të saj me jetën e përditshme. Sipas tij hartuesit e teksteve mësimore pasqyruan kërkesat e programeve, duke përfshirë mësimet që nxitnin përdorimin e gramatikës në lloje të ndryshme të punëve me shkrim, ku nxënësi vihej në provë sa i zoti ishte për të shkruar në pajtim me rregullat që mësonte në gramatikë.

Një ndryshim arsimimor, siç ishte kalimi i sistemit arsimor të detyruar nga ai fillor në atë shtatëvjeçar, bëri që mësimi i gjuhës shqipe të kishte një vend kryesor në planin mësimor. Në këtë mënyrë u rrit numri i botimeve të teksteve shkollore për gjuhën dhe për këndimin shqip.

Në këtë kontekst, gjuha shqipe u zhvillua në një dimension të ri. Mësimi i saj një cikël shtatëvjeçar të arsimit të detyruar zgjeroi vëllimin e njohurive gjuhësore dhe trajtimin e tyre në mënyrë të përshkallëzuar. Në atë kohë, qëllimi kryesor ishte që nxënësit të përgatiteshin në dy drejtime kryesore: të përdornin gjuhën me gojë e me shkrim dhe kontingjentet që do të vijonin më tej mësimet në shkolla të mesme, të kishin përgatitje të mjaftueshme për të përballuar planin mësimor në tërësi, sidomos lëndët e gjuhës shqipe dhe të letërsisë , referuar kështu programeve të gjuhës shqipe të viteve (1946-47).

2.2. Vitet ‘60-‘70 deri në vitet 2000

Në vitet ‘60-’70, mund të themi me bindje se gjuha shqipe ishte ndër lëndët themelore themelor në planin mësimor të ciklit fillor: 12 orë në klasat I dhe II, 13 orë në klasën III dhe 10 orë në klasën IV (Sipas planit mësimor të vitit 1963). Njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që fitojnë nxënësit në këto mësimet u hapin rrugën për njohuri të reja dhe ngjallin tek ata dashurinë për gjuhën amtare, për librin, për lexim. Referuar kështu programit të shkollës tetëvjeçare , (1963).

Po në vitin 1963, programi i gjuhës shqipe për klasat V-VIII shtronte para mësuesve kërkesa në rritje për zotërimin e gjuhës amtare nga nxënësit, veç të tjerash, edhe për studimin e gjuhëve të huaja. Në programi e atij viti ndër të tjera shkruhet se mësimet e gjuhës i bëjnë nxënësit të aftë të kuptojnë pasurinë dhe varietetin e madh të mjeteve për të shfaqur mendimet dhe ndjenjat e tyre. Ndër detyrat themeole të shkollës Një nga detyrat ishte përgatitja e njerëzve të kulturuar që dinë ta shkruajnë pa gabim dhe ta zotërojnë mirë gjuhën. Me bindje mund të themi se ky ishte synimi i të gjitha shkollave ku jepej Gjuha shqipe. Gjuha si lëndë mësimore, luajti një rol vendimtar për kryerjen e kësaj detyre.

Krahas kësaj, studimi i gjuhës, përceptohej si një faktor kyç në zhvillimin e të menduarit të nxënësve, duke qenë se shoqërohej me punë të vazhdueshme analitiko-sintetike, në procesin e së cilës kryehesin veprime të si: krahasimi, ndarja e tipareve esenciale të fenomeneve të studiuara, përgjithësimi dhe sistematizimi i materialit. Përveç kësaj njohja e gjuhës ishte një kusht i domosdoshëm paraprak për studimin me sukses të gjuhëve të huaja.

Referuar përsëri studiusit Rama (2003), Mësimi i gjuhës shqipe në këto vite, krahas kërkesave të shtruara në programet e mëparshme, e kthente vëmendjen në karakteristika të reja që duhet të merrte ky mësim. Disa prej të tyre, në thelb, synonin që fëmijët:

- ❖ të fitojnë aftësi e shprehë për të lexuar rrjedhshëm e me kuptim;
- ❖ të bëhen të aftë për punë mendore të pavarur;
- ❖ të kuptojnë pasurinë dhe varietetin e madh të mjeteve për të shfaqur mendimet dhe ndjenjat e tyre;
- ❖ të përpiqen për kulturën e të folurit.

Vlen të theksohet, që gjatë kësaj periudhe, u dhanë shenjat e para të futjes së frymës ideologjike edhe në lëndën e gjuhës shqipe: nxënësit duhet të kuptonin ëmbëlsinë, forcën dhe shprehësinë e gjuhës, gjë që do t'i ndihmonte në edukimin e patriotizmit . Krahas kësaj zotërimi i lirë i gjuhës konsiderohej si një kusht i domosdoshëm për të marrë pjesë aktive në ndërtimin e shoqërisë së re.

Në vitet '70 qëllimi i mësimit të gjuhës amtare nuk u shpëtoi politikës dhe ideologjisë së kohës. Referuar programit mësimor të vitit (1970) ,Gjuha shqipe ishte një nga lëndët më të

rëndësishme në ciklin e ulët të shkollës tetëvjeçare. Qëllimet kryesore të kësaj lënde në këtë etapë të parë janë: të njihen nxënësit me gjuhën letrare shqipe; të zotërojnë sa më thellë dhe praktikisht atë, duke u aftësuar në përdorimin drejt dhe me lehtësi të pasurisë gjuhësore dhe të mjeteve shprehëse të saj si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar; përmes tërë procesit mësimor të ngulisë praktikisht normat e gjuhës letrare shqipe; të ngjallë dhe të kultivojë dashurinë për gjuhën amtare... Për t'ia arritur qëllimit, është e domosdoshme që mësuesi të bëjë përpjekje të pandërprera për të ngritur nivelin e tij ideologjik e politik, për t'u ushqyer gjithnjë me të rejat e shkencës gjuhësore dhe për të përsosur vazhdimisht sistemin e tij të punës pedagogjike e metodike, duke mbajtur qëndrim krijues dhe kritik ndaj punës së tij.

Ndërsa programet e viteve '80 shtruan kërkesa të tjera, të tilla si: njohja, përvetësimi dhe zbatimi në praktikë i normës së gjuhës letrare .

Bazuar ne programet e fillim viteve 90-ta, orjentime e programeve të gjuhës shqipe dhe të leximit letrar fokusohen në zotërimin aktiv të gjuhës dhe letesise nga nxënësit, duke aplikuar edhe metoda strikte të normës drejtshkrimore e drejtshqiptimore, si dhe gjithmone dukle mos e lene anash përvetësimin dhe aplikimin e metodave themelore të gjuhës letrare ne nivel kombetare si dhe te asja ndekombetare. Referuar programit të Gjuhës shipe të vitit (1990), planifikimi kyç si orjentim prograsmore apo detyr e programit të ri të gjuhës shqipe për nivelin e shkollimit fillor është që të rritë nivelin e jo vetem të kërkesave të sotme mbi zotërimin aktiv të gjuhës sonë letrare nga ana e nxënësve por edhe nivlein e mesimedhenjese se kesaj fushe. Pra detyre shetese ishte qe nxensit te lene njohuri të mjaftueshme dhe të jene ne hap ne reformat ne pergjithesi që ndodhnin ne ate kohë, ku per asnje qaste të mos lihet anash gjuha, drejtshkrimi dhe drejtshqiperimi i saj.

Kjo lëndë formonte te nxënësit kulturën, mpreh intuitën, forcon arsyetimin, i mëson të bëjnë përgjithësime, ngulit te ata elemente të humanizmit dhe i bën të aftë për të gjykuar e vlerësuar në mënyrë të pavarur proceset historiko-letrare, dukuritë letrare-artistike dhe autorë e vepra letrare.

2.3. Pas vitit 2000

Vitet 2000 sollën një varg reformash arsimore, refroma këto që prekën sigurisht edhe lëndën e Gjuhës shqipe.

Në programin e lëndës së Gjuhës shqipe e vitit (2000) te rubrika *Synim shkruhej që* qëllimi përfundimtar i mësimit të gjuhës shqipe ishte alfabetizimi në kuptimin e përvetësimit më të mirë dhe më kreativ të të katër shprehive komunikuese gjuhësore. Këto katër kompetenca ishin:

të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit,

Sipas programit synohej ,gjithashtu, të arriheshin këto kompetenca:

- ❖ aftësi komunikuese me gojë dhe me shkrim
- ❖ njohuri për sistemin gjuhësor të shqipes
- ❖ qëndrime vlerësuese e vetvlerësuese

Ndryshe nga shqipëria, duhet të theksojmë se Kosova nuk arriti të kishte këto programe, dhe në këto rrethana ndikuan negativisht në mësimdhënien e Gjuhës shqipe, në trojet kosovare.

2.4. Abetarja, libri bazë i mësimit të gjuhës shqipe, fillimet e saj dhe Abetarja e përbashkët Shqipëri – Kosovë

Abetarja e parë e gjuhës shqipes, ashtu siç u përmend edhe më lart, ishte një libërth prej 8 faqesh, shkruar me një alfabet të veçantë.

Sigurisht si kontribuesi kryesor, nuk mund të lihet pa u përmendur N. Veqilharxhi, i cili u angazhua të hartonte abetaret për gjuhën shqipe, në një kohë kur nuk kishte një alfabet të vetëm të gjuhës sonë dhe nuk kishte shkolla në gjuhën amtare.

Abetarja e parë i përket vitit 1844. Një vit më vonë, më 1845, u botua abetarja e dytë me 50 faqe.

Duke njohur rrjedhat e gjuhes shqiper pase punen shume domethenese te Naum Veqilharxhit ishte rilindasi ynë i madh Kostandin Kristoforidhi, i cili në vitin 1867 berui një histori në vete kur botoi Abetare në dy dialektet e shqipes në gegërisht dhe një toskërisht. Epokën e re për librat shkollorë dhe përgatitjen e truallit për shkollën kombëtare e përgatiten figurat e njohura, si Jani Vreto, Sami Frashëri, Pashko Vasa dhe Koto Hoxhi, të cilët, gjatë periudhës

së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit botuan “Alfabetarja e gjuhës shqipe”. Më vonë, rruga e përpilimit dhe hartimit të Abetares shqipe kalon nëpër emra të njohur, të cilët punuan me përkushtim brenda dhe jashtë vendit. Ndër këto emra mund të përmendim: Luigj Gurakuqi (1905), Parashqevi Qiriazi (1906), Nikolla Lako (1906), Simon Shuteriqi (1911) etj. Në vitet e mëvonshme, studiues të tjerë u morën me abetaren, të tillë si: A. Xhuvani, Th. Papapano, M. Logoreci, J. Minga, duke krijuar kështu një traditë kombëtare.

Ishte vetëm pas vitit 1994, kur u arrit punimi i mirëfilltë shkencor i Abetares shqipe. Kjo përgatitje u vu mbi baza shkencore, pedagogjike e gjuhësore.

Parimet dhe metodologjia e hartimit të abetares kanë ndryshuar vazhdimisht, janë përzgjedhur e janë pasuruar, me qëllim përmirësimin e plotësimin e standardeve që duhet të përmbushë libri i parë i shkollës. Kështu, ndër vite, kanë qenë të ndryshme metodat për mësimin e lexim-shkrimit.

Metodisti K. Xhumari duke aplikuar është metoda analitiko-sintetike njëzet në historikun e Abetares si profesionisti që i qendroj më se shumti teksti e që u rezistoi më shumë kohëve, nga fundi i viteve '40 deri në fillim të viteve '90 të shekullit XX,

Në vitet 2000-2001, me procedura zyrtare, u organizua konkurs mbarëkombëtar për Abetaren mbarëkombëtare. Në përfundim të konkursit u shpallën fituese dy abetare: *Shkronjë pas shkronje* (me autorë M. Gjokutaj e Sh. Rrokaj) dhe *Abetare* e K. Xhumarit. Pas eksperimentimit paralel, u vlerësua fituese abetarja “Shkronjë pas shkronje”, por, në shkolla u zbatua abetarja tjetër. Në vitin shkollor 2004-2005, pas konkursit për tekste shkollore, të dy abetaret e sipërpërmendura u lejuan si tekste alternative.

2.4.1 Abetarja e përbashkët Shqipëri – Kosovë

Viti 2012 do të mbetet në historinë e mbarë kombit shqiptar, pasi për herë të parë u arrit, hartimi dhe miratimi zyrtar i Abetares së përbashkët Shqipëri – Kosovë. Ky tekst që per

shumë ke paraqitet si i shenjete duke pasur per baze vujtjet dhe rrugtuimin e saj u mundesua fale koordinimit ne mes dy ministrive të arsimit asaj të Republikës së Shqipëris dhe Kosovës. Hartimi i Abetares së përbashkët, vërtetoi faktin se edhe kur mungon një program i përbashkët, kapërcehen pengesat për të hartuar një tekst shkollor të përbashkët. Në komisionin e miratimit të Abetares së përbashkët u paraqitën shtatë tekste alternative, prej të cilave vetëm tri vazhduan garën në përputhje me standardet dhe kriteret e përcaktuara në paketën përkatëse. Abetarja e shtëpive botuese PEGI (Shqipëri) dhe DUKAGJINI (Kosovë) dalloi si më e arrira dhe u vlerësua me pikë maksimale.

Metoda bazë e hartimit të kësaj abetareje është metoda analitiko-sintetike e tingullit, e shoqëruar me metodën mikste. Në Abetaren e përbashkët gjejnë zbatim edhe metoda globale, por dhe metoda të mirëfillta analitike, si metoda e fjalëve dhe fjalive normale, dhe metoda të mirëfillta sintetike, si metoda e tingujve natyralë, metoda fonetike, metoda fonografike etj. Renditja e tingujve dhe e shkronjave në këtë Abetare është bërë në bazë të parimeve të metodologjisë bashkëkohore, siç janë: parimi fonetik (parimi i vështirësisë së shqiptimit të tingujve), parimi grafik (vështirësia e grafike e shkronjave) dhe parimi i dendurisë ose i frekuencës së përdorimit të tingujve në gjuhën e folur dhe të shkruar. Duke mësuar më parë tingujPërmbajtja e Abetares së përbashkët është bashkëkohore dhe në përshtatje me moshën e 6-vjeçarëve, me nivelin e zhvillimit të kulturës së tyre të të folurit dhe me veçoritë shqiptimore të gjuhës sonë në treva të ndryshme vendbanimi të shqiptarëve.

Libri “Abetare” dhe libri “Abetare pune” përmbushin objektivat e mësimit gjithëvjeter. Pasurimi i fjalorit të nxënësve dhe zhvillimi i të folurit të tyre ndihmohen edhe përmes përshkrimit të figurave dhe ilustrimeve të shumta, përmes metodës “Shiko dhe trego çfarë sheh”. Përmes Abetares së punës, nxënësit kryejnë shumë ushtrime gjuhësore për të zbërthyer e përvetësuar Abetaren.

Themi me bindje se Abetarja e përbashkët Shqipëri-Kosovë është shembulli më i mirë i bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore, autorëve e botuesve të të dy vendeve.

Përvoja me këtë abetare i hap rrugën procesit të përafrimit deri në njësim të programeve mësimore e teksteve shkollore edhe për lëndët e tjera, sidomos të lëndës së gjuhës shqipe.

2.4.2 Abetare të përdorura në shkollat shqiptare

Libri bazë i mësimimit të gjuhës shqipe, Abetarja, njohu një sërë botimesh në vite dhe shtëpi botimi të ndryshme.

Duhet të theksojmë periudhën rreth 170-vjeçare që nga botimi i “Ëvetar”-it. Listat jepen në tabelat 1, 2 dhe 3, të cilat përmbajnë vetëm abetaret e njohura zyrtarisht në Shqipëri, Kosovë, e diasporë.

Tabela 1. Abetaret e shkollave shtetërore shqiptare

Nr.	Titulli	Autori	Viti
1.	Abetari i vogël Shqyp	Anonim	1912
2.	Stërvitjetore për nxënësit shqiptarë	Nikolla Lako	1909-1915
3.	Kndime për shkollë t’para	Anonim	1914
4.	Abetari për Msoitore Fillore t’Shqypniis	Anonim	1915 - 1916
5.	Sillabario albanese- italiano	Marco la Piane	1917
6.	Shkëndilat e Para...	Thoma P. Pano	1919
7.	Abetare	Dhori Koti	1920
8.	Libër i parë...	Gaspër Beltoja	1921
9.	Abetari dhe	Mati Logoreci	1920
10.	Abetarja kombëtare shqip	Jani Minga	1920

11.	Abetaret për shkollat popullore Shqipe	Ndue Paluca	1921 - 1938
12.	Abetar për shkollat fillore të Shqipërisë	Aleksandër Xhuvani, Pertef Pogoni	1922 - 1939
13.	Abetare	Anonim (MA)	1946
14.	Abetare	Kolë Xhumari	1945-2009
15.	Abetare për të Rritur	Anonim	1945
16.	Shkronjë pas shkronje	M. Gjokutaj, Sh. Rrokaj	2001-2012
17.	Abetare		K. Xhumari
18.	Abetare	Bahri Beci	2011
19.	Abetare e përbashkët Shqipëri-Kosovë		M. Gjokutaj, Sh. Rrokaj, I. Krasniqi, S. Pozhegu 2012

Më poshtë jepen një tabelë me të dhëna mbi Abetaret e përdorura në Kosovë

Tabela 2. Abetare të përdoruru në Kosovë, në periudha të ndryshme

Nr.	Titulli	Autori	Vendi	Viti
1.	Abetare për të rritur	M. Gjevori, I. Riza, R. Shpendi	Prizren	1946
2.	Abetare	A. Dogani, K. Xheria. M. Dumani	Shkup	1946
3.	Abetare për klasën i të Shkollës Fillore	M. Gjevori, S. Kostari, J. Gjino	Beograd	1947
4.	Abetare për të rritur	M. Gjevori, I. Riza, R.	Beograd	1948

5.	Abetare për klasën i të shkollës Fillore	M. Gjevori, S. Kostari, J. Gjino	?	1948
6.	Abetare për klasën i të shkollës Fillore	M. Gjevori, S. Kostari, J. Gjino	Prishtinë	1950
7.	Abetare	M. Gjevori, J. Shushka	Beograd	1955
8.	Abetare...	Ramiz Hoxha	Prishtinë	1965
9.	Abetare...	Xhevat Gega	Shkup	1969
10.	Abetare	Mehmet Gjevori	Prishtinë	1974
11.	Abetare	Mehmetali Hoxha	Prishtinë	1977
12.	Abetare	Qamil Batalli	Prishtinë	1982
13.	Abetare	Gj. Gjokaj, F. Camaj	Podgoricë	1984
14.	Abetare	Qamil Batalli	Prishtinë	1987
15.	Abetare	Xhevat Gega	Shkup	1991
16.	Abetare	Gj. Gjokaj, F. Camaj	Podgoricë	1993

Në tabelën më poshtë jepen të dhëna mbi abetaret e përdorura në Diasporë, ku një pjesë e mirë e shqiptarëve të Kosovës jetojnë.

Tabela 3. Abetaret në diasporën e vjetër dhe të re shqiptare

Nr.	Titulli	Autori	Viti
1.	Abavator arbëror	Anastas Kullurioti	1882
2.	Abecedario	Jeronim de Rada	1896
3.	Abetari i të mërguemit	Shpend Bardhi (pseudonim: M. Merlika)	1952
4.	Abetare e posaçme për nxënësit shqiptarë jashtë Republikës së Shqipërisë	Urti Osmani	2011

2.5 Planet e ndryshme mësimore të përdorura në Kosovë.

Një çështje tjetër e rëndësishme në historinë e mësimit të gjuhës shqipe, e veçanërisht në Kosovë, janë planet e ndryshme mësimore nëperiudha të ndryshme. Kështu, në lidhje me këtë çështje mund të përmendim:

Planet austriake 1915-1918
Plani mësimor i Mbretërisë së Jugosllavisë, i detyruar të mësohej në gjuhën serbe 1918-1941;
Plani mësimor i Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë për gjuhën shqipe 1954-1951;
Plani i ri mësimor i pasluftës në Kosovë për lëndën gjuhë shqipe 1945-1946;
Plani mësimor për lëndën gjuhë amnore 1960;
Plani dhe programi mësimor për gjuhën amtare 1971;
Plani dhe programi mësimor për gjuhën amtare 1977;
Plani dhe programi mësimor për gjuhën dhe letërsinë shqipe i vitit 1985;
Plani dhe programi mësimor për gjuhën dhe letërsinë shqipe i vitit 1990.

2.5.1. Programi i gjuhës shqipe sot në Kosovë

Mësimi i gjuhës amtare në shkollat e Kosovës trajtohet si lëndë me karakter kombëtar. Kjo lëndë ka për synim krijimin e vetëdijes mbi rëndësinë e gjuhës dhe përvetësimin e saj të përshkallëzuar. Pikërisht, duke pasur parasysh këtë funksion u ndërtua edhe programi i kësaj lënde.

Ky program është organizuar në kuadër të kategorive: të dëgjuarit dhe të folurit; të lexuarit; të shkruarit dhe të nënkategorive: kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, kulturë e të lexuarit dhe kulturë e të shkruarit; tekste letrare dhe joletrare si dhe njohuri gjuhësore.

Në lidhje me synimin e lëndës, kemi shqyrtuar vetëm klasa të caktuara. Kështu, për klasën e dytë, synohet që nxënësi:

- Të përvetësojë dhe të zgjerojë mënyrat e komunikimit.
- Të përvetësojë dhe të thellojë njohurit themelore gjuhësore.
- Të kuptojë dhe të dallojë tekstet letrare dhe joletrare.

Për klasën e gjashtë, që në Kosovë i përket arsimit të mesëm të ulët, shënohet: “Qëllimi i mësimit të gjuhës shqipe në klasën e gjashtë është përforcimi dhe zhvillimi i njohurive të përvetësuara më parë, siç janë:

- Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit në situata të ndryshme.
 - Zhvillimi i kulturës gjuhësore dhe formimi kulturor.
 - Zhvillimi emocional, krijues dhe estetik përmes shkathtësive të komunikimit.
 - Zhvillimi i vetëbesimit dhe të menduarit e pavarur.
 - Zhvillimi i përdorimit të gjuhës letrare.Përgatitja e nxënësit për të mësuar gjatë gjithë jetës
- Në klasën e nëntë, që shënon mbarimin e arsimit të detyruar në Kosovë, lënda e gjuhës shqipe mësohet “me qëllim që nxënësi:

- Të përforcojë, të zhvillojë dhe të zbatojë shkathtësitë e komunikimit në shkollë dhe në situata të ndryshme jashtë shkollës.
- Të rrisë shkallën e analizës, të vlerësimit dhe të kritikës për tekstet letrare dhe joletrare.
- Të zotërojë dhe të praktikojë drejt njohuritë e sistemit gjuhësor.

Për klasën e trembëdhjetë, gjimnaz: “Qëllimi i mësimit të kësaj lënde në klasën e trembëdhjetë është që nxënësi:

- të rumbullakojë përfundimisht të arriturat nga klasat e mëparshme të shkollës së mesme të lartë;
- të fitojë aftësinë për analizë kritike të pavarur të teksteve dhe të fenomeneve kulturore;
- të komunikojë pavarësisht, në përputhje me standardet, me tekste letrare e joletrare;
- të komunikojë, duke arritur të artikulojë mendimin kritik, me modele e kultura të ndryshme etj.

2.6. Studime të huaja mbi Gjuhën Shqipe

Ndër studimet e huaja më relevante mbi gjuhën shqipe, pra në fushën e albanologjisë është ajo e shkollës gjermane, me kontributin më të madh të dhe studiutit të shquar Gustav Majeri.

Një tjetër vepër që flet për gjuhën shqipe daton në shekullin XVI, nga studiuesi gjerman: Konrad von Gesner (1555)

Më vonë, në shekullin e XVIII, del në skenë njëri prej filozofëve më të mëdhenj gjermanë dhe evropianë të kohës së tij, Gottfried Eilhelm Leibnitz (1705-1715), i cili ishte njëri prej popullarizuesve më të mëdhenj të prejardhjes së gjuhës shqipe, madje jo vetëm njëherë dhe në një rasë, por për më se njëzet vjet me radhë, ndërsa i po kësaj kohe është edhe kritiku e filozofi i madh gjerman Johan Gotfrid Fon Herder (1744-803), si edhe historiani Johan Erih Tunman (1746-1778)

Sigurisht ndër kontribuesit kryesor në studimin e gjuhës shqipe është bërë nga studiuesi i madh gjerman Hohann Georg von Hahn, i cili hodhi bazat materiale dhe shkencore, mbi të cilat u vunë themelet shkencore të albanologjisë.

Gjithë ky interesim dhe gjithë kjo punë për studimin e gjuhës shqipe edhe është pritur që do të kurorëzohet një ditë me rezultate të reja shkencore në fushë, jo vetëm të albanologjisë si shkencë, që po linte, por edhe në shkallë të ballkanologjisë dhe të indoevropianistikës në përgjithësi. Për të ndodhur kjo nuk është dashur shumë kohë.

KAPITULLI III

SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I TEZËS

3.1 Teoritë bazë

Kur flasim për mësimdhënien, natyrisht, na vijnë në mend shumë teori, por në këtë studim tri janë me rëndësi të përmenden:

1. Teoria Konstruktiviste

Kjo teori fokusohet në përgatitjen e nxënësve për të zgjidhur problemet në situata reale dhe shpesh të paqarta, nxënësit janë aktivë në mendimet e tyre. Në këtë proces të ndertimit të njohurive kanë rëndësi ndërveprimet sociale. Teoria Konstruktiviste qëndron në themele të shkencave të nxenit (shkencë e re ndërdisiplinore mbi të nxenit) e cila mbështetet në kërkimet në psikologji, arsim dhe shkencë. Vigotski ka theksuar idenë se ndërveprimi shoqëror, mjetet kulturore dhe aktiviteti formësojnë zhvillimin dhe të nxënësit individual. Duke marrë pjesë në një gamë të gjerë veprimtarish me të tjerët, nxënësit përvetësojnë rezultatet e përfutuara nga të punuarit së bashku; këto rezultate mund të përfshijnë si strategji të reja ashtu edhe njohuri të reja Konstruktivistet besojnë se nxënësit e ndërtojnë, ose të paktën interpretojnë, realitetin nisur nga perceptimet e tyre rreth përvojave që kanë. Fillet e konstruktivizmit mund të gjenden te teoritë e Piaget-it, Dewey-t, Bruner-it etj. (Garo, 2011:5).

2. Teoria sociale e të mësuarit

Në lidhje me bihevizmin në shkollë, lidhet *teoria sociale e të mësuarit*. Kjo teori është⁸ përpunuar nga Albert Bandura. Nga njëra anë, kjo është një teori e pastër biheviziste e imitimit, që bazohet në parimin se shumë nga sjelljet njerëzore formohen përmes imitimit të modelve të ndryshme. Nga ana tjetër, ajo është një *teori kognitiviste* se një dhe pranon

⁸ <https://sq.reoveme.com/si-punon-teoria-sociale-e-mesimit/>

rëndësinë e aftësisë që ka njeriu për të menduar, për të simbolizuar, për të ndjerë, për të parashikuar pasojat e caktuara. Është e vërtetë se përforcimi kontrollon shumë nga sjelljet tona. Por, sipas Bandurës përforcimi nuk na kontrollon në mënyrë të verbër. Efektet e përforcimit thotë Bandura varen shumë nga vetëdija e njeriut për marrëdhëniet mes sjelljeve të tij dhe pasojave të këtyre sjelljeve. P. sh, studentët studjojnë për provime. Në këto raste, përforcimi apo ndëshkimi ndodh shumë më pas sjelljes (d.m.th, pas studimit). Në këtë rast nuk është përforcimi ose ndëshkimi që ndikon sjelljen e studentëve në mënyrë direkte, por aftësia e studentëve që të parashikojnë pasojën e sjelljes së tyre. Teoria e Bandurës është një teori e të mësuarit përmes vëzhgimit. Kjo teori mund të përmblihet në mënyrë të shkurtuar.

2.2. **Format didaktike të mësimit**

Në mes të gramatikës së gjuhës shqipe si një sistem gramatikor (gramatika, stilistika) dhe zbatimin e saj (të shprehurit me gojë dhe me shkrim), pavarësisht nga ndërvarësia, mund të dallohen këto nëndisiplina: *Didaktika e gramatikës shqipe (në kuptimin e gjerë)*; *Didaktika e të shprehurit me gojë (retorikë)*; *Didaktika e të shprehurit me shkrim (shkrim-leximi dhe shkrim - krijim)*.

Didaktikat e tjera, krijohen në formë sistemi: “*Didaktika e fonetikës dhe fonologjisë; Didaktika e morfologjisë dhe fjalëformimit; Didaktika e sintaksës; Didaktika e leksikologjisë; Didaktika e stilistikës gjuhësor; Didaktika e të shprehurit me gojë (ars dicendi); Didaktika e të shprehurit me shkrim (ars scribendi)*” (Tezak, 1996, f. 14-16).

-



Fig. 3 Koncepti strukturorë teorik dhe praktikë i metodologjisë së mësimit

Studiuesit e ndryshëm vlerësojnë se metodat mësimore, janë një mënyrë shumë efektive në punën mësimore përmes ligjërimit dhe përvetësimit të diturive, të shprehive, si dhe të shkathtësive të ndryshme.

Metodat e mësimit, nuk janë shprehje e kohës sonë, ato përdoren që në Greqinë e lashtë. Filozofët e njohur Sokrati, Platoni dhe Aristoteli, u kanë kushtuar vëmendje të veçantë koncepteve dhe formave të procesve mësimore, si rrugë për arritjen e dijeve gjithëpërfshirëse. Por teknologjia e metodave nuk ishte e përhapur në epokën mesjetare. Ndërkaq, në epokat e mëvonshme dhe veçanërisht përgjatë shekullit XX reformat dhe përpjekjet e vazhdueshme për ngritje të cilësisë mësimore, janë prioritet i sistemit arsimor . Mësimi tradicional, është bazuar mbi këto kritere të përgatitjes së lëndës: 1. Shkoqitja dhe planifikimi i lëndës mësimore. 2.Përgatitja e mësuesit për orën mësimore. 3.Organizimi i orës mësimore. 4. Përpunimi i përmbajtjeve mësimore. 5. Përdorimi i mjeteve mësimore. 6. Zbatimi i metodave mësimore. 7. Mënyra e përfundimit të lëndës. 8. Përpunimi i lekturës. 9. Format e punës jashtëmësimore nga gjuha amtare etj. (Borzanoviq, 1979, f.4-5)

Përpjekjet e ndryshme, janë fokusuar në shtimin e vazhdueshëm të ideve dhe të përpjekjeve, të rritjes së cilësisë, konkurrencës, por edhe të përshtatjes së procesit mësimor me faktorë të tjerë human, shoqëror, kombëtar por edhe me zhvillimin socio-kulturor, ekonomik etj. 55

Agjensitë e ndryshme, institucionet arsimore etj., kanë këmbëngulur vazhdimisht në përdorimin e sa më shumë metodave mësimore në procesin edukativ – arsimor. Proceset e ndërvarme, si dhe zhvillimet industriale dhe teknologjike, fenomenet e shumta që janë aktuale kudo në botë, kanë rritur kërkesat e sistemit të arsimit dhe shkollës në shtimin e sa më shumë metodave mësimore. Në këtë kontekst, kjo ka ndikuar në bërjen e një kornizë të përdorimit të tyre. Në këtë aspekt, institucionet shkollore përcaktojnë me kujdes metodat e mësimdhënies që duhet të përdoren në shkolla, duke i sistemuar dhe zbatuar ato në bazë të kriterëve programore dhe planeve shkollore.

Nisur nga aspekti studimor tematik konstatojmë me të drejtë se metodologjitë e mësimdhënies në realitetin aktual të zhvillimit shumëdimensional të shoqërive dhe të kombeve, të shteteve të ndryshme, të sistemeve etj., janë prioritete jetike të mësimdhënies. Prandaj, veç rolit thelbësor që ka përdorimi i sa më shumë metodave pozitive lidhur me avancimin e procesit arsimor parauniversitar, shtrohet çështja edhe e formave dhe e mënyrave të planifikimit dhe të zbatimit të tyre.

2.3. Roli i mësimdhënësit

Mësimdhënsi ka pasur dhe vazhdon të ketë rolin kyç në mësimdhënien e gjithës shqipe. Roli tij ndër vite ka evoluar së bashku me evolimin e metodologjive. Hartimi i kurrikulave të reja, vitet e fundit, ka shtruar para institucioneve arsimore nevojën për kualifikimin e trajnimin e mësimdhënësve të ardhshëm, pasi vetëm njohës dhe përvetësues të mirë të këtyre planprogrameve do të jenë implementuesit apo realizues me adekuat të tyre. Referuar studiuesit Rama (2013), prlonesi arsimore gjithmone kerkon qe te jete në hap me proceset e reja dhe akomulimin e dijese dhe teknikave te avancuera dhe janë shumë të interesuar për ngritjen e tyre profesionale. Pjesëmarrja e gjerë dhe aktive në seminare kombëtare e lokale është njëri nga treguesit pozitivë. Mësuesit sot duhet të mësohet me përdorimin e metodave dhe strategjive të reja, detyrimisht duke u larguar nga praktika tradicionale të vjetruara e të paefektshme. Sot shtrohet kërkesa për teknologji dhe avancim në mësimdhënie bashkëkohore. Në këtë kontekst ai duhet t'u përgjigjet strukturës dhe përmbajtjes së kurrikulës . Kjo bëhet e mundur të duke realizuar forma të ndryshme të

punës mësimore, të tilla si (puna në grupe, në çifte, puna individuale etj.) dhe modeleve të ndryshme të mësimdhënies, të cilat vendosin në qendër të nxënësin dhe jo mësuesin. Ata duhet të marrin për bazë potencialet dhe aftësitë individuale të nxënësve, duke i përfshirë ata të gjithë në veprimtari të ndryshme mësimore. Kjo arrihet, sigurisht, me anë të përdorimit tëimodeleve alternative, të strategjive të larmishme, të formave të ndryshme mësimore, të metodave ndërvepruese, të programeve individuale etj. të cilat do të lehtësojnë procesin e të nxënësve tek të gjithë nxënësit.

3.4 Metodologjitë e mësimdhënies

Në lidhje me metodologjitë e mësimdhënies së gjuhës shqipe i kemi referuar një sërë studimesish, të tillë si Rama (2013), Zajazi (2003), Trendafil (2008) etj.

Gjithashtu nuk mund ta lëmë pa përmendur edhe një sërë burimesh të huaja, Banks (2000), Rather, A (2004), etj, të cilat do të citohen më hollësisht më poshtë.

Metodologjitë e mësimdhënies gërshetohen me realizimin e orës mësimore e cila padyshim që kushtëzohet nga një plan i përgatitur mirë lidhur me orën mësimore që përfshin: temën e mësimit, përmbajtjen e saj, cilësinë e realizimit të orës mësimore etj. Për secilën temë mësuesi duhet të përgatitet me shkrim lidhur me lëndën që e mban. Përgatitja e këtillë lidhur me temën e orës mësimore nuk nënkupton aplikim të metodologjive klasike. Përkundrazi, *“përgatitja e hartuar mirë për orën e mësimit, është predispozita bazë për realizimin me sukses të detyrave të planifikuara arsimoro-edukative.”* (Ristivojeviq, f. 7)

Struktura e përgatitjes me shkrim të mësuesit për orën e mësimit përmban:

1. Pjesën hyrëse. 2. Pjesën kryesore. 3. Pjesën përfundimtare të orës së mësimit.

1. Pjesa hyrëse e orës së mësimit fillon me përsëritjen e njohurive të fituara më parë në mënyrë që të plotësohet më lehtë lënda e re mësimore. Me një udhëheqje të mirë të mësuesit, nxënësit mund të nxjerrin vetë në fund me përsëritje emërtimin e temës së re të mësimit.

2. Pjesa kryesore e orës së mësimit.

Në pjesën kryesore të përgatitjes për orën e mësimit, *“mësuesi duhet të japë përmbajtjen e shkurtër të punës në orën e mësimit; ecurinë e orës së mësimit, zakonisht në formë tezash. Duhet të planifikohet edhe kur do të përdoren mjetet e parashikuara të mësimit gjatë orës së mësimit, cilat detyra do të punohen në formë probleme gjatë orës së mësimit etj., duke respektuar në këtë rast parimet didaktike të mësimitdhënies.”* (Po aty, f. 7)

3. Pjesën përfundimtare të orës së mësimit.

Gjatë procesit mësuesor, pra gjatë zhvillimit të lëndës mësimore, mësimitdhënia bashkëhore aplikohet përmes një procesi që përfshin kujtesën (përsëritjen – evokimin e mësimit), zbërthimin e temës, dhe reflektimin tematik.

Në studim më të thelluar të problemit, veprimi i parë përfshin përsëritjen, pra diskutimin e përmbajtjes së mësimit që zërthehet përmes disa pyetjeve elementare: Cila është tema? Çfarë dinë nxënësit rreth saj? Çka dëshirojnë nxënësit të mësojnë rreth temës? Duke i zberthyer këto pyetje, gradualisht arrihet që të shpaloset kuptimi i temës gjë që, kjo situatë mundëson shtim të informacioneve të reja, dhe një qartësim gjithnjë e më real kundrejt mësimit – temës! Në relacion me zberthimin e mëtutjeshëm, kërkohet që nxënësit të reflektojnë rreth temës, rreth përmbajtjes së saj, si pyetja: Çka kanë mësuar...? Pastaj, ata nxjerrin përgjigje dhe kundërpërgjigje nga dy fazat e lartpërmendura (të kujtuarit e përmbajtjes dhe reflektimi ndaj temës), duke ardhur deri te momenti – pyetja, se « Cilat janë argumentet kryesore që pasohen nga pyetja kontekstuale », “Përse mendoni kështu...?”

Gjatë zhvillimit të këtyre tri fazave të mbajtës së orës mësimore, bazuar në metodologjitë moderne dhe efikase të aplikimit të mësimitdhënies, si mjete - teknika përdoren:

Brainstormingu, kllasteri, parashikimi me terma paraprake, tryeza rrethore etj.

Në fazën e zberthimit të mëtutjeshëm të kuptimit tematik, përdoren këto teknika:

Inserti, di/dua të di/ të mësoj, leximi i orientuar, mësimitdhënia reciproke, të nxënës në bashkëpunim etj.

Në fazën e reflektimit, si teknika më të përshtatshme përdoren:

Ditari dy pjesësh, të menduarit, shkrimi i lirë, puna në dyshe, shkrimi i eseut, rrjeti i diskutimeve, shqyrtimi kategorizues etj.

Kundrejt sensibilizimit të motivimit dhe interesit të nxënësit për procesin mësimor dhe kundrejt aplikimit të sa më shumë metodologjive që do të kishin për qëllim aktivizimin dhe dinamizimin e nxënësit në klasë është me rëndësi që të synohet shkalla sa më e lartë e formësimit të personalitetit të nxënësit, rritja e shkallës së sigurisë së tij përballë lëndës mësimore, rritja e nivelit dhe e cilësisë së të shprehurit të nxënësit brenda procesit të mësimimit etj. Në këtë drejtim, si procesi dhe si metodologjia e mësimdhënies do të ishin në komparacion të duhur me “qëllimin dhe arsyen” e zhvillimit të procesit mësimor . Prandaj, vetëm atëherë kur “qëllimi dhe arsyeja” vendosen mbi informacione dhe mbi shpjegime të kuptueshme tematike, vetëm mund të konstatojmë se mësimdhënia e ka arritur qëllimin e saj.

3.4.1 Metodologjia e mësimdhënies e Gjuhës Shqipe

Aspekti menaxhues në procesin mësimor lidhet në radhë të parë me përgatitjet teorike dhe praktike që prej mësuesit e deri te nxënësi. Menaxhimi i mirë i klasës, mbajtja e disiplinës janë parakushte për mbarëvajtjen e një procesi që nuk është i lehtë, sidomos në kushtet kur brenda një klase mund të ketë 35-40 nxënës. Mësimdhënësit ballafaqohen me idenë se si t’i mbajnë nxënësit të përqëndruar e aktivë përgjatë mbajtjes së orës mësimore. Realizimi i objektivave mësimore nënkupton drejtimin dhe organizimin e procesit që lidhet me ndërtimin e marrëvdhënies të mira mësues – nxënës, me krijimin e besimit reciprok etj. Strategjitë për menaxhimin e duhur të procesit mësimor nënkuptojnë vrojtimin e përhershëm të nxënësit nga mësuesi, zhvillimin e tij, kujdesin deri në krijimin e shprehive të duhura. Mbikqyrja me vëmendje e klasës, pyetjet, bashkëpunimin, dhënien e ndihmës dhe përkrahjen e nxënësit, shmangien e ndonjë sjelljeje të keqe, tërheqjen e vëmendjes së nxënësit lidhur me lëndën mësimore etj, janë disa nga mënyrat se si duhet menaxhuar me përpikmëri procesi mësimor, ku mësimdhënsi duhet të jetë model për nxënësin.

Për aq sa mund të konkludojmë, gjuha shqipe si rrallë ndonjë gjuhë tjetër ka gëzuar një respekt të veçantë në shoqërinë tonë. Natyrisht, shkaqet dhe arsytet janë të ndryshme. Kemi folur lidhur me rrethanat dhe historinë e zhvillimit të germës dhe të shkollës shqipe. Në kontekst, si edhe çdo çështje apo çdo proces që i ka implikimet dhe problemet e veta të ndryshme, sidomos (sot) kur jetojmë brenda kohërave me dinamikë dhe me ndikime të paparashikueshme, s'ka dyshim që edhe gjuha shqipe vazhdon t'i ketë problemet e veta. E para, gjuha shqipe nuk është aspak një gjuhë e letë për t'u mësuar mirë dhe, me përkushtim. E dyta, ajo ballafaqohet me humbjen e prestigjit si një lëndë me prioritet për shkak të rrethanave socio – teknologjike, ekonomike, materiale etj.

Aplikimi i metodologjive si nevojë e zhvillimit dhe e avancimit të mësimdhënies në procesin shkollor në Kosovë, siç konstatuam edhe më lart, është pjesë e gjithë teknologjisë së mësimdhënies në procesin arsimor dhe në këtë drejtim, nuk bënë përjashtim as lënda e Gjuhës Shqipe. Përkundrazi, për ta kuptuar më drejt dhe më mirë rolin e mësimdhënies, themi që etimologjia e njohjes dhe e zgjerimit të më shumë njohurive gjuhësore (sintaksore dhe gramatikore), qëndron në përmbajtjet gjuhësore që lidhen me konceptet, me rregullat, ashtu si edhe me dallimet dhe me format e aplikimit të gjuhës, të standardeve të saj, qoftë më jetën private, dhe qoftë në atë publike.

Mësimdhënia si proces buron nga një program i hartuar mësimor, nga një plan i mirorganizuar që ka si objekt parësor një proces mësimor me objektiva të qartë. Pra, mësimdhënia është një proces i planifikuar që kushtëzohet me zbatimin efikas të planprogramit mësimor. Si e kuptojmë këtë proces ? E kuptojmë si: *1. Transmetim të njohurive të caktuara nga mësuesi tek nxënësi. 2. Organizim dhe drejtimi i punës me nxënësit.*

Përgatitja dhe koncepti zhvillimor i orës së mësimimit të lëndës së Gjuhës Shqipe në të shkuarën zhvillohej mbi këto kritere:

1.	<i>Hyrja dhe pjesa përgatitore e orës - kontrollimi i detyrave të shtëpisë,</i>
2.	<i>Pjesa kryesore e orës mësimore,</i>
3.	<i>Pjesa përfundimtare e orës mësimore,</i>
4.	<i>Dhënia e detyrave të shtëpisë,</i>
5.	<i>Përforcimi gojor dhe i tekstit.</i>

Këto metoda përdoren si në arsimin fillor dhe si në atë të mesëm. Konstatohet se teoria dhe praktika e këtyre të mësimdhënies ishte mjaft dogmatike dhe mbisundohej nga metodologjitë klasike të mësimdhënies. Pra, nuk kishte ndryshime, reforma, avancime të këtij procesi. Lidhur me metodologjitë e mësimdhënies zbatoheshin këto mënyra të procesit të zhvillimit të lëndës mësimore:

1. *Metodat e karakterit në formë monologu (ligjërimet e mësimdhënësit),*
2. *Metodat e karakterit në formë dialogu (bashkëbisedimi),*
3. *Metoda e shpjegimit të tekstit,*
4. *Metoda e demonstrimit – konkretizimit të mësimin,*
5. *Vëzhgimi i fakteve dhe të dhënave gjuhësore.*

Në procesin e mësimdhënies është e domodoshme që mësuesi (arsimtari – pedagogu) të ketë si pikësynim objektivin që në vetëdijen e nxënësit të nxisë (në kontekstin pozitiv) motivimin – shtytjen për të mësuar, në rastin tonë, për ta respektuar dhe trajtuar këtë lëndë me dashuri të veçantë. Mund të konstatoj se qëllimi i përdorimit të metodologjive të ndryshme e ka edhe këtë pikësynim si shumë të tjerë sepse ka rëndësi specifike që nxënësit të jenë vazhdimisht të motivuar dhe të nxitur kundrejt lëndës dhe procesit mësimor.

Pra, kërkohet që mësuesi lidhur me procesin e zhvillimit të lëndës t'i shprehë sa më shumë aftësitë e tij përballë zbërthimit të lëndës, të jetë sa më profesional në mënyrë që të nxisë tek nxënësi sa më shumë motiv, përkushtim, dashuri etj, në mësimin dhe njohjen e lëndës. Në kontekst, i veçojmë disa forma produktive dhe strategjike në organizimin e procesit mësimor në klasë:

- *Formën ballore të zhvillimit të procesit mësimor me gjithë klasën,*
- *Formën individuale të organizimit të punës mësimore,*
- *Formën e zhvillimit të mësimin në çifte,*
- *Formën e zhvillimit të mësimin në grupe.*

Sigurisht, nuk mund të lëmë pa veçuar këta tri metoda tradicionale të mësimdhënies:

1. *Metoda verbalo-tekstuale.*
2. *Metoda ilustrativo – demonstruese.*
3. *Metoda laboratoriko-eksperimentale*

Mësimdhënia e Gjuhës Shqipe në periudhat e ndryshme historike ka pasur si objektiv kontributin e zhvillimit të gjuhës shqipe - në të folur dhe në të shkruar. Sipas Ukella (1977), procesi i mësimin zanafillor i lëndës së Gjuhës Shqipe fillon me mësimin e të shkruarit të shkronjave. Mbasi që mësohen shkronjat, domethënë kur përfundon etapa e tretë e programit që lidhet me abetaren, nxënësi arrinë t'i lexojë 50, deri në 60 fjalë brenda një minute. Gjatë leximit, kërkohet që nxënësi t'i respektojë shenjat e pikësimit. Metodologjitë e reja, sugjerojnë që gjatë zbatimit të programit të abetares, nxënësi të jetë në qendër të procesit mësimor. Për ta arritur këtë objektiv metodologjik, kërkohet që gjatë punës mësimore për realizimin e objektivave për lëndën Gjuha shqipe 1, të zbatohen veprimtari të ndryshme mësimore.

Në bazë të avancimit të programeve dhe të metodave të mësimdhënies në Kosovë është përdorur metoda zanore-analitike-sintetike e mësimin të shkronjave dhe e mësimin të të lexuarit të abetares. Kjo metodë është e përkrahur nga shumë ekspertë, nga mësuesit por edhe nga institucionet profesionale, ato pedagogjike etj.

Metoda e quajtur “zanore”, ka të bëjë me shqiptimin e drejtë të zërave (tingujve).

Metoda analitike, ka të bëjë me analizën e tregimit (përmbajtjes së tekstit), të fjalës, të fjalisë.

Metoda sintetike, ja të bëjë me sintezën e tingujve gjatë shqiptimit të ngadalshëm të fjalëve, në fakt, gjatë leximit të ngadalshëm të shkronjave që formojnë një fjalë, apo gjatë shkrimit të shkronjave që përmes fjalëve formojnë fjali, dhe fjalitë formojnë tekst.

Përdorimi i sinkronizuar i metodave të ndryshme, është me rëndësi primare për të siguruar që nxënësit të lexojnë bukur dhe pa gabime, të shkruajn mirë dhe drejtë. Si mësohej programi i abetares?

Ukella (1997).Shembull: Metodrat, janë të ndërlidhura mes tyre në mënyrë që të arrihet efikasiteti i mësimdhënies. Procesi i mësimi të shkronjave, pas zhvillimit pozitiv të tij, është përcjellë pastaj me biseda të lira në klasë, me lexim dhe zërtim të tregimeve, të vjershave etj., dhe të cilat, u janë përgjigjur aftësive psiko-fizike të nxënësve. Këto relacione interaktive në klasë, kanë përmbajtje të pranueshme, të këndshme, të konkretizohet me fotografi dhe ilustrime.⁹ Në proces të mëtutjeshëm të zërtimit të procesit mësimor , nga tregimet nxirren fjalitë, që janë pjesë e tregimit. Fjalitë, na njeh me personazhet e tregimit, që kryesisht janë: njerëzit, kafshët, sendet. Fjalitë e nxjerrë nga tregimi, shoqërohet me figuracione – vizatime.

Shqiptimi i fjalive përcillet me shqiptime - theksime të lehta, në mënyrë që të kenë mundësi zgjatjeje të zërit në të shqiptuar, dhe që tingujt të mos jenë shpërthyes: “t, p, k...” etj. Shembull: kur shqiptohet apo mësohet shkronja "n", zakonisht merret fjala "nënë", si për t'u dalluar dhe si për t'u shqiptuar më lehtë germa - fjala. Kjo, përcillet edhe me fotografi në librin e abetares. Shqiptimi, është i ngadalshëm, i kujdesshëm, si: "nnnëënnnaaa".

Nga aspekti figurativ i analizës, disa ekspertë të metodologjive, tregimin e paraqesin si një “dru” i madh, fjalinë me degë e trashë, kurse fjalën dhe tingujt i krahasonin me degë me të holla (Udhëzime metodike, 1978, f. 7). Kjo mënyrë e të krahasuarit, nuk ishte adekuate. Krahasimi më adekuat, bëhej me anë të vijave: për shembull, një fjalë personifikohej me shumë vija, me dy tri vija, me një vijë të shkurtër, kurse tingulli shprehej përmes pikave. Mënyra e paraqitjes grafike, ndikon që fëmija të njihet me korinzën logjike të tregimit (fjala), me një segment të tërësisë logjike të tregimit dhe me personazhin e tregimit (fjalitë), si dhe me elementet e fjalës (tingujt).

⁹Sadik Ukella: Diskutim nga tryeza e organizuar nga revista arsimore “Shkëndia”. Raport i botuar në revistën “Shkëndija”, nr. 18. Datë: 1. 11. 1977. (Sadik Ukella, kishte hartues i mjetit mësimor të emërtuar si “Racionalizator”, që përfshinte ilustrime, mjete, figura për konkretizimin e mësimi të shkrim-leximit. Racionalizatori, i specifikuar për përdorim shkollorë, u përdor disa dekada në Kosovë)

Në vazhdim, do t'i shpjegojmë tri lloje të metodave të përdorura në ciklin fillestar të mësimin fillor të cilat, u aplikuan në Kosovë qysh prej viteve të 70-ta të shekullit të kaluar. Si më poshtë, po e japim një shpjegim të shkurtër për disa prej tyre:

1. Metoda e zanoreve: Shqiptimi i zanoreve, konsiderohet si më i lehtë nga nxënësit. Pra, shqiptimin e tyre ata mund ta arrijnë më lehtë, dhe në formë të përsëritjes, ata e dëgjojnë prej secilit nxënës në klasë. Shqiptimi i zanoreve, bëhet në formë të tingujve - këndimit dhe duke bërë edhe leximin e fjalëve të shkurta, por me kusht që nxënësit të mos e zgjasin shumë zërin në formë të këndimit, sepse kështu deformohet fjala. Pse kjo metodë, është quajtur metodë zanore-analitike-sintetike? Është quajtur metodë zanore ngase, kishte të bënte me shqiptimin e drejtë të zërave (tingujve), analitike sepse lidhej me analizën e temës - tregimit (përmbajtjes së tekstit), dhe quhej sintetike, ngase lidhej me sintezën e tingujve gjatë shqiptimit të fjalëve, leximit (Udhëzime metodike, 1978, f. 7).

2. Metoda fonetike, përdoret gjatë mësimin të të gjitha shkronjave. Përvetësimi dhe shqiptimi i drejtë i shkronjave, është i varur nga konkretizimi i pozitës së gojës gjatë kohës kur kryhet shqiptimi i shkronjave. Prandaj, mënyra e pozicionimit të gojës kur shqiptohet një zanore e gjuhës shqipe, ka rëndësi të theksuar. Gjatë procesit të mësimin dhe shqiptimit të shkronjave dhe të fjalëve, nxënësit njihen me disa elemente të fonetikës. Pse? Nxënësi, e fiton njohurinë se si ta mendojë pozitën e gojës gjatë zhvillimit të shkronjës, gje gjësisht gjatë praktikimit të tingullit! Nga ky proces mësimin, nxënësi e kupton se gjatë shqiptimit të 36 shkronja, pozicioni i gojës pëson 36 pozicione të ndryshme. Aktiviteti mësimor dhe shkathtësitë pedagogjiko-metodike të mësuesit në klasë, ndikojnë që nxënësit t'i njohin dhe t'i dallojnë tingujt e nevojshëm që shfaqen si rezultat i shqiptimit të shkronjave të caktuara.

3. Metoda e zërave normalë, është një metodë e përdorur për të gjitha zanoret dhe për të gjitha bashkëtingëlloret. Nuk konsiderohet si një metodë që ka pasur sukses...! Ekspertët, kanë tenuar t'i marrin si shembuj adekuat zërat dhe bashkëtingëlloret që i kanë lëshuar njerëzit duke i krahasuar me të kafshëve, pastaj zukatja e bletëve (zz-zz...), mirëpo “zërat e kafshëve dhe të insekteve), nuk i përgjigjet të folurit të njeriut dhe për këtë, nuk mund të llogarisim se zërat e tyre, janë zëra normalë.

4. Metoda fonografike, lidhet me atë kur forma e shkronjës, sinkronizohet në kuptimin figurativ, me një objekt-figurë të ngjashme: për shembull, shkronjën "o", e krahasojmë me rrotën, ose me ndonjë rreth etj.

5. Metoda e internjeksionit, është një lloj metode që buron nga metoda e "zërave normalë" dhe, e metodës fonomimike. Kjo, mund të përdoret vetëm për disa shkronja, për shembull, kur jemi te shkronja "F" e madhe e shtypit, nxënësi, përmes mbajtjes së trupit drejtë, e zgjatë njëren dorë në pozitë horizontale (më shumë), dhe njëren dorë më pak. Në këtë mënyrë, nxënësi arrinë ta formojë këtë shkronjë në mënyrë figurative.

6. Metoda e tekstit ose metoda e Jocotit, është një metodë që mbështetet në faktin se çdo tingull apo çdo shkronjë e re që mësohet në procesin mësimor, duhet të gjendet në brendinë e tekstit të abetares. Në kontekst, lidhur me shkronjën që mësohet, duhet të gjendet edhe teksti adekuat i cili, hartohet me qëllim të përdorimit sa më të theksuar të shkronjës dhe tingullit.

7. Metoda e fjalive normale, është ajo metodë që kërkon nga mësuesi t'i thellojë tek nxënësit njohuritë dhe përvojat për fjalinë, e të cilat nxirren prej tërësisë së tregimit. Pavarësisht prej fjalive që ka në tekst, mësuesi mund të krijoj fjali të reja në lidhje me protagonistët e tregimit. Fjala normale duhet të jetë më e afërt, më konkrete dhe më e kuptueshme në mënyrë që nxënësit ta kenë më të qartë ngjajën, tregimin, fabulën e mësimin të cilin, mësuesi e paraqetë në klasë! Fjala normale, mund të konsiderohet edhe si simbol i ngjarjes së konkretizuar përmes aplikacionit, përmes tablos etj.

Referuar Rather, A, (2004), aplikimi i sa më shumë metodologjive e rrit interesimin e nxënësit përgjatë procesit mësimor si dhe ndihmon në forma dhe mënyra të ndryshme avancimin e procesit mësimor. Nisur nga aspekti i procesit, secili nxënës aktivizohet në mësim. Prosesi mësimor, do të jetë më i suksesshëm, nëse tek nxënësit vihen në veprim të gjitha shqisat, shqisa e të parit, e të dëgjuarit, e të prekurit, kur nxënësit mund t'i prekin sendet ose mund të manovrojnë me to, shqisa e ndjesisë etj. (Po aty, f. 5)

Mësimdhënia e drejtpërdrejtë – tradicionale

Metodat përfshijnë

Mësimdhënie mirë e strukturuar	Mësimdhënie
Aksionale	
Mësimdhënie e hollësishme	Vështrim i strukturuar
E hollësishme	Ushtrime dhe
Praktikë	
Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë	Metodat përfshijnë
Ka në qendër nxënësin	I bazuar në pyetje
U jep nxënësve mundësinë për të marrë vendime	I bazuar në probleme
Për të bërë zgjidhje	Të nxënit e pavarur
Marrëdhënia ndërvepruese	Metodat përfshijnë
Mbështet nxënësit në të punuarit në bashkëpunim	Diskutime me gjithë klasën
dhe produktivisht në të nxënit aktiv me material	Të nxënit në bashkëpunim
të ndryshëm	Të nxënit me një
Partner	
Marrëdhënia e bazuar në përvojë	Metodat përfshijnë
U mundëson nxënësve të mësojnë dhe të	Eksperiencë në fushë
konstruktojnë kuptimin me anë	Stimulim
të shembujve	Lojë me role -
Dramatizime	

Figura 4: Shumëllojshmëria e modaliteteve të mësimdhënies: “Dimension of Teaching and Learning Branch”

Çështjet që lidhen me përdorimin e shqisave janë thelbësore sepse është me rëndësi që nxënësi veç të dëgjuarit e shpjegimit të lëndës, të mënyrës së shpjegimit, bërjes së detyrave, të ushtrimeve etj., ta mbajë në mend thelbin e lëndës dhe ta regjistrojë në kujtesën e tij. Janë të rëndësishme, dy forma të procesit të kujtesës kundrejt mësimnxënies:

1. Kujtesa afatshkurtër: Për t'ia arritur këtij qëllimi, nxënësi duhet të jetë aktiv në proces, të jetë i vëmendshëm ndaj asaj që dëgjon dhe mëson, sepse në këtë mënyrë ai arrin që në planin afatshkurtër të mbajë mend thelbin e mësimit. Ndonëse kemi të bëjmë me mbamendje të kufizuar ose me mbajtne mend të një pjesë të caktuar të sasisë mësimore, kjo ka rëndësi që pjesë të caktuara të mësimit të mbahen mend nga nxënësi si një mënyrë e shpërfaqjes së dijeve nga procesi mësimor .
2. Kujtesa afatgjatë: Në mënyrë që informacioni të mbahet mend sa më gjatë dhe në më shumë pjesë, ai ka nevojë të kodifikohet në mënyrë që të ruhet. Por, kjo mënyrë e të mësuarit apo e të nxënëit të mësimit, ndryshe nga e kaluara, për shkak të shumësisë së informacioneve dhe komunikimeve përtej lëndore, nuk preferohet aq shumë. Strategjita e mësimit sot, ndryshe nga e kaluara, është të kuptuarit e thelbit të mësimit: kuptimi ideve kryesore të mësimit, dhe lidhja e tij me pjesët më pak të rëndësishme dhe kjo bëhet përmes aplikimit tabelarë të konceptit të mësimit.

Nga shumë studime të bëra, reflektojnë një mori faktesh se procesi mësimor është një proces i organizuar – i planifikuar me qëllime të caktuara. Dhe se përmes këtij procesi, transmetohen njohuri tek nxënësi. Në konceptimin dhe në zbatimin e drejtë dhe efikas të procesit mësimor, planprogramet mësimore mbështeten në objektiva të ndryshëm metodologjik. Banks (2001), thekson se mësimdhënia është një proces aktiv, ku *“një person e ndanë informacionin me të tjerët për t'i pajisur ata me njohuri të cilat qojnë në ndryshimin e sjelljes”* (Banks, 2000, f. 1)

Ndërsa eksperti i problemit të mësimdhënies Rather, thekson se *“mësimdhënia është një proces tripolar, e që përfshinë mësimdhënësin, nxënësin dhe situatën e të mësuarit, dhe që qon në ndryshimin e sjelljes së nxënësit”* (Rather, 2004, f. 5).

Disa lëndë, janë të atilla që kërkojnë të nxihen, të përvetësohen dhe të plotësohen jo vetëm në mënyrë të kufizuar, pra, jo vetëm brenda mureve të klasës. Për të realizuar synimet e

mësimdhënies, duhet pasur qëllime dhe objektiva të qartë dhe që i shërbejnë edukimit – arsimimit të nxënësve. Profesori i njohur, Bedri Jaka (2004), në analizë dhe studim të proceseve mësimore thekson: *“Objektivitet mësimor dhe qëllimet arsimore nuk janë e njëjta gjë, ata janë të veçuar midis tyre. Nocioni i objektivitet mësimor është lloj i nocionit qëllimi arsimor, përkatësisht, i pari është i futur në të dytin.”*¹⁰

Në elaborim të mëtejshëm Jaka thotë: *“Qëllimet arsimore janë synime të përgjithshme, afatgjata, realizimi i të cilave varet nga bashkëveprimi i faktorit njeri me faktorë të tjerë. Të zëmë : “Si ti përgatisim fëmijët për një jetë të suksesshme dhe frutdhënëse, të cilën në horizont nuk mund ta shohin”!* Kurse, objektivat mësimor janë synime të veçanta, afatshkurtër, të cilët planifikohen së realizuari brendapërbrenda orës mësimore. Ato janë ecuri të prekshme, të cilat do duhej t’i demonstrojë dhe t’i mbrojë nxënësi , si produkt i të nxënësit.”¹¹

3.4.2 Metodologjia e vlerësimit të nxënësit

Në shkollimin parauniversitar në Kosovë institucioni i shkollës luan një rol të fuqishëm në edukimin e nxënësve, prandaj procesi edukativ – arsimor ka si pikësynim që nxënësi hap pas hapi të arrijë formësim shoqëror, social, profesional, shkencor dhe akademik etj. Në kostelacion me rolin e gjuhës, përgatitja edukative dhe mësimore e nxënësit, përbën një nga angazhimet dhe detyrimet kryesore të shkollimit fillor dhe të mesëm. Mësimdhënia si proces i organizuar sipas kornizës së planifikuar mbi program të qartë mësimor dhe, nevoja e nxënies së mësimimit nga vetë nxënësi, janë dy modele të të njëjtit proces. Prosesi i këtillë (mësimdhënia-të nxënësit), mundëson përvetësimin gradual të programit mësimor nga nxënësi.

Roli i mësuesit në procesin e mësimdhënies: Në anën tjetër duhet të konstatojmë pa ndonjë hezitim se fushë-veprimtaria e zhvillimit të procesit mësimor është tejet komplekse. Prosesi mësimor s’ka dyshim që shtrihet në relacione dhe marrëdhënie direkte mes mësimdhënësit dhe nxënësit dhe anasjelltas. Aktiviteti i mësuesit shprehet në realizimin e planprogramit

¹⁰ www.bedri-jaka.com

¹¹ Po aty.

mësimor, në zbatimin e procesit të mësimimit me përkushtim, me qartësi dhe duke aplikuar sa më shumë metoda të mësimdhënies. Mësimdhënësit e përkushtuar dhe profesionalisht të përgatitur, kompetent në procesin edukativ – arsimor , janë të interesuar që të aplikojnë më shumë metodologji të mësimdhënies, krahasuar me mësimdhënësit që janë më pak të përkushtuar dhe profesionalisht më pak të përgatitur në kuadër të procesit mësimor .

Mësimdhënia e përkushtuar dhe profesionale, është ajo që lehtëson procesin e të nxënimit të mësimimit nga nxënësi përmes realizimit të strategjive të ndryshme (të përshtatshme) përmes formave, metodave, mjeteve adekuate që ndikojnë jo vetëm në mbarëvajtjen e procesit, por edhe në “ndërrimin” e rolit i nxënësit dhe të mësimdhënësit, e ku nxënësi bëhet aktori kryesor (subjekti aktiv), dhe nuk qëndron si një spektator i thjeshtë. (subjekt pasiv)

Realizimi i strategjive efikase përmes formave, metodave, teknikave të ndryshme në zhvillimin e procesit mësimor mundëson vazhdimisht alternativa të ndryshme në zhvillimin e procesit të të nxënimit të mësimimit nga nxënësi dhe kjo, ndikon që nxënësi t’i zhvillojë aftësitë ndërvepruese - komunikative dhe nxisë diversitetin dhe kreativitetin e nxënësit në procesin e nxënies së mësimimit.

Mësimdhënia e gjuhës shqipe, veç lidhjes me rolin primar të mësuesit, siguron strategjinë e të mësuarit teorik dhe praktik të gjuhës, përmes përshtatjes së lëndës me moshën dhe njohuritë e nxënësve si dhe me karakterin e tyre psikologjik etj. Lënda e gjuhës shqipe, po ashtu, siguron edhe përvetësimin e nocioneve gjuhësore, njohjen e norëms së drejtshkrimit Vlerësimi i nxënësit: Mësimdhënia si proces vlerësimi në kuptimin klasik të fjalës, është proces ose veprim që mësuesi, bazuar në planprogramin mësimor e zbaton kundrejt procesit gjithë shkollor. Përmes vlerësimit, maten njohuritë dhe rezultetet e nxënësit. Natyrisht, matjet bëhen individualisht, si edhe për çdo nxënësi. Në literaturën bashkëkohore apo në praktikën e vlerësimit, ne hasim termet “vlerësim”, “matje e diturisë”, “vlerësim i suksesit” etj. Edhe pse këto terme nuk janë adekuate me njëra-tjetrën ngase, variojnë me kuptime të ndryshme (nuk janë sinonime), përdoren në fjalorin vlerësues të mësuesve. Në kuptimin e përgjithshëm, fjala “matje” nënkupton peshim e diçkahes, të një sasi të caktuar të produktit, pastaj nënkupton matjen e trupit fizik, të temperaturës, të vëllimit të ndonjë objekti etj.

Matjet, janë të ndryshme: fizike-peshuese, shëndetësore, administrative, kërkimore – shkencore, etj. Ndërsa, me matjen në arsim, nënkuptojmë grumbullimin, vlerësimin, peshimin e aktivitetit të rregullt të nxënësit në procesin lëndorë, apo mësimor (matja e veçantë - për një lëndë; matja e përgjithshme - për të gjitha lëndët). Në kontekst, vlerësimi apo matja e diturisë së nxënësit, është proces i gjyqimit të mësuesit kundrejt sjelljes dhe suksesit të arritur të nxënësit, përmes vlerësimit-notimit. Procesi i vlerësimit të nxënësit, ndodh gjatë tërë procesit mësimor , dhe gjithashtu, në fund të procesit mësimor .

Procesi i vlerësimit në lëndën e Gjuhës Shqipe, përfshinë matjen periodike të diturive – dijeve të nxënësit. Disa prej vlerësimeve apo matjeve të rëndomta (të thjeshta) të njohurive të nxënësve, janë: përsëritja e mësimit nga ana e nxënësit në fund të shpjegimit të temës së lëndës nga mësuesi, pjesëmarrja e nxënësit në aktivitetet ushtrimore, kryerja e detyrave me rregull etj. Referuar programit nga MASHT (2017), ekzistojnë forma të ndryshme vlerësimi.

Testimi: Teknikat kryesore të vlerësimit të njohurive të nxënësit, janë: testet. Testet, konsiderohen si vlerësime apo matje lidhur me shkallën e njohurive të nxënësit kundrejt lëndës së shpjeguar përgjatë periudhave të caktuara shkollore, janë instrumente apo teknika të caktuara – adekuate. Sipas kësaj metode të vlerësimit, llojet e testeve janë: testet verbale, joverbale, të njohurive, të aftësive, testet përmbledhëse etj. Testet, ndërtohen nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve. Përgjigjet, mund të jenë: alternative, të kombinuara, me shumë alternativa, me përgjigje të shkurtëra. Si instrumentë vlerësues është edhe ese etj. Vlerësimi i testit bëhet nëpërmes përgjigjes së saktë, përgjigjes negative (kur gjedet përgjigja e gabuar në mes të një, apo dy përgjigjeve të sakta), përgjigja më e saktë në mesin e dy, apo tri përgjigjeve të sakta, si dhe me anë të pikëve të mbledhura.

Në metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës shqipe, zakonisht përdoret testi që siguron për nxënësit përgjigje të saktë, në mesin e dy apo tri përgjigjeve të gabuara. Gjithashtu, preferohen edhe testet me shumë alternativa, varësisht se si e sheh rolin dhe arsyeshmërinë e tyre një mësimdhënës i kësaj lënde.

1. *Test me përgjigje alternative*

Pyetja:

1. A është e drejtë që institucionet administrative, mediat, gjykatat etj., të mos ken lektorë ?	
Përgjigja:	
a) E drejtë	b) E gabuar
a) Po	b) Jo
a) E vërtetë	b) E gabuar
Përgjigja që konsiderohet si më e sakta, rrethohet me laps	

2. *Test me përgjigje të shkurtëra dhe me plotësim*

Shembull:
Gramatikën e parë të gjuhës shqipe e hartoi.....në vitin.....
<i>3. Test me përgjigje të zgjeruar</i>
Shembull:
Shkruani 3 folje dhe 3 mbiemra
1.....2.....3.....
4.....5.....6.....

Figura 5. Forme testi në lëndën e Gjuhës shqipe.

Vlerësimi përmes vrojtimit: Jo i gjithë procesi i vlerësimit, konsiderohet si adekuat nga vlerësimet e mësimdhënësit. Mësimdhënësi në procesin e vlerësimit merr për bazë aktivitetin e nxënësit përgjatë procesit mësimor: pjesëmarrjen në bashkëbisedim lidhur me lëndën (temën e shpjeguar), cilësia e realizimit të detyrave, eseve, shkathtësistë e të shprehur, puna në grupe etj. Si realizohet metoda e vrojtimit ?

Vrojtimi mund të jetë i drejtpëdrejtë dhe realizohet përmes:

- Katalogut të pjesëmarrjes së nxënësit në grup: roli i tij, mënyra e bashkëpunimit, pjesëmarrja në diskutim etj.
- Listës së kontrollit që, ndërtohet përmes termave: objektivi, njohuria, shkathtësia, oratoria etj., përmes të cilëve, nxënësi vrojtohet nga mësuesi në mënyrën se si ai po zhvillohet, si po i përmbushë obligimet, detyrat, sa po e zgjeron diapazonin e njohurive mësimore etj.
- Shkallës vlerësuese, nënkupton stadin e nivelit kur mësuesi arrinë që të vlerësoj dallueshmëritë mes nxënësve etj.
- Dosja e nxënësit është shumë atraktive për nxënësin dhe shumë e dobishme për mesimdhënsin për vlerësim, ajo përmbanë aktivitetin e nxënësit, punën e tij etj ditore, javore dhe mujore, dhe kjo përbën një metodë moderne – por shumë adekuate në matjen e dijeve dhe të cilësisë së nxënësit.
- Pritshmëritë e mesimdhënsit, një mënyrë e vrotimit përmes së cilës, mësuesi duhet që të mbështetet në fakte dhe rezultatet konkrete, në mënyrë që pritjet të jenë të përmbushura, dhe jo në dëshira...Pra, mesimdhënësi përmes rezultateve vrotuese, mund ta ketë një pasqyrë më të qartë për secilin nxënës, bazuar në aktivitetet dhe shkathtësitë që ata kanë dhe kështu, pritshmëritë e tij të jenë të arritshme.

3.4.3 Metodologjia e punës praktike

Mësimdhënia si proces sot kërkon qasje jashtëzakonisht elastike dhe në përputhje me planifikimet dhe programet shkollore.

Problemet e cilësisë mësimore: Puna praktike e nxënësve, sidomos në shkollimin e mësim të ulët, zhvillohet në klasë dhe për këtë, shfrytëzohen kabinete të ndryshme me qëllim të

nxënies së mësim, rritjes së efikasitetit, të cilësisë. Metodologjitë e punës praktike, janë të lidhura dhe të ndërlidhura me idetë dhe me konceptet që sigurojnë përmbajtje cilësore të arritjeve sa më pozitive në procesin mësimor. Sepse, puna praktike, konsiderohet si kreative dhe shërben për t'i zgjëruar njohuritë në lidhmëri me teorinë mësimore, me përvojën, me intelegjencën e nxënësit, me kujdesin e punës së mësimdhënsve etj.

Metodologjia praktike e mësimdhënies, i sensibilizon përvojat e organizuara të diturive, shkathtësitë mendore, ato kreative – prodhuese. Efikasiteti dhe cilësia e nxënësit në mësim, qëndron në përsosjen e procesit dhe të modernizimit të tij, duke e lidhur atë edhe me punën praktike.

Natyrisht, mësimdhënia bashëkohore, e ndryshon mësimdhënien tradicionale, dhe i jep teorisë së procesit mësimor mbështetje dhe konotacione më cilësore. Në procesin e aplikimit të metodologjive të mësimdhënies, qysh në zanafillë të saj, përmes moduleve të ndryshme nga mësuesit e Gjuhës shqipe kërkohet që ata të jenë të përqëndruar edhe në normat dhe rregullat e çështjeve që lidhen me drejtshkrimin e gjuhës, me teknikat dhe me mënyrat e përdorimit të gjuhës në mënyrë që, nxënësit të shkruajnë sa më drejtë dhe me sa më pak gabime dretjshkimore.

Hulumtuesit dhe studiuesit e ndryshëm, si Hoxha (1984), parashtrojnë disa kritere në kuadër të përgatitjes së zhvillimit të procesit të mësimdhënies dhe përfshirjen e punës praktike në këtë proces. Ndër këto kritere përmendim:

- | |
|--|
| • <i>Koha në dispozicion për përdorimin e metodës apo punës praktike përkatëse mësimore</i> |
| • <i>Pajisja e shkollës, baza materiale e organizimit të punës mësimore në shkollë.</i> |
| • <i>Aftësia profesionale dhe pedagogjike e mësimdhënësit dhe e bashkëpunëtorëve mësimor</i> |

Roli i mësimdhënsit në këtë proces

Mësimdhënia ngërthen më vete shprehjen e aftësive dhe të shkathtësive të mësuesit në raport me nxënësit, me klasën në njësi e tërësishme. Ekuivalent me procesin mësimor, do të kishte rëndësi të veçantë personaliteti i mësuesit, aftësia e tij për zbatimin me korrektësi dhe cilësi, të procesit mësimor në shkollë sepse, mësuesit e gjuhës shqipe po thujnë se në shumicën e rasteve për nxënësit ishin simbol dhe fuqi. Musa Kraja në librin e tij “Mësuesit për kombin shqiptar” të botuar në Tiranë 1993 thotë: “Ai (mësuesi i gjuhës shqipe) nuk ishte vetëm ligjërues i lëndës së vet, por në të njëjtën kohë ishte edhe edukator.”

Në këtë relacion të detyrueshëm, mësuesit kërkohet që të zotërojnë: *“Njohuri të gjëra dhe të thella për lëndën që japin; Njohuri të mira për psikologjinë e nxënësve; Njohuri pedagogjike; Aftësi metodike; Aftësi për vlerësimin e çdo situatë që mund të dalë në klasë etj (Gjoshi, 2006, 141).*

3.4.5 Metodologjitë motivuese

Në kërkim të hulumtimit të veçorive dhe të mënyrave të mësimdhënies, parimi ose synimi i zhvillimit të të mësuarit në formë të përdorimit dhe përshtatjes, mbështetet në vlerësimin sa më adekuat të veçorive të moshës së nxënësve, si dhe mbështetet në shkallën e zhvillimit të karakterit dhe të shkathtësive të nxënësve. Studiuesi i njohur, Aleksandër Xhuvani ka konstatuar se mënyrat e të mësuarit dhe të metodologjisë së të mësuarit, janë: të mësuarit në mënyrë të natyrshme sipas psikologjisë së fëmijëve. Pastaj të mësuarit në mënyrë intuitive, të kuptueshme, interesante, në mënyrë që nxënësit të vetëveprojnë, të mësuarit në mënyrë të qëndrueshme dhe praktike etj.

Qëllimet e metodologjisë së të mësuarit, objektivisht mbështeten në synimet që mësimi të ketë karakter sa më edukativ dhe sa më shkencor. Kjo, pasqyrohet me tendencat dhe synimet e të mësuarit të vetëdijshëm dhe aktiv, të të mësuarit të qëndrueshëm, lidhja e teorisë me praktikën etj. Në rend të parë, inkurajimi dhe motivimi i nxënësit në procesin mësimor, është një kusht i rëndësishëm dhe strategjik në krijimin e ambientit të duhur, e ku nxënësi ka jo

vetëm përkrahje familjare por edhe shkollore. Mbi të gjitha, mësuesi është ai që ka rolin kryesor në motivimin dhe nxitjen e nxënësve kundrejt lëndës dhe procesit mësimor. Metodologjitë e mësimdhënies prandaj lidhen ngushtë me veprimtaritë që duhet t'i udhëheqë mësuesi në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me nxënësit për ta realizuar dhe për ta përvetësuar sa më mirë programin e të mësuarit të shkrimit dhe të leximit.

Për të arritur motivime të fuqishme, të kënaqshme, efikase etj., e para, kërkohet që marrëdhëniet e ndërsjella mësues-nxënës, të ndërtohen mbi nivele të lartë bashkëpunimi, të jenë ndërvepruese dhe në përputhje me konceptin dhe me rolin edukues dhe formësues që ka arsimi (shkolla). Objektivi për ndërtimi të raporteve të denja edukative dhe mësimore në relacion të qartë me qëllimin programorë të procesit mësimor , sigurisht që lidhet direktë me marrëdhëniet që duhet të ndërtohen në mes mësuesit dhe nxënësit. Metodologjia e sjelljes dhe e rregullit ndërveprues, pasqyron një segment që ndërtohet përmes rregullit dhe kulturës së edukimit dhe mësimit, qoftë kjo kulturë e nxënësit dhe qoftë kulturë e mësuesit.

Figura e mësuesit, luan rol të pazëvendësueshëm. Po të bëjmë krahasime, në të kaluarën mësuesi ka qenë i shtyrë që t'u nënshtrohet planprogrameve dogmatike – të pandryshueshme, dhe kurseve rigoroze të trajtimit të nxënësve në klasë. Roli i mësuesit, ka qenë goxha autoritar (pa fajin e tij) sepse, procesi mësimor ndikohej nga politika, nga sistemi shtetërorë. Sot, kanë ndryshuar rrethana politike dhe ideologjike. Shkollat, rrjedhimisht institucionet mësimore u janë nënshtruar reformave të thella dhe metodologjive të ndryshme për zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me ndryshimet shoqërore dhe nacionale, si dhe në përputhje me standret ndërkombëtare. Në kontekst, edhe pozicioni i rolit të mësuesit ka ndryshuar. E para, sepse mësuesi nuk duhet t'u nënshtrohet politikave të ashpëra dhe ndikuese shoqërore dhe shtetërore të mësimdhënies. E dyta, sepse me veprimet e tyre përshtatshme lidhur me shpjegimin dhe zbatimin e lëndës mësimore, janë të destinuara t'u përshtaten nxënësve sepse ata, janë në qendër të mësimit. E treta, sepse mundësitë e bashkëpunimit dhe të bashkëbisedimit në mes të mësuesit dhe të nxënësit, gjithnjë duhet të jenë në dobi të procesit mësimor , dhe këto mundësi janë të lejueshme, pozitive dhe si pjesë të kurikulës mësimore.




Fig. 6 Skemë lidhur me mësimdhënien ndërvepruese

Po t'i krahasojmë kohërat dhe historitë e mësimdhënies, relacionet e dikurshme mësues – nxënës, ishin tejet të ngurta. Nxënësë, trajtohet “me dorë të fortë”, dhe ai nuk ishte në qendër të klasës: në “qendër të klasës”, ishte mësuesi. Kjo gjendje, ishte e njëjtë si në shkollat në Shqipëri, dhe si në Kosovë dhe në viset e tjera. Pra, ka ekzistuar një praktikë e zhvillimit tradicional të mësimi. Siç e dimë, ka ekzistuar një raport i ftohtë dhe në distancë në mes të mësuesit dhe nxënësit.

Në kushtet që janë krijuar sot, këto “distanca” të dikurshme janë eliminuar. Nxënësi, dhe jo mësuesi, është në qendër të mësimdhënies. Prandaj, në kushtet e reja të mësimdhënies, është plotësisht e arsyeshme që mësuesi të mendoj vazhdimisht lidhur me atë se, cilat janë format dhe mënyrat më të përshtatshme dhe më pozitive për t’ia bërë më të afërt dhe sa më joshëse lëndën e tij, nxënësit! Në këtë aspekt, kërkohet aplikimi i më shumë metodologjive të mësimdhënies:

1. Bashkëpunimi interaktiv në klasë: Veç planprogramit mësimor dhe metodologjive të domosdoshme, mësuesi duhet të ndërtoj bashkëpunimi të lirë interaktiv, bashkëbisedim dhe

bashkëveprim me nxënësit në mënyrë që t'u ofrojë atyre sa më shumë mundësi dhe kushte lidhur me lënden dhe njohjen e thelluar të procesit lëndorë.

2. Motivimi i nxënësit: Çështja e motivimit të nxënësit, është një prej mënyrave më pozitive të mundshme për ta mbajtur nxënësin vazhdimisht aktiv kundrejt lëndës. Për këtë, ekzistojnë mënyra të ndryshme: shpjegimi i rrjedhshëm i lëndës, bashkëpunimi, vlerësimi i denjë i nxënësit etj.

3. Vlerësimi i nxënësit: Një mënyrë apo metodë tjetër, është edhe të vlerësuarit e duhur të nxënësit. Vlerësimi periodik (mujorë, dymujorë, tremujorë), përbën pasqyrën e matshme të arritjeve të nxënësit në procesin mësimor. Përgjatë kësaj kohe, mësuesi i ka mundësitë reale që t'i motivojë nxënësit për ta mësuar lëndën e tij. Secili mësues, nuk e ka aspekt të lehtë që të bëjë vlerësimin real – adekuat të nxënësit, sidomos në kushtet kur një klasë ka më shumë se 30 nxënës. Mirëpo, mësuesit i duhet që t'u përshtatet rrethanave dhe të mos jetë aspak subjektiv në vlerësimin e drejtë të secilit nxënës, kuptohet në përputhje me aftësitë dhe me suksesin e treguar të nxënësit përgjatë zbatimit të programit të lëndës së tij.

3.4.6. Metodologjitë tradicionale dhe bashkëkohore të mësimdhënies

Metoda tradicionale paraqet një sjellje të niveleve të ulta dhe të thjeshta në fushen njohëse tek nxënësit. Në këtë mësimdhënie sigurohet një shkallë e lartë e kontrollit nga ana e mësimdhënsit në klasë, i cili do që vetem ai të jetë në qender të vemendjes. Në këtë metodë mësimdhënsi: kontrollon detyrat e shtëpisë, shpjegon temen e re, i urdheron nxënësit që të lexojnë me radhë dhe pa nderprerje, dhe prap i cakton detyrat e shtëpisë. Punon vetem me shkumës në tabelen e zezë pa letër të bardhë të formateve të ndryshme, nuk lejohen nxënësit të shprehin mendimin e tyre të lirë. Nxënësit kryesisht janë dëgjues, lexues, ndonjherë udhëzohen të dalin edhe në tabelë për detyra pa i argumentuar ato lirshem. Nxënësi motivohet pakë për nxitje të krijimtarisë së tij, pra nuk shpalosin sa duhet. Ndërsa metoda bashkëkohore paraqet sjellje të niveleve me të lartat, me të nderlikuara të objektivat në nivelet e analizës. Mësimdhënsi bashkëkohore nënkupton ndryshimin e roleve të mësimdhënsit dhe të nxënësit, ku nxënësi është në qender të vemendjes e jo mësimdhënsi, me qëllimin kryesor për lehësimin

e të nxënit. Mësimdhënsi orjenton, udhëzon dhe mbështet, ai është partner në komunikim dhe ndërveprim në klasë, ku dhe përdorë mjete digjitalë për kërkime njohurish bashk me nxënës. Nxënsi: diskuton, arsyton, argumenton, bënë pyetje dhe kërkon sqarime nga shokët dhe në fund edhe nga mësimdhënsi. Nxënësit përfshihet në mënyrë aktive në procesin e të nxënit dhe kanë të drejtë në literaturë të ndryshme kërkimore si në klasë ashtu dhe jashta klasës, duke sjellë risi në shkollë.

3.4.6.1. Metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies

Në përputhje me reformat dhe standardet bashkëkohore të procesit të mësimdhënies, pas ndryshimeve politike dhe ideologjike në Shqipëri dhe në Kosovë, kanë ndryshuar rrënjësisht format dhe mënyrat, mjetet, metodologjitë e procesit të zhvillimit mësimor . Si për çdo lëndë mësimore, pra edhe për lëndën e Gjuhës Shqipe, mjetet dhe metodat e mësimdhënies synojnë që të nxisin përgatitjen dhe edukimin sa më të mirë dhe sa më efikas, dhe në përputhje me standardet e shkollimit të nxënësve, pavarësisht se në cilën klasë janë ata. Ndër metodat e mësimdhënies së vanacuuar - strategjike të procesit mësimor modernë janë:

- 1. Situatat mësimore,*
- 2. Burimet e komunitetit dhe eksperiencia e nxënësve,*
- 3. Qartësimi i vlerave,*
- 4. Teknikat për të nxitur aftësitë e të arsyetuarit,*
- 5. Puna në grupe etj.*

Në fushën e përpjekjeve reformuese të arsmimit, nxënësi vendoset në qendër të vëmendjes, dhe ai është subjekt në qendër të mësimin. Prandaj, për t'u zhvilluar dhe integruar me sukses në sferat e një ekonomie digjitale, nxënësve u nevojiten kompetenca digjitale. Por, vetëm njohuritë dhe shkathtësitë digjitale nuk mjaftojnë për të krijuar “njeriun” e duhur të epokës digjitale, si në aspektin e shkollimit, ashtu edhe në atë të formimit edukativ.

Kështu, në teorinë dhe në praktikën e sistemit shkollor, çështja e metodave të mësimdhënies është një prej problemeve strategjike të mësimi. Në gamën e gjerë të veprimtarisë arsimore, sistemi i teorisë dhe praktikës mësimore lidhet në mënyrë kryesore me përdorimin e metodave të ndryshme, qoftë në realizimin e programit dhe planit mësimor, qoftë në zhvillimin e procesit mësimor .

Procesi edukativ –arsimor është një proces që përcaktohet në bazë të organizimit, rregullave dhe mjeteve të ndryshme mësimore për të qenë ky proces, adekuat dhe i ligjshëm. Prandaj është e rëndësishme që këto metoda të studiohen në thellësi.

Metodat mësimore, janë pjesë e përmbajtjes së organizuar dhe të planifikuara kundrejt organizimit dhe zhvillimit të procesit mësimor në lidhje me absorbimin e njohurive të nxënësve, si dhe në lidhje me zbatimin e diturive, të shkathtësive dhe të afiniteteve të ndryshme lidhur me procesin efikas mësimor .

Metodat mësimore, janë aktivitete të veprimeve të përbashkëta brenda procesit mësimor në mes arsimtarit dhe nxënësve sipas planprogramit mësimor , dhe sistemit të përcaktuar arsimor. Ata që janë kompetentë, përgjegjës dhe drejtues të këtij procesi por edhe studiuesit, organizata e ndryshme (në realizim sa më efikas të sistemit edukues – arsimor), janë përkushtuar vazhdimisht në kërkim apo gjetje të mënyrave dhe të mjeteve kundrejt këtij procesi. Metodologjitë e mësimdhënies, kushtimisht, janë fokusuar në qëllimin dhe objektivat kryesorë, si: përzgjedhja e materialit mësimor , analizimi i fakteve, rënditja e çështjeve mësimor , debatet rreth fakteve, argumenteve, konstatimet dhe vendimet. Përgjatë procesit mësimor, në arritje të reformimit dhe të modernizimit të procesit mësimor format dhe mjetet e mësimi, janë zgjeruar përtej “klasës”!

Bashkëveprimi dhe koordinimi i disa faktorëve të procesit mësimor, në rend të parë përfshinë kushtet dhe rrethanat e domosdoshme, si kuadri mësimor , faktorët objektiv - material, mjetet mësimore etj., në mënyrë që të jetë efikase, dhe në dobi të zbatimit të planprogramit mësimor. Cilësia në mësim, qëndron në përgatitjen dhe angazhimin profesional të mësuesit, pavarësisht se për cilën lëndë bëhet fjalë. Prandaj, kur bëhet fjalë për lëndën e gjuhës shqipe, mësimdhënësit me shkallë më të lartë të arsimimit, e vlerësojnë si mjaftë kryesore rolin e

gjuhës në procesin edukativ – arsimor , krahasuar me mësimdhënësit me shkallë më të ulët të arsimimit.

3.4.6.2 Sistemi ndërveprues i shënjimit për të menduarit dhe leximit efektiv

Sistemi ndërveprues i shënjimit për të menduarit dhe leximin efektiv (Interactive Noting System for Effective Reading & Thinking/INSRT), zbatohet në tri etapa të orës mësimore. Ecuria e aplikimit të kësaj teknike të të menduarit dhe leximit efektiv, është:

3.4.6.1 Teknika „Brainstroming”

Brainstorming-u, “është një veprimtari që shërben si fillimi i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda e teknika të tjera.”¹ Pse përdorimi Brainstorming-ut? Ka ka si qëllim që të aplikoj më shumë ide, diskutime, opzione ose komente rreth nje problematike te ngritur. Një teknikë e këtillë e mësimdhënies, nënkupton bisedën - dialogun në formë pyetje-përgjigjëje me nxënës., apo dhënjën në mënyrë të lirë të përgjigjëjeve nga nxënësi për një problem të shtruar mësimorë. Dhënja e mendimeve të këtilla nga nxënsi, mund të jetë individuale. Megjithatë, sipas kësaj teknike, dhënia e përgjigjeve mund të bëhet edhe me bashkimin e ideve nga nxënësit në çift, apo edhe në grup.

Në kontekst, përgjegjjet mund të realizohen edhe në formën frontale (kur problemi paraqitet para gjithë klasës).

Përdorimi adekuat i kësaj teknike, është shume e thjeshtë: Parashtrohet pyetja, e cila, ku nxënësit mund të japin përgjigjëje të ndryshme. Pra, pyetja, formulohet në atë menyre që nxënësit të mos kufizohen në përgjegjje e tyre. Pyetja mund të shtrohet kështu: Çfar mendoni se dini për....?

Teknika “Brainstroming”, mund të aplikohet në fazën e evokimit, fillimisht për të hyrë në temë, e pastaj mund të përdoret në fazën e reflektimit për të nxjerrë konstatime e ide për njësinë e mësuar.

Brainstorming kërkon të mbahet parasysht:

<i>Asnjë prej zgjidhjeve e ideve të mos kritikohet,</i>
<i>Të nxiten nxënësit të shprehin ide,</i>
<i>Diskutimi të zhvillohet për gjëra të njohura,</i>
<i>Të aktivizohen edhe nxënës të drojtur,</i>
<i>Të shërbejë si nxehje e trurit.</i>

Përdorimi i brainstorming është i dobishëm:

<i>Zhvillon aftësitë pjesëmarrëse të të gjithë nxënësve,</i>
<i>Rrit pavarësinë e gjykimit të nxënësve,</i>
<i>Inkurajon nxënësit të shprehin atë që dine,</i>
<i>Jepen zgjidhje të parashikuara,</i>
<i>Sugjeron arsye për të vazhduar diskutime në forma të tjera,</i>
<i>Zbulon preferencat e nxënësve,</i>
<i>Kërkon burime të pakta dhe të thjeshta.</i>

Brainstorming-u nuk mund të zhvillohet:

<i>Kur nxënësit nuk kanë njohuri për çështjen që shtrohet,</i>
<i>Kur çështja (pyetja) kyç që ju përdorni për brainstorming nuk është formuluar mirë (ka mangësi),</i>
<i>Kur çështja (pyetja) kyç që ju përdorni, ka pak alternativa (ide) për zgjidhjen e problemit</i>

Evokimi

Nxënësi, duhet t'i ketë parasysht vendosjet e shenjave. Ndërsa, pjesëmarrësit, ende përpara se ta marrin tekstin, udhëzohen që gjatë leximit të tij, në fund të fjalisë apo në fund të fjalise ku nenkupton dhe pershkruan dikë ate rendeshime, është obligatë te vendosen shenjat.

Pra, shenjat e mëposhteme vendiose ne rastet kur:

- informacionit që për ju ka qen i njohur ↓,
- informacioni është ndryshe nga ai qëe keni pasur -,
- informacion i cili tregon se ju keni mësuar diçka të re +,
- kur nformacioni është i pa njohur,apo deshironi të dini më shumë ?.

3.4.6.5 Realizimi – kuptimi

Jepet për lexim tekësti, i cili tekst tregon diçka, shpreh apo reflekton një ngjarje që ka një kuptim për t'u ditur, për t'u interpretuar:

„.....”;

fq.....

Reflektimi:

Pas leximit të tekstit, pjesmarrësit në çifte të identifikuara bisedojnë lidhur me atë se çfarë kanë lexuar, bisedojnë për informacionet e reja, krahasojnë shenjat që duhet përdorur etj. Secili në mënyrë individuale, e rradhitë informacionin në bazë të shenjave, kështu që përgatitet „Tabela e insertit”.

Ne rastet kur reflektimi, është i arsyetoht mbi temën, tabela e insertit preferohet te ipet si detyrë shtese.

3.4.6.6 Diskutimi në çifte dhe në grup

Teknika e diskutimit në çifte dhe në grup, shpreh një moment të përshtatëshëm lidhur me etapën e reflektimit. Nxënësit, së pari në çifte dhe më pas edhe në grup, e diskutojnë pjesën e lexuar të tekstit. Pastaj, shihet dhe analizohet fakti nëse ka mospërputhje në informacione, nxirren konkluzione, krahasohen shenjat, diskutohen mospërputhjet. Pas bashkbisedimit, mësimdhënësi angazhon antarë nga grupet për të dhënë shpjegimin dhe përfundimet e nxjerra gjatë bashkëbisedimit. Një gjë e tillë, mund të bëhet duke prezentuar menaxherin e grupit. Ky angazhimi shpese aplikohet duke e përdorur teknikën e njohur si „stilolapsat në mes”! Si bëhet kjo? Nxënësit, i vënë lapsat mbi bankë dhe grupin e përfaqëson ai nxënës, lapsin e të cilit e përzgjedh mësuesi.

3.4.6.7 Shqyrtimi kategorizues

Kjo teknikë, zakonisht aplikohet në fazën e reflektimit. Qëllimi i kësaj teknike, është kategorizimi i një përmbajtje nëpër kategori. Numëri i kategorive, mund të jetë i aplikueshëm në dy e më shumë prej tyre. Nëse marrim shembullin e përmbajtjes “Zogjtë”, kategoritë që mund të merren dhe të analizohen mund të jenë: sjelljet e zogjve, vetitë fizike, dobia, banimi etj.

Kategorizim i tillë, mund të bëhet në lëndë të ndryshme. Posaqerit gjuhëa shqipe ka nje, një përmbajtje leximi apo një fjalije e që mund të grupohet në njësit gramatikore si : emra, mbiemra, përemëra, folje, ndajfolje, lidhëza etj. Kategorizimi bëhet nëpërmjet tabelës e cila, mund t’u jepet nxënësve si e gatshme dhe më pas, nxënësit bëjnë plotsimet e duhura. Kategorizimet, nxënësit mund t’i bëjnë në mënyrë të pavarur, t’i ndajnë problemet, t’i kategorizojnë ato etj.

Përmbajtjet lidhur me kategorizimin merren nga teknika “braistorming” në bashkëveprim me nxënës, por edhe nga informacionet e nxjerra gjatë përpunimit të tekstit. Kategorizimi, lejohet që të bëhet në mënyrë individuale, pastaj bëhet rishikimi në çifte dhe në grup i kategorive. Në fund të këtij shqyrtimi, bëhet përmbledhja e këtyre kategorizimeve dhe, rekomandimet pastaj në formë të sistemuar, prezentohet para klasës në fleta të mëdha ose në dërrasë të zezë.

3. 4. 6.8 Drita

Kjo teknikë, nënkupton “lexim dhe mendim të drejtuar”, si dhe “etapat të aplikimit” që shfaqen ose jepen me pika në kryerresht. Në kontekst, fillohet duke e prezantuar autorin e tekstit, si dhe duke i dhënë udhëzimet ngase, leximi bëhet individualisht. Me këtë rast, duhet përfillur (respektuar) ndalesat në tekst.

Të lexuarit bëhet në ndalesa. Kjo paraqet më vete evokimin. Teknika si kjo mbulon tri faza të orës mësimore. Fillimisht, lexohet paragrafi i parë. Dhe kur nxënësi e përfundon leximin e paragrafit, e mbyll tekstin. Pas leximit të tekstit, nxënësve u shtrohen pyetje, varsishtë nga natyra e përmbajtjes së tekstit. Pyetjet, mund të kenë natyrë të këtyllë, si: Si u ndiet gjatë

leximit? Çfarë kuptuat nga kjo pjesë e tekstit që keni lexuar? Si do të vazhdoj më tutje tregimi apo ngjarja? Përse mendoni kështu?

Në realizim të kësaj teknike, nxënësve u lihet një lloj hapsire që ata të mendojnë. Para leximit të fundit të tekstit, shtohet pyetja: Si përfundon ngjarja? Ndërsa, pas leximit të fundit pyesim: A përfundoi ngjarja si e menduat? Cila është çështja që trajtohet? Çfarë mendoni se është mesazhi i tekstit? Gjatë përgjigjeve të nxënësve, mësuesi duhet të lejojë që ata të flasin me njëri tjetër, e jo përmes mësuesit. Mësuesi, e miraton me lëvizje të kokës, një situatë të këtyllë.

Në ndërkohë, mësuesi i nxjerrë në dërrasë të zezë mesazhet e tekstit me thënie të qarta. Diskutimi pastaj, përfundon duke i analizuar ato.

3.4.6.9 DLTA (Dëgjim dhe mendimi i detajuar)

Kjo teknikë, dallon nga teknika “Drita”. Ku dallon? Leximi bëhet në mënyrë individuale, dhe lexohet me zë. Qoftë arsimtari apo qoftë nxënësi e lexon tekstin me zë, kurse të tjerët afër dëgjojnë. Fazat tjera mësimore, janë pothuajse të njëjta. Teknika “Dlta”, ka përparsi nga teknika “Drita” në situatat kur kemi mungesë tekstesh, ose kur nxënësi nuk i respekton ndalesat gjatë leximit.

3.4.6.10 Pesëvargëshi

Teknika e pesëvargëshit, mund të përdoret në dy faza të ores mësimore: si evokim, dhe si reflektim. Ecuria e aplikimit, është kjo: shkruhet emri i temës, ose ndonjë emër që ka të bëjë me temën: Mali, Stina, Ministrinë, Zogu, Liria, Mësuesi, Albani, Stralli etj.

Secili nxënës, individualisht gjen dy mbiemra, tri folje, një fjali dhe sinonimin e emrit.

Emri	Qeni	Mësuesi
2 <i>mbiemra</i>	<i>i urtë, i shpejtë</i>	<i>i dijshëm, bashkohor</i>
3 <i>Folje</i>	<i>ulurinë, kafshon, vrapon</i>	<i>arsimo, mëson, edukon</i>
1 <i>Fjali</i>	<i>qeni i uritur ulurinë natën</i>	<i>mësuesi bashkohor jep dije</i>
<i>Sinonimi</i>	<i>besnik</i>	<i>i popullit</i>

Figura 7. Skemë analize në lëndën e Gjuhës shqipe

3.4.6.11 Mendo, puno në dyshe, thuaja grupit...

Një teknikë e këtyre, mund të përdoret në evokim dhe reflektim. Nga pjesmarrësit, kërkohet që të bashkohen në dyshe dhe më pas, veprohet sipas këtyre hapave:

1 Njëri nga antarët në qift, ka për detyrë që të shkruaj për pesë minuta një temë (Për shembull: Përshkruani një rast nga përvoja juaj jo e mirë me një administrator). Kurse, anëtari tjetër nga çifti shkruan për një rast tjetër që ai e ka pasur, ndryshe nga anëtari tjetër i qiftit (Përshkruan rastin kur ka kryer ndonjë punë, dhe ka pas një përvojë të mirë me donjë klient).

3.4.6.12 Ditari dypjesësh dhe tripjesësh

Në hapin e parë, pjesmarrësit informohen për atë që do të lexojnë. Në rastin konkret, mund të lexohet një poemë. Gjatë leximit, mbahen shënime. Pastaj, pjeëmarrësve u tregohet se fleta ndahet në mes me një vijë vertikale sepse, gjatë leximit, në të majtë të faqes shkruhet ndonjë imazh, citat nga teksti, dicka që lë përshtypje të caktuar. Në anën e djathtë, mund të shkruhen komentet si: Pse e kemi ndarë citatin? Çfarë dhe pse u ka shtyrë të mendoni ?

Përgjatë mbajtjes së ditarit dypjesësh dhe trepjesësh, në lexim të poemës, duhet të ndalemi së paku katër herë deri në fund. Koha e leximit, është 20 minuta.

Leximin e njejtë e zhvillon edhe mësuesi. Kurse, në fund të leximit kërkohet ndonjë vullnetar që ta bëjë shpjegimin e tekstit, t'i jap komentet. Dhe pas leximit të asaj pjese që, krijon përshtypje, shtrohen pyetjet: Pse ua ka tërhequr vëmendjen kjo pjesë ? Çfarë u bënë të mendoni ?

Në kontekst, shtrohet edhe pyetja nëse ka ndonjë anëtar i grupit që e ka zgjedhur të njëjtën pjesë. Në fund, mësuesi jep komentet e vetat të nxjerrura gjatë leximit që ai ka bërë në tekstin e poemës. Leximi i pjesëve, mund të bëhet duke u ndalur pas çdo pjese të lexuar për t'ua plotësuar ditarin dhe në fund, për t'i dëgjuar edhe pyetjet që mund t'i shtrojë mësuesi.

Pyetjet e fundit, kanë këtë kuptim: Çfarë pyetjesh kanë mbetur pa përgjigje? Çfarë do të mbani mend nga ky material? Cili, është mesazhi më i rëndësishëm?

(Këtyre pyetjeve, u përgjigjen nxënësit në formë teknike të braistormingut.)

3.4.5.12 Shkrimi i lirë

Shkrimi i lirë, realizohet zakonisht në reflektim, por mund të përdoret edhe si evokim! Nxënësve, u jepet një temë ose, u shtrohet një pyetje. Ata pastaj, janë të lire të shkruajnë rreth saj. Nxënësit, mund të shkruajnë në mënyrë të lirë. Në fund, lexohet nga një shkrim prej secilit grup, ku japin mendime të ndryshme.

Një shkrim i shkruar në mënyrë të lirë dhe një ese, dallojnë mes tyre. Dallimi qëndron në faktin se tek shkrimi i lirë, nxënësve u jepet paraprakisht titulli orientues i temës apo problemi të cilin, ata duhet ta trajtojnë!

Nxënësit, janë të lirë të shkruajnë rreth temës, rreth problemit të parashtruar. Kurse, forma e shkrimit të eses, është një shkrim i orientuar nga mësuesi. Orientimi, ka për qëllim që të bëhet me anë të një pyetjeje dhe kërkesës për zbërthimin të argumentuar, si dhe të arsyetohen mendimet.

3.6 Roli dhe funksioni i metodologjive,

Aplikimi cilësor i tyre, është i pazëvendësueshëm. Ç'farë kërkohet në këtë drejtim?

Referuar Gashi (2001)

- *Alikimi i vazhdueshëm i metodologjive në funksion të mësimit cilësor, dhe ngritja e suksesit në mësim,*
- *Bashkëpunim të afërt dhe komunikim të lirshëm në mes të mësuesit dhe nxënësit me qëllim të zbërthimit dhe rritjes së interesimit të nxënësit ndaj procesit mësimorë,*
- *Sigurim të kushteve objektive, materiale, i mjeteve mësimore etj.*
- *Mësimdhënie të përgjegjshme dhe profesionale,*
- *Sinkronizimi, reformimi dhe modernizimi i procesit mësimorë në shërbim të lëndëve mësimore, me një fjalë, në shërbim të gjithë planprogramit mësimorë,*
- *Gjetja e faktorëve apo metodologjive që e rrisin interesimin e nxënësit kundrejt procesit mësimor.*

Mënjanimi i pengesave, dobësive dhe faktorëve që e pengojnë arritjen e suksesit të nxënësit në mësim: trajtimi me kompetencë i lëndës nga mësuesi, planprogrami i përshtatshëm për nxënësit, shmangija e numrit të madh të nxënësve në klasë, trajnimi i duhur i kuadrit mësimorë (i mësuesve), bashkëpunimi prind – mësues etj.

3.5.1. Çka synohet me aplikimin e metodologjive bashkohore në procesin mësimor ?

Në të kaluarën edukimi dhe arsimit në Shqipëri dhe në Kosovë, ishte i ndikuar nga mësimet tradicionale, si dhe nga aspektet politike dhe ideologjike. Vetëm pas rënjes së komunizmit në vitet e 90-ta, u krijuan perspektiva të reja dhe qasje më të moderuara në raport me zhvillimin e sistemit arsimor. Në vitin 1997, në Republikën e Shqipërisë, ashtu si edhe në tetë shtete të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore, filloi zbatimi i projektit mësimor: “Zhvillimi i të menduarit kritik përmes të lexuarit dhe të shkruarit”. Ky projekt, i dha impulse tejet të fuqishme (pozitive) hapjes dhe modernizimit të mësimit shqip, e në kontekst edhe metodologjitë e mësimdhënies së gjuhës shqipe.

Me kalimin e kohës, rreth tridhjetë shtete në Evropën Juglindore dhe Lindore, e filluan aplikimin e këtij projekti. Ndërsa, për shkak të rrethanave të ditura, ky projekt në Republikën

e Kosovës, filloi të zbatohet në vitin 2001. Përgjatë zbatimit të teorive dhe teknologjive të reja në arsim, metodat dhe strategjitë bashkëkohëse të mësimdhënies dhe të nxënies të mësim, kanë zënë vend kudo në arsimin fillor dhe parauniversitar. Të menduarit kritik dhe mësimnxënia, janë shndërruar në një sistem në shkallë kombëtare. Që pas vitit 1997, janë zhvilluar veprimtari dhe organizime të thella dhe gjithëpërfshirëse, qoftë në ngritjen e kapaciteteve subjektive dhe objektive, dhe qoftë në organizimin e seminareve, të debateve këshilluese, të trajnimit të kuadrit shkollorë etj. Synimet themelore që janë kërkuar dhe që vazhdimisht kërkohen që të arrihen me aplikimin e metodologjive për një proces mësimorë efikas dhe cilësorë, determinojnë përgatitjet dhe udhëzimet e ndryshme materiale. Dhe, si rezultat i synimeve për një proces sa më efikas të mësimdhënies, janë botuar një sasi e konsiderueshme materialesh në formë të udhëzimeve, të broshurave dhe të revistave pedagogjike, si dhe janë botuar katalogje dhe libra të cilat përdoren nga mijëra e mijëra nxënës, arsimtar etj.

Rezultatet e arritjeve individuale dhe kolektive në arsim, janë njohuritë, aftësitë dhe shkathhtësitë e përkufizuara qartë, e të cilat janë pjesë e realizimit të programit shkollorë. Procesi i arsimimit, rezulton gjithmonë me synimin për arritje të rezultateve pozitive, por natyra e tyre shpesh është e papërcaktuar, dhe nganjëherë edhe e paqartë! Temat mësimore të deritashme të programit mësimorë, nuk u kanë ofruar mësuesve ndihmë të fuqishme për t'u orientuar nëpër lëndën mësimore që zhvillohet në klasë. Në këto programe, ka tema mësimi më shumë, dhe më pak të rëndësishme. Ato, mund të zhvillohen në nivele të ndryshme duke u dhënë më shumë ose më pak rëndësi, kështu që huqjet e mësuesve janë të mundshme. Për këtë arsye, edhe rezultatet janë të ndryshme, si të dalin (Po aty, f.6).

Në kontekst, nxënësi arrinë që të ketë shumë imazhe, njohje, kuptime lidhur me tematikën e tekstit, por ai nuk të grumbullojë sasi fjalësh, riprodhim të tekstit që ai e përdorë. Kështu që mundësitë e të kuptuarit, të komunikimit dhe të interpretimit të tekstit nga këndi original i intelektit dhe i aftësive të nxënësit, do të shfaqen vetëm si rezultat i zhvillimit dhe evoluimit të nxënësit kundrejt procesit mësimorë, dhe anasjelltas...!

Mësimdhënia bashkëkohore, në realitetin e tanishëm, mbështetet në dhjetëra metoda të cilat nxisin jo vetëm interesimin e nxënësit, por edhe ngritjen e kapaciteteve mësimore të tij. Prandaj, konkretizimi i kohës, formimi i grupeve të punës në përbërje të nxënësve, shfaqjet

e duhura të shkathtësive në zbatimin e procesit mësimorë, përdorimi efikas i metodologjive etj., kanë interferuar në rritjen e kapaciteteve metodologjike, si në zbatimin e programit mësimorë, dhe si në rritjen e suksesit të nxënësve në shkollë. Kur jemi te metodat e mësimdhënies, po i veçojmë tri metoda tradicionale të mësimdhënies: *1. Metoda verbalo-teksuale. 2. Metoda ilustrativo – demonstruese. 3. Metoda laboratoriko-eksperimentale.*

Siç e kemi theksuar edhe më lartë, procesi mësimorë përshkohet nga faktorë subjektiv dhe objektiv – material. Sjellja dhe kultura e rendit mësimorë në klasë, përfaqëson filozofinë e zbatimit të rendit shtëpiak të shkollës, ashtu si edhe qasjen dhe sjelljen e nxënësve kundrejt përgjegjësive në vijim dhe mësim, në kryrjen e detyrave, të ushtrimeve etj. Kultura e sjelljeve, që domethënë performanca e nxënësit në klasë duhet të jetë e vëzhguar vlerëson Dr. Jaka, i cili thekson: “Veprimtaritë që ndodhin të veçuara në mendjen e nxënësit, nuk janë të vëzhguara dhe si të tilla, nuk mund të përfshihen në objektiv, ta zëmë, krijimi i ndonjë përfytyrimi mendor apo përpunimi i një zgjidhjeje (përgjigjeje) në mendje i paraprinë të nxënësit, por ato nuk mund të konsiderohen prova për të treguar se ka ndodhur të nxënësit.”¹²

Mjetet mësimore: Ndërsa që procesi mësimorë të jetë sa më gjithëpërfshirës, si në nga aspekti teorik dhe si nga aspektin praktik, lypset të përdoren mënyra dhe mjete të adekuata për zhvillimin e këtij procesi. Në kontekst, mjetet mësimore që përdoren në arsimin fillorë dhe të mesëm (parauniversitar) klasifikohen në: 1.Mjetet mësimore vizuale. 2. Mjete auditive.

1 Mjetet mësimore vizuale. - Këto mjete ndahen sipas formës, paraqitjes së tyre të jashtme, dhe vendit. Ato janë: *1. Mjete dydimensionale.2. Mjete tredimensionale. 3. Mjetet audiovizuale. 4. Mjetet e komunikimit masiv. 5. Mjetet ndihmëse-teknike mësimore dhe orenditë shkollore.*

Mjetet dydimensionale konsiderohen: fotografitë dhe pikturat, mjetet grafike me të cilat, nënkuptojmë grafikët linearë, histogrami, Figura rrethor ose cirkular, piktogramet, skemat,

diagramet, tabelogramet, hartogramet, simbolet, pllakatet, materialet foliografike, tekstet dhe botimet e ndryshme, albumet, atlasit dhe planetariumi.

Mjetet tredimensionale janë: materialet e natyrës të cilat e rrethojnë njeriun (malet, fushat, bimët, shtazët), makinat, modelet, relievet, maketet dhe numërorja

2. *Mjetet auditive.* - Këto mjete janë: radio emisionet, incizimet magnetofonike dhe incizimet në CD, instrumente muzikore. Kurse, mjetet audiovizuale janë: emisionet televizive, filmi, mjetet manuale mësimore ku hyjnë laboratorët lëvizës, vegëltoret ose punishtet lëvizëse, aparatet për kopjim dhe fotokopjim.

Mjetet e komunikimit masiv: të mësuarit nga emisionet e ndryshme nga radio dhe televizioni, përdorimi i kompjuterit dhe i internetit.

Mjetet ndihmëse-teknike mësimore dhe orenditë shkollore janë: mjetet për të shkruar, mjetet për të vizatuar, mjetet ndihmëse me qëllim demonstrimi, instrumentet dhe aparatet e ndryshme, makinat mekanike, elektrike dhe elektronike. Në aspekt të përdorimit të mjeteve ndihmëse – teknike, mund të përdoren karriget, bankat, vizorja, trekëndëshi, epruveta, vitrina, tabela, arka

Ekzistojnë disa metoda, sipas Jaka (2008), të cilat janë të nevojshme që të përdoren për ta bërë një studim të thelluar, të qartë dhe po ashtu, për të pasur një pasqyrë sa më reale-konkrete lidhur me objektin e temës, me thelbin dhe me kornizën adekuate të temës, dhe për të arritur deri te rezultati konkret.

- *Metodologjia e kërkimit, shtrohet si një nevojë që teksti i doktoratës të ketë një strukturë të qëndrueshme vertikale dhe horizontale, përmes së cilës strukturë, ne arrijmë që ta vendosim temën mbi konditat studiuëse: hyrja, trajtimi i temës, grumbullimi i materialeve, analizimi dhe studimi i tyre, krahasimi etj. Vetëm kur ta kemi vjelur të gjithë format dhe mënyrat e nevojshme, mjetet, teknikat studimore etj., mbështetur në të dhëna dhe në faktet e caktuara, ne do të jemi të gatshëm për të realizuar deri në fund, objektivin tonë të përcaktuar lidhur me këtë studim, e që është: metodologjia e mësimdhënies së lëndës së gjuhës shqipe.*

- *Metoda e analizës, na mundëson shtyrtrimin dhe analizimin e përmbajtjes së temës dhe të studimit të saj.*
- *Metoda historike, po ashtu, me fakte dhe dokumente relevante na mundëson njohjen dhe shtyrtrimin e rrjedhës të procesit mësimorë, vlerësimin adekuat të zhvillimit të këtij procesi etj.*
- *Metoda krahasimtare, është po ashtu një prej metodave përmes së cilës, ne bëjmë krahasime të gjendjes së zhvillimit lidhur me arsimimin, dhe në veçanti, lidhur me zhvillimin e gjuhës shqipe nëpër epoka të ndryshme, dhe faktin se si ka evoluar metodologjia e mësimdhënies etj.*
- *Metoda e vrojtimit të objektit – lëndës studimore, na mundëson vrojtimin dhe zbërthimin e teorive të ndryshme, të dëshmimeve, të fakteve të cilat, janë të lidhura me metodologjitë në përgjithësi, dhe me rolin e tyre në veçanti. Qëllimi i secilës medotë, është që të kuptohet struktura dhe harmonia në mes të teorive të ndryshme mbi aplikimet e metodologjive, ashtu si edhe mbi rolin dhe rëndësinë e tyre në procesin e mësimdhënies.*
- *Janë me rëndësi edhe aplikimet e metodave statistikore, metoda e sintezës etj. Mbi një sintezë dhe mbi një analizë sa më të plotë studimi të bazuar në dëshmi, fakte, shifra etj., ne arrijmë që ta kuptojmë më mirë dhe më përmbajtësisht rëndësinë e sistemimit dhe harmonizimin të fakteve dhe të dhënave bazike, duke u dhënë atyre formë të rrjedhshme dhe funksionale në thelbin e trajtimit tematikë.*
- *Një metodë tjetër, është edhe metoda e induksionit. Kjo metodë, ka rëndësi të thelluar në trajtimin e temës: nga studimi i pjesëve të veçanta, në drejtim të pjesëve të tërësishme të lëndës që e hulumtojmë dhe e studiojmë, na mundëson që të përfitojmë një pasqyrë të përgjithshme lidhur me aplikimin e metodologjisë së mësimdhënies së gjuhës shqipe. Janë, në kontekst, dy lloje të induksionit: induksioni i plotë, që nënkupton analizën e të gjitha pjesëve të veçanta prej të cilave përbëhet lënda, dhe induksioni jo i plotë, e që nënkupton studimin vetëm të disa pjesëve në mënydrë të ndarë, pra të veçuar. Me këtë metodë, kemi mundësi që t'i zbërthejmë çështjet trajtuese metodologjike nga tërësia e tyre, në pjesë të ndara, të veçanta.*

3.6 Krahasime të metodologjive të mësimdhënies

Dinamika e procesit mësimor e kushtëzon nevojën e procesit mësimor dhe të mësimdhënies që nxënësi, në vend të përvetësimit të njohurive klasike - tradicionale, të përpiqet të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri të veta sa më origjinale, kuptohet, në relacion me konceptin dhe me tematikën e lëndës. Në procesin e mësimdhënies së lëndës së gjuhës shqipe, dallojmë (kryesisht), tre nivele të procesit të mësimdhënies: *1. Niveli i mëimit teorik - shkencor i mësimdhënies. 2. Niveli profesional i zbatimit të njohurive teorike (përmes projekteve, programeve, udhëzime metodike, teksteve dhe mjete mësimore). 3. Niveli i mëimit praktik (praktimi i aktiviteteve të ndryshme të mësimdhënies).*

Gjuha shqipe (shembull: Kosova), si shkencë pedagogjike-arismore merret me studimin teorik të gjuhës, me zërthimin dhe përpunimin teorik të saj, ashtu si edhe me zbatimin praktik në këndvështrimin e saj themelorë: të folurit standard të gjuhës, dhe të të shkruarit të saj! Mirëpo, planprogrami i gjuhës shqipe, jo rrallë, është kushtëzuar nga aplikimi i metodologjive jo adekuate organizative dhe efikase për shkak të procesve të vështira historike, për shkak se zhvillimi i shkollës shqipe në hapësirat albanofone është penguar nga regjime dhe ideologji të ndryshme, pastaj për shkak të kushteve politike dhe ekonomike, për shkak të ndarjeve politike dhe administrative – shtetërore etj.

Dallimet përmbajtësore metodologjike. - Bazuar në mësimdhënien tradicionale, metodologjia e gjuhës shqipe në Shqipëri dhe në Kosovë, përfshinte veprimtarinë metodike, njohuritë teorike dhe praktike etj. Mirëpo, në Kosovë vështirësitë e shkollës shqipe dhe sidomos, të gjuhës dhe të letërsisë shqipe imponoheshin jo vetëm nga koncepti ideologjik, por edhe nga teoritë dhe planprgramet e sistemit serbë dhe atij jugosllav të arsimit. Për rreth 50 vite, shkolla shqipe në Kosovë, ishte dominuar në këtë drejtim. Madje, shkollat e para në Kosovë (të pakëta në numër...), pas Luftës së Dytë Botërore (1945), ishin hapur në gjuhën serbe. Në periudhën 1945 – 1965, shkollat në Kosovë ishin mbikëqyrur nga Beogradi në çdo drejtim, duke mos i lejuar ato që të pavarësoheshin, me një fjalë që të funksiononin sipas nevojave të komunitetit shqiptar. Për rrjedhojë, mund të konstatojmë se roli i sistemit shkollor në Kosovë, ishte një rol imponuar nga sistemi politik dhe ideologjik, si dhe nga qëllimet autoritare dhe asimiluese të Beogradit kundrejt komunitetit shqiptar. Për fat të keq, jo vetëm në Kosovë. Në format edhe më drastike, gjuha shqipe ishte satanizuar në Maqedoni, në Mal të Zi dhe, kudo ku kishte shqiptar në ish Jugosllavi.

Në Shqipëri, pavarësisht nga ndikimi politik dhe ideologjik, gjuha shqipe përdorej në gjithë territorin sipas planprogrameve të unisuara, dhe në funksion të edukimit dhe emancipimit nacional. Madje, gjuha u standardizua në vitet e 70-ta (shek.. XX-të). Mësimet dhe studimet e gjuhës, kanë qenë të ndara nga letërsia, ndërsa që në Kosovë, kjo lëndë është mësuar bashkërisht: si letërsi dhe gjuhësi. Ndërsa bëjmë krahasime të sistemit mësimor , kushtet dhe rrethanat e shkollës shqipe në Shqipëri, metodologjitë e mësimdhënies për rreth gjysmë shekulli, ishin të tjera, krahasuar me ato në Kosovë. Në anën tjetër, misioni i gjuhës shqipe ka qenë gjithmonë jo vetëm të lexuarit dhe të shkruarit, por, edhe edukimi, emancipimi, njohja shkencore etj. Megjithatë, gjuha shqipe nuk është një gjuhë dosido, ajo përfaqëson një gjuhë jashtëzakonisht komplekse, të vështirë për t'u kapur në aspekt të strukturës, të përbërjes së saj etj. Kundruall këtij “kompleksiteti”, nxënësit duhej që të përgatiteshin dhe të mësonin pjesë të historisë së zhvillimit të gjuhës, teoritë gjuhësore, krijimtaritë letrare, biografitë e shkrimtarëve etj. Qysh nga klasët e ulëta, nxënësit ngarkoheshin edhe me lektyrat shkollore, me leximin dhe interpretimin e tyre.

Në kuadër të lektyrës shkollore në ciklin fillor , mësohej kryesisht letërsia kombëtare (Shqipëri), kurse në Kosovë, edhe letërsia Jugosllave. Hartuesit e programeve të gjuhës dhe të letërsisë shqipe, nuk e kishin integruar edhe letërsinë botërore. Atë, e kishin lënë si të veçantë! Ndërsa sot, lista e lektyrës shkollore për klasët VI, VII, VIII, IX të mësimt fillor në Republikën e Kosovës, preferohen pak autorë të kësaj letërsie.

Në dy-tri dekadat e fundit, rëndësia e edukimit dhe e arsimit si në Shqipëri dhe si në Kosovë, ka tërhequr vëmendjen e politikave zhvillimore të qeverive dhe të institucioneve që janë pjesë e procesit mësimor , dhe e kanë vendosur sistemin e arsimit si prioritet në agjendat e tyre politike. Modernizimi aktual i shkollës dhe investimet kapitale në sistemin e arsimit, andej dhe këndeje kufirit Shqipëri – Kosovë, kanë të bëjnë me reforma të thella arsimore, me ndërtimin e objekteve shkollore, me ngritjen e pagave të mësimdhënësve etj. Faktorë të shumtë pozitiv, si shtytës koherentë të avancimit të shkollës shqipe, nxisin në shkallë kombëtare një arsimim të baralancuar dhe në kushte të njejëta, për secilin nxënës pa dallim deri në zonat më të thella rurale.

Shembull: Në Republikën e Kosovës, struktura e modernizuar organizative arsimore, mbështetet në sistemin 5 + 4 + 3 e shkollimit fillor dhe të mesëm, i cili fillon në moshën 6

vjeçare. Këto ndyshime, janë ndërmarrë me qëllimin të ndërtimit të një sistemi arsimor në përputhje me standardet e sistemet arsimor të vendeve të Bashkimit Evropian, dhe në përputhje me vendet e tjera të zhvillura. Kështu, në vitin e rregullt shkollor 2002/2003, në Republikën e Kosovës, funksiononin 973 shkolla fillore, me 315.089 nxënës, dhe 20,352 mësues. Ndërsa, funksiononin 140 shkolla të mesme (në 72.5% në gjuhën shqipe, 22% në gjuhën serbe, dhe 4,5% në më shumë se një gjuhë, kurse një shkollë e mesme funksiononte në gjuhën turke –(0.7%). Në total, numri i nxënësve në arsimin e mesëm përfshinte, gjithsej: 86.830 nxënës. Moshë e mësimdhënësve, shprehet nga 41-50 (43%) e arsimtarëve në total, i përkasin kësaj grupmoshe), kurse numri mesatar i nxënësve për një shkollë të mesme, është në 932 nxënës, dhe numri i nxënësve për një klasë, varion nga: 26, deri në 31 nxënës!

Në vitin shkollor 2003/04, është hartuar për herë të parë kurrikulumi për klasën e 10-të, e cila do të ndiqet edhe nga klasa e 11-të, dhe e 12-të. Shpenzimet për arsim të buxhetit të Kosovës, përfshijnë rreth (15%) të shpenzimeve totale buxhetore (11.8%) për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, 0.18% për arsimin e personave me nevojë të veçanta/ të kufizuara, dhe 2.1% për arsimin e lartë).

Procesi i reformave: Arsimi i detyrueshëm, është sanksionuar deri në klasën e 9-të të arsimit fillor nga viti 2002/2003. Financimi i shkollave fillore dhe të mesme, është përgjegjësi komunave me rreth 77% të shpenzimeve publike në arsim. Që problemi i mësimdhënies të sillet në nivele të kënaqshme, në Universitetin “Hasan Prishtina” të Prishtinës, më konkretisht në fakultetin e Edukimit, janë zhvilluar trajnime disavjeqare për mësimdhënësit. Gjithashtu, është hartuar një kurrikulum pilot për arsimin e mesëm profesional. Nga Agjencia për Standarde dhe Vlerësim, më 2003 u realizua një testim në shkallë kombëtare për klasën e 9-të.

Në procesin e vazhdueshëm të reformimit të sistemit të arsimit, janë bërë revidime, ashtu si edhe legjislacione të reja, në përputhje me modernizimin e shkollës. Nisur nga përpjekjet për decentralizim të sistemit arsimor në përputhje me intereset e nxënësve dhe të kuadrit mësimor , është sanksionuar përgjegjësi më e madhe, transparencë, dhe qeverisje standarde arsimore. Në shkollat fillore dhe të mesme për shembull, janë themeluar borde (këshilla) të shkollave dhe ku marrin pjesë edhe prindërit që, mbikqyrin menaxhimin e shkollës në mënyrë më aktive. Matjet e rezultateve në mësim, po ashtu, janë një përpjekje kontinuitive në

përcjelljen e pjesëmarrjes së nxënësve në jetën aktive mësimore, dhe në vijimin e tyre për rritjen e efikasitetit, paga më të larta për mësimdhënës.

Përmirësimi adekuat dhe reformimi dinamik i sistemit të arsimit, është garancë e fuqizimit të standardeve të moderuara në arsimit. Sidomos në Kosovë, *“hulumtimet në lidhje me tregun e punës, sistemin e arsimit dhe kapitalin njerëzor në Kosovës, tregojnë se në aspektin individual, niveli i shkollimit është një përcaktues kryesor si i probabilitetit për të siguruar dhe mbajtur vendin e punës, ashtu edhe për nivelin e të ardhurave”* (Adnett, 2004).

3.7. Metodologjia e kërkimit

Kjo pjesë e studimit trajton çështjet e mëposhtme: Metodologjinë, Popullatën dhe mostrën e kërkimit, Instrumentet e kërkimit, Procesin e mbledhjes së të dhënave, Analizën e të dhënave. Studimi kryhet nga këndvështrime të ndryshme, prandaj u pa e udhës që .duhen përmbledhur lloje të ndryshme të dhënash duke përdorur metoda të ndryshme. Në këtë mënyrë kjo punë kërkimore është në formën e një kërkimi ku përdoren metoda mikse, sasiore dhe cilësore.

Për të vërtetuar hipotezat të mësipërme u zgjodhën pyetësorët, me pyetje të mbyllura dhe të hapura. Këta pyetësorë janë bërë për dy kategori të rëndësishme siç janë mësimdhënësit dhe nxënësit.

Pyetësorët janë kryesisht me pyetje gjysmë të strukturuar, të mirëformuluara por dhe që kanë vend për shprehjen e mendimit, apo dhënien e ideve dhe sugjerimeve.

Për të shkuar tek konstatimi faktik i situatës, ne nuk mund të mënjanojmë mësimdhënësit që janë një kategori aq e rëndësishme në procesin e mësimdhënies.

Krahas pyetësorëve, në këtë studim, janë përdorur edhe intervistat e fokus grupi.

Në intervistat u përdorën pyetje pothuajse të njëjta me pyetësorët e plotësuar nga nxënësit dhe mësimdhënësit, por sigurisht në mënyrë të përmbledhur.

Intervistat janë zhvilluar me dejtues shkolle, të lokalizuar në zona urbane dhe rurale. Ata u pyetën mbi metodologjitë që përdorin mësuesit në shkollat e tyre në orën e mësimin të Gjuhës shqipe.

Strategjia jonë e kërkimit kundrejt shkaqeve dhe arsyeve, e dobësive, e cilësisë së ulët etj., do të bazohet në mjetet e përdorura, nga popullata që do t'i përzgjedhim kampionët e duhur, dhe pastaj grumbullimi dhe analizimi i të dhënave, si domosdoshmëri e shqyrtimit të metodës sasiore me metodën e kërkimit. Në fund, në bazë të arritjes së zbërthimit dhe nxjerrjes së fakteve, do të kemi mundësi që t'i identifikojmë faktorët e caktuar, dhe sigurisht rezultatet

do të jenë më serioze, më të qëndrueshme në raport me zbatimin e strategjisë më bashkëkohore të mësimdhënies në lëndës së Gjuhës shqipe.

3.7.1 Popullata dhe kampionimi

Duke qenë se studimi ynë kryhet mbi metodologjitë e lëndës së Gjuhës Shqipe në shkollat e sistemit të arsimit të mesëm të ulët (nga klasa 6-^{të} deri në klasën e 9-^{të} , duke qenë se lënda e Gjuhës shqipe zhvillohet kryesisht në këto klasa) në komunën e Gjakovës, popullata është në dy kategori: mësimdhënësit e Gjuhës shqipe dhe nxënësit e këtij sistemi arsimor.

Për këtë popullatë të dhënat janë e kësaj kategorie popullata janë mundësuar nga Drejtoria për Arsim në komunën e Gjakovës.

Referuar Drejtorisë për Arsim në komunën e Gjakovës (2018) (Drejtoria për Arsim.Tel. 038 200 44006) fillimisht në lidhje me mësimdhënësit e Gjuhës shqipe kemi këto të dhëna:

Tabela 4. Numri i shkollave të AMU dhe mësimdhënësve të Gjuhës shqipe sipas gjinisë në Gjakovë

Emri i shkollës	M	F	Gjithsej
1. "Emin.Duraku"			3
2. "Mustafa Bakija"(1-5)			0
3. "Fehmi Agani"			3
4. Yll Morina			10
5. "Mazllom Këpuska"	1		3
6. "Zekeria Rexha"	1		6
7. "Selman Riza"			4
8. "Zef L.Marku"		1	1
9. "Anton Qetta"			2
10. "Pjetër Muqaj"		1	
11. "Zenel Sadiku"			1
12. "Luigj Gurakuqi"			1
13. "Ganimete Tërbeshi"		1	
14. "Sylejmon Vokshi"			1
15. "Jahë Salihu"			0

16. "Bajram Sadriu"	1		1
17. "Ardhmëria"	1	1	2
18. "Dy dëshmorët"	1		1
19. "Gjergj Fishta"		2	2
20. "Haxhi Hoti"	2	2	4
21. "Shaban Golaj"	1	1	2
22. "7 Shtatori"	1		1
23. "Durak Ahmeti"	3		3
24. "Kongresi Manastirit"	1		1
25. "Pjetër Bogdani"	1	1	2
26. "Malush Stavileci"	1		1
27. "Isa Boletini"	1		1
28. "Ukshin Miftari"	1	1	2
29. "Fan Noli"	1		1
30. "Engjëll Gjoni"	1		1
31. "Shtjefën Kurti"	1		1
32. "Rilindja"	1		1
33. "Ahmet Rrustemi"		1	1
34. "Ali Hasi"	1		1
35. "Deshmoret e Dushkajes"	1		1
36. "8 Dëshmorët"	1		1
37. "Deshmoret Lleshi"		1	1
38. "Dëshmor. e Kombit"	2		2
39. "Dëshmorët e Hereqit"	1		1
Gjithsej:	30	45	75

Siç paraqitet në tabelën më sipër, në komunën e Gjakovës ndodhen 39 (tridhejtë e nëntë) shkolla të ciklit të arsmi të mesëm të ulët. Nga këto 9 (nëntë) shkolla janë në zona urbane dhe 30 shkolla janë në zona rurale, pra në rrethinat e Gjakovës.

Në lidhje me mësimdhënësit, në këto shkolla japin mësim gjithsesi 75 mësimdhënës, të cilët kanë dallime gjinore mes tyre të pasqyruar më poshtë:

Janë përdorur formati elektronik *samplezize* për të llogaritur kampionimin, ku për një numër popullate 2403 nevojiten 322 pyetësor. Duke iu referuar ‘The Research Advisors’ (2006), kjo mostër ka një interval të besimit 95% me kufinj të gabimit 3.5%.

Tabela 5. Të dhënat sipas Gjinisë

		N	%
Gjinia e mësimitdhënsve	Femra	30	60
	Meshkuj	45	40
	Gjithsej	75	100

Ndërsa në tabelën 6 jepen të dhëna në lidhje me përvojën e mësimitdhënsve ku edhe aty pati dallime të rëndësishme.

Tabela 6. Të dhënat mbi përvojnë e mësimitdhënsve

		N	%
Përvoja e mësimitdhënsve	1 vit		
	5 vjet	5	6.6%
	10 vjet	9	12%
	15 vjet	12	16%
	16-20 vjet	11	14.6%
	25-30 vjet	18	24%
	30- 35 vjet	14	18.6%
	36-40 vjet	6	8%
Gjithsej		75	

Për të parë dallimet e mundshme në gjininë dhe përvojën e punës së pjesëmarrësve në hulumtim, u zhvillua testi i hi-katrorit. Vlerat e u fituan nga testi i *hikatrorit*, treguan që ka dallime të vlefshme statistikore në të gjitha variablat. Këtu, dallimet në gjini janë të shprehura përmes $\chi^2(1 N=322)= 5.760, p =.016$.

Gjithashtu ka dallime të vlefshme statistikore edhe për sa i përket përvojës në punë. $\chi^2(2, N=322)=22.95, p=.00$.

-Kategoria tjetër e popullatës janë nxënësit e ciklit arsimor të mesëm të ulët në Komunën e Gjakovës. Në këtë komunë ekzistojnë 39 (tridhjetë enëntë) shkolla, të cilat janë në zona urbane dhe rurale. Vlen të përmendet që numri i nxënësve në shkolla ka një shpërndarje të pa barabartë. Në tabelën më poshtë jepen të dhëna të detjuara për secilën nga klasat, nga klasa e 6-të në të 9-të. është me rëndësi të përmendet fakti se në tabelën më poshtë jepen edhe të dhëna mbi dallimin gjinor.

Tabela 7. Numri i nxënësve në Arsimin e Mesëm të Ulët në komunën e Gjakovës sipas klasave dhe gjinisë

Shkolla	Klasa 6			Klasa 7			Klasa 8			Klasa 9			Gjithsej
	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	
1 Emin Duraku	26	29	55	24	38	62	31	32	63	45	30	75	255
2 Yll Morina	94	104	198	107	77	184	106	107	213	104	79	183	778
3 Fehmi Agani	36	30	66	33	34	67	30	21	51	35	29	64	248
4 Mazllum Këpuska	61	44	105	66	46	112	61	59	120	70	59	129	466
5 Zekiria Rexha	117	101	218	126	81	207	101	86	187	102	86	188	800
6 Selman Riza	33	30	63	29	31	60	46	28	74	35	31	66	263
7 Zef Lush Marku	32	22	54	27	25	52	21	16	37	36	26	62	205
8 Anton Çetta	8	8	16	6	15	21	25	13	38	10	14	24	99
9 Pjetër Muqaj	2	4	6	3	2	5	2	6	8	4	2	6	25
10 Zenel Sadiku	4	7	11	13	4	17	9	7	16	10	2	12	56
11 Luigj Gurakuqi	7	9	16	4	6	10	12	5	17	8	8	16	59
12 Ganimete Tërbeshi	7	10	17	4	9	13	7	9	16	7	10	17	63
13 Sylejman Vokshi	11	11	22	5	6	11	8	8	16	5	6	11	60
14 Jahë Salihu	10	8	18	10	7	17	13	19	32	14	4	18	85
15 Bajram Sadriu	5	10	15	5	5	10	6	5	11	11	6	17	53
16 Ardhmëria	6	5	11	5	6	11	4	4	8	5	3	8	38
17 Dy dëshmorët	10	10	20	9	12	21	12	12	24	10	10	20	85
18 Gjergj Fishta	13	12	25	11	16	27	22	16	38	19	23	42	132
19 Haxhi Hoti	21	29	50	38	28	66	37	27	64	32	39	71	251
20 Shaban Gola	8	4	12	12	16	28	12	15	27	11	18	29	96

21	7 Shtatori	13	6	19	19	8	27	20	11	31	9	14	23	100
22	Durak Ahmeti Kongresi i	22	17	39	21	31	52	26	21	47	22	17	39	177
23	Manastirit	18	23	41	11	5	16	9	12	21	19	16	35	113
24	Pjetër Bogdani	11	13	24	22	18	40	17	18	35	9	10	19	118
25	Malush Stavileci	0	1	1	0	0	0	0	1	1	0	0	0	2
26	Isa Boletini	9	9	18	9	10	19	9	8	17	11	13	24	78
27	Ukshin Miftari	14	12	26	14	11	25	18	13	31	21	16	37	119
28	Fan Noli	10	8	18	11	8	19	14	8	22	13	15	28	87
29	Engjëll Gjoni	8	6	14	8	9	17	8	9	17	9	7	16	64
30	Shtjefen Kurti	2	9	11	6	2	8	5	7	12	2	9	11	42
31	Rilindja	2	5	7	4	4	8	1	5	6	5	4	9	30
32	Avni Rrustemi	11	7	18	18	5	23	19	17	36	15	11	26	103
33	Ali M.Hasi Dëshmorët e	16	7	23	16	16	32	10	12	22	22	12	34	111
34	Dushkajës	10	5	15	12	6	18	8	7	15	15	5	20	68
35	8 Dëshmorët	10	10	20	14	12	26	17	8	25	12	13	25	96
36	Dëshmorët Lleshi Dëshmorët e	6	7	13	16	6	22	7	18	25	16	9	25	85
37	Kombit Dëshmorët e	5	3	8	6	4	10	3	4	7	6	7	13	38
38	Hereqit Shk f muz Prenk	7	5	12	6	4	10	9	8	17	5	7	12	51
39	Jakova	13	17	30	7	7	14	3	2	5	0	0	0	49
	Gjithsej	698	657	1355	757	630	1387	768	684	1452	784	670	1454	5648

Në tabelën më sipër vihet re se numrin më të lartë të nxënësve e kanë shkollat e qytetit. Ndërsa në lidhje me dallimet gjinore, kemi një numër pak më të lartë meshkujsh por diferenca nuk është e ndjeshme.

Për sa i përket kampionimit, edhe për popullatën e nxënësve, i jemi referuar ‘The Research Advisors’ (2006). Edhe këtu u përdor formati elektronik *samplezize*, ku për një numër popullate prej 5468 nxënësish në total në shkollat e arsimit të mesëm të ulët në komunën e Gjakovës, nevojiten 686 pyetësor. Bazuar në llogaritje kjo mostër ka një interval të besimit 95% me kufinj të gabimit 3.5%.

E theksojmë faktin se, identifikimi dhe përzgjedhja e popullatës si mostra të hulumtimit në studimin tonë, pasqyron më pak kampion krahasuar me ndonjë lëndë tjetër. Kjo, për shkak

të natyrës së lëndës, por edhe për shkak të qasjes së popullatës ndaj lëndës së gjuhës shqipe. Ndarjen – shtresimin¹ (stratifikimin) e kampionëve, e kemi bërë në dy grupe (kategori):

- *Nga vendbanimet urban*
- *Nga vendbanimet rural*

Përzgjedhja e popullatës së anketuar, ashtu si edhe peshimin e kampionëve, e kemi bërë në bazë të pjesëmarrjes së përafërt të grupeve dhe pastaj, në bazë të metodologjisë së rastësisë. Shtresimi (stratifikimi), rrjedhë nga hulumtimi ynë në shkollat e komunës së Gjakovës , në ambiente urbane , dhe në ambiente rurale),

Përgjatë hulumtimit, kemi intervistuar 5 drejtues shkollash në komunën e Gjakovës mbi metodologjitë e përdorura në lëndën e Gjuhës shqipe të ciklit të mesëm. Përgjigjet e tyre bazohen mbi vezhimet e bëra në orë të caktuara mësimore.

Përgjatë hulumtimit, ne kemi bërë anketime me 686 nxënës për ta ndjekur qëndrimin e tyre në lidhje me lëndën, me procesin mësimorë, si dhe në lidhje me interesimin e tyre për lëndën e gjuhës shqipe.

Po ashtu, me qëllim të hulumtimit sa më të thelluar të problemit, kemi ndarë – shtresuar anketime me respondent të kategorive të tjera, si të personelit të shkollës, gjithsej 10 respondent (drejtor shkollash, pedagog, psikolog), dhe disa respondent (fokus grupi). Gjithashtu, jemi orientuar që në kuadër të fokus grupit, t'i intervistojmë edhe 10 respondentë që përfshijnë profile të drejtpërdrejta, të përafërta, po edhe dytësorë: zyrtar civilë, gazetar, studiues të gjuhës dhe publicistë. Këtë, e kemi bërë me qëllim që kampionët të jenë nga profile të ndryshme në mënyrë që, t'i identifikojmë më lehtë idetë, mendimet, dobësitë por edhe botëkuptimet, përcaktimet, përvojat që në përgjithësi, lidhen me pozicionin që ka aktualisht procesi edukativ – mësimorë, e me theks të veçuar, lënda e Gjuhës shqipe.

3.7.2. Instrumentet e kërkimit

Në këtë studim Instrumentet e kërkimit përbëjnë një larmishmëri për të marrë mendimin e nxënësve u përdorën pyetësor. Ndërsa për sa u përket mësimdhënësve u përdorën intervista gjysmë të strukturuar, duke qenë sa ata ishin të pakët në numër. Në studim u morën në shqyrtim edhe prindërit.

Në studim u morën në shqyrtim edhe prindërit me të cilët përdorëm fokus grupet.

Në mënyrë të përmbledhur, instrumentat e përdorur, janë: 1. Pyetësorët. 2. Intervistat. 3. Fokus – grupet

Le t'i shtjellojmë më në detaje këta instrumente.

1. Pyetësori:

“Pyetësori është padyshim një ndër mënyrat më të zakonshme për të mbledhur të dhëna nga pjesëmarrësit e përfshirë në hulumtim.” Shumica e pyetësorëve kanë për qëllim të mbledhin të dhëna të strukturuar, sikurse dhe në rastin e pyetësorëve të përdorur në realizimin e këtij kërkimi shkencor. Këta pyetësorë përfshijnë pyetje të cilat përmbajnë një grup përgjigjesh nga të cilat të anketuarit mund të përzgjedhin, por në to ka dhe pyetje të hapura që i japin mundësi pjesëmarrësve të japin përgjigjet e tyre individuale.

Në këtë mënyrë pyetësorët e përdorur në këtë studim kanë shërbyer jo vetëm për të mbledhur të dhëna faktike, në rastin tonë vitet e punës së mësuesve, numri i nxënësve në klasë, vendndodhja e shkollës, etj. por dhe për të mbledhur opinione, ide, qëndrime të nxënësve dhe mësuesve, në lidhje me tematikën e menaxhimit të klasës.

Përmbanë pyetje që rekomandohen në formë anketash. Pyetësori, ka përmbajtur një grup pyetjesh që lidhen me të dhënat e respondentëve (varësisht nga profili i tyre), si: moshë, gjinia, shkolla, klasa, profili etj. Dhe pyetjet e grupit tjetër lidhur me kërkesat e synuara si, qasjet, njohuritë, vlerësimet etj. Ky grup i pyetjeve ka përmbajtur edhe vlerësimet lidhur me

kushtet e mësimit, metodologjitë e mësimeve dhe aspektet që fokusohen lidhur me lëndën.

Përdorimi i pyetësorëve si instrumenta matës	
Avantazhet	Disavantazhet
<p>-Të dhënat e mbledhura janë në një format të standartizuar e të strukturuar</p> <p>-Përdorimi i pyetësorëve është një mënyrë e thjeshtë dhe e shpejtë në mbledhjen e të dhënave</p> <p>-Anonimati në plotësimin e pyetësorëve i lejon të anketuarit ta plotësojnë të pa ndikuar emocionalisht</p> <p>-Formati i një pyetësori mund të përfshijë të gjitha çështjet e temës së hulumtuar duke mbledhur të dhëna të larmishme brenda një kohe të shkurtër</p> <p>-Pyetjet me përgjigje të strukturuar krijojnë lehtësi për t'u analizuar nga hulumtuesi.</p>	<p>-Shpërndarja e një numri të lart pyetësorësh është e kushtueshme</p> <p>-Kur kampioni i përzgjedhur është relativisht i lartë si numër, nxjerrja e të dhënave nga pyetësorët e plotësuar kërkon kohë për t'u realizuar</p> <p>-Shpesh anonimati ndaj plotësimit të pyetësorëve rezulton në përgjigje jo të sinqerta të të anketuarve</p> <p>-Pyetësorët që kanë në përmbajtjen e tyre disa çështje për t'u anketuar shkaktojnë mërzitje dhe neglizhencë në plotësimin e tyre nga ana e pjesëmarrësve</p> <p>-Pyetjet përgjigjet e të cilave janë të hapura shpeshherë krijojnë paqartësi si rezultat i mosformulimit të duhur të përgjigjeve</p>

2. Intervista:

Krahas pyetësorëve, në këtë studim u përdorën edhe intervista si një përpjekje për nxjerrjen e rezultateve sa më të sakta në funksion të vërtetimit të hipotezave tona.

Në këtë mënyrë, përveç mësimit dhe nxënësve, si mostër u morën dhe drejtuesit e disa shkollave të arsimit të mesëm të ulët.

Aplikimin e intervistave me përfaqësues të organeve drejtuese të shkollave, e kemi bërë me qëllim të identifikimit të disa mendimeve dhe përgjegjësisve të tyre. Jemi orientuar të pyesim rreth kushteve në shkollë, rreth faktorëve që ata i konsiderojnë si pengues lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimorë. Në thellim më të detajuar, na kanë interesuar që t'i shtrojmë edhe pyetjet, sidomos që kanë të bëjnë me metodologjitë që aplikohen dhe me sjelljet e nxënësve gjatë procesit mësimorë.

Është realizuar për t'i mësuar informacionet dhe për t'i grumbulluar ato në lidhje me kapacitetet që ofron shkolla në mbarëvajtjen e mësimit, kushtet mbi të cilat realizohet procesi mësimor sa u përketë planprogrameve, reformave në mësim, disiplinës në shkollë, në mënyrë që t'i identifikojmë edhe faktorët material po edhe ata pedagogjik në mbarëvajtjen e procesit mësimorë. Në intervistë morën pjesë katër drejtues të shkollave të rëndësishme në Gjakovë.

3. Fokus grupet:

Nëse i referohemi gjithë problematikës, këtu hyjnë mësimit të cilët janë ta autorizuar lidhur me lëndën e gjuhës, dhe se përvoja e tyre në punën mësimore, përgatitja, njohuritë edukative, aspekti profesional, a janë të mjaftueshme për realizimin me sukses të mësimit. Synim ynë për t'i identifikuar dobësitë aktuale përmes intervistës, është një pasqyrë më gjithëpërfshirëse në aspekt të zhvillimit të arsimit.

Në vlerësimet lidhur me rëndësinë e gjuhës, kemi përzgjedhur mendime (diskutimet e shkurtëra) që nuk shkojnë në analizim të thelluar të objektivit, mirëpo janë të rëndësishme për t'i dhënë më shumë rëndësi temës. Pse kemi bërë këtë hap ?

Sikur t'i qasëshim gjerësisht temës, shumë më gjerësisht mbi hulumtime jo vetëm në shkolla por edhe në administratë, në institucione të artit dhe të kulturës, në media, do të mbeteshim të befusuar me shkallën e ulët dhe tejet të dobët të përdorimit të gjuhës. Kemi një gjendje

që, është e pazakontë. Sirtarët, arkivat, faqet e shtypit të shkruar, dokumentet, letrat, shkresat e ndryshme etj., po t'i hulumtonin, do të hasim në një trajtim të gjuhës në mënyrën më të pavëmendshme të mundshme.

Kemi një trajtim të padijshëm të gjuhës përmes shkrimit, dhe sigurisht të padinjitetshëm në përmasa. Interesimi i dobët dhe trajtimi aspak i denjë i gjuhës, mund të jetë shumë më i theksuar në publik dhe në institucionet publike se sa në shkollë. Këtë konstatim, mbase e bëjmë në formë dytësore, në kontekst dhe për ta kuptuar rëndësinë dhe përgjegjshmërinë që, gjithmonë duhet ta kemi ndaj gjuhës s'i një prej attributeve më të rëndësishme të një komuniteti.

Në formë anketimi me vetëm një pyetje, kemi përzgjedhur tre persona që japin vlerësimin e tyre për gjuhën. Kemi përzgjedhur një jurist, një gazetar dhe një studiues të gjuhës. Për të tre, kemi ofruar këtë pyetje me të njëjtën përmbajtje: “*Si e vlerësoni rolin e gjuhës?* “

3.7.3 Dizenjimi i pyetësorit

Pyetësorët nisin me një informim të objektit të studimit, pjesë e kampionimit, mbi qëllimin dhe objektivin e këtij studim, gjithashtu citohet mjaft qartë se pjesëmarrja është në mënyrë vullnetare dhe anonime në të njëjtën kohë. Atyre u kërkohet që të tregohen të sinqertë në përgjigjet e tyre.

Pyetësori përbëhet kryesisht nga dy lloj pyetjesh, pyetje të mbyllura dhe të hapura. Lloji i parë i pyetjeve ka të bëjë me vendosjen e një shkalle si Psh. “Sa? Ku si përgjigje duhet të zgjidhet mes: *po, jo, aspak, pjesërisht, plotësisht*.

Një lloj tjetër pyetjesh janë pyetjet ku studentëve u kërkohet të shprehin dakordësinë në lidhje me pohimet e dhëna, duke qarkuar një nga shprehjet:

Po, Jo, Deri iku, Aspak

Lloji i tretë i pyetjeve përbëhet nga pyetje me alternativa, dhe ketu u kërkohet nxënësve të shprehin dakordësinë ose mosdakordësinë në lidhje me një listë pohimesh. Krahas këryre pyetësorëve ku në fund ka edhe disa pyetje të hapura.

Duhet theksuar se pyetësi ndahet në gjashtë seksione.

Seksioni i parë jepen të dhëna të përgjithshme, si mosha, gjinia, venbanimi, niveli i arsimit, mjedisi ku vepron.

Seksioni i dytë ka pyetje specifike mbi metodologjitë e mësimdhënies së lëndës së Gjuhës shqipe.

Seksioni i tretë ka pyetje të hapura, si: Listoni, Përmendi etj.

3.7.4. Procesi i mbledhjes së të dhënave

Aplikimin e sistemit të hulumtimit përmes anketave dhe intervistave, për një pjesë të popullatës, nuk e kemi bërë me ndonjë sipas ndonjë paracaktimi paraprak. Nuk kemi bërë dallim në përzgjedhje e kampionëve, por këtë e kemi bërë sipas metodës së rastësisë, dhe kjo do të thotë se propabiliteti i të përzgjedhurve është i njëjtë. Me këtë sistem, themi që statistikën e kampionëve të përzgjedhur janë të vlefshme për popullatën në secilën komunë. Metodologjinë e rastësisë, e kemi përdorur me popullatën e nxënësve, të familjarëve dhe të personelit shkollorë.

Sa i përketë popullatës së mësuesve, përzgjedhjen e kemi bërë sipas përkatësisë: intervistimin e tyre e kemi bërë duke u bazuar në faktin se kemi të bëjmë për një lëndë të caktuar. Kjo do të thotë se, nuk kemi mundur që lidhur me lëndën e gjuhës shqipe, për shembull, t'u referohemi mësuesve të lëndës së biologjisë, të matematikës, të gjeografisë etj. Praktikisht, ne kemi intervistuar të gjithë mësuesit e lëndës së gjuhës shqipe për secilën shkollë, për secilën klasë dhe për secilën gjeneratë.

Sa i përketë popullatës, përcaktimi shtresor i tyre nënkupton lokacionin e veprimit, shkollën, përgatitjen profesionale etj. Peshimi i kampionëve, e kemi bërë sipas numrit të të anketuarëve, dhe analizat e zberthimit i kemi bërë brenda grupit. Mundësia e gabimeve, bazuar në agjendën e përzgjedhjes së kampionëve dhe në limitin e tyre, nënkupton një

diferencë prej (5%). Në raport me konfidencën e atyre që kemi intervistuar, përgjigjet lidhur me problemet sillen në interval besueshmërie të plotë, dhe ndoshta kalkulimet pyetje – përgjigje mund të mos i përmbushin objektivat e synuar deri në 10 -15%.

Bazuar në mjaftueshmëritë e sigurimit të kampionëve, kemi mundur të kemi më shumë tentime për anketime - intervista nga popullacioni, për shembull në më shumë shkolla ose në më shumë klasë. Këtë, edhe e kemi bërë sepse, në raste të këtilla nuk mund të paragjykohet fakti se, të gjitha tentimet për anketime dhe intervista mund të rezultojnë të suksesshme. Lidhur me kampionët që përfshijnë mësuesit, kemi ndjekur objektiva mjaftë të sigurtë. Fillimisht, kemi pasur tentime t'i marrim 30 mësues, mirëpo 7 prej tyre nuk i janë përgjigjur ftesës sonë. Ndërkaq, 23 mësues kanë bashkëpunuar në masë të konsiderueshme – të dëshiruar. Intervistimit me përgjigjet e tyre, i janë përgjigjur në nivel deri diku të kënaqshëm, deri në (70%) nga pyetjet e parashtruara.

Në synimin për intervistim të personelit shkollorë (drejtori, pedagog, psikolog), nuk kemi parashikuar ndonjë limit për shkak se, si një popullatë deficitare, jemi bazuar në arritjen e një objektivi për t'i intervistuar, detyrimisht 10 respondentë, dhe nuk kemi synuar më shumë të intervistuar. Qasja jonë, ka qenë strikte: intervistimin e personelit shkollorë.

Në kuadër të hulumtimit, kemi trajtuar problemet në fokus grupe. Po ashtu, jemi orientuar me qëllim që t'i intervistojmë edhe 5 respondentë që përfshijnë profile të përafërta, po edhe profile dytësore: 1 zyrtar civil, 1 gazetar dhe 1 studiues të gjuhës. Këtë objektiv, e kemi lidhur me faktin që ta plotësojmë sa më gjerësisht hulumtimin tonë me referenca, po edhe me të dhëna më të shumëta, krahasuar me ekskluzivitetin apo me veçantitë që i përmbanë tema jonë. Qasja në hulumtim ka qenë strikte: lënda e gjuhës shqipe.

Të dhënat, në fakt përgjigjet e grumbulluara pasqyrojnë statistika të kategorive që janë pjesë e popullatës. Përzgjedhjet, nuk janë të thjeshta, mbi të gjitha, i përgjigjen hulumtimit tonë.

(vlefshmëria e pyetsorëve) Kurse, analizat statistikore të të dhënave, janë përshkruese dhe testuese. Në të parën, pasqyrohen informata dhe të dhëna themelore, pasqyrohen përgjigjet që burojnë nga pyetjet e parashtruara. Në të dytën, bëjmë testimin e hipotezave që kanë të bëjnë me përgjigjet e mësimdhënësve dhe të respondentëve të tjerë, gjithnjë duke u mbështetur

në dallimet e tyre të gjinisë, të mjedisit shkollorë, nivelit socio – kulturorë, botëkuptimit edukativ, cilësive përgatitore – profesionale etj.

KAPITULLI IV

TË GJETURAT DHE REZULTATET E HULUMTIMIT

4.1 Analiza sistematike e të dhënave

4.1. Niveli i përgjithshëm i pranimi të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe

Niveli i përgjithshëm i pranimi të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe në klasa është përcaktuar me anë të 27 pohimeve të bëra në pyetësonin e stafit (të shkallëzuara këto në bazë të llojit të vështirësisë së nxënësit dhe shkallës së saj), të cilat janë të tipit Likert e variojnë nga:

1. Aspak Dakord, 2.Kundër, 3.Dakord, 4. Shumë Dakord.

Minimumi i përgjigjes së dhënë nga msimdhënsitt e anketuar është 27, mesatarja 61.03 dhe maksimumi 107. Këto rezultate, që janë paraqitur edhe në tabelën 1, më poshtë, na tregojnë se mësimdhënsit e anketuar e kanë nivelin e pranimi të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe mbi mesataren. Gjithashtu bie në sy se asnjë prej të anketuarve nuk ka qenë maksimalisht dakord për përfshirjen e metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe pavarësisht llojit të vështirësive dhe shkallës së tyre.

Tabela 1 Niveli i përgjithshëm i pranimi të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe

	N	Minimum	Maksimumi	Mesatarja	Devijimi standard
Niveli i përgjithshëm i pranimi të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe	75	27,00	107,00	161.0342	18.33558
Raste të vlefshme	75				

4.1.1. Lidhja që ekziston ndërmjet pranimi të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe në klasa dhe shkallës së vështirësisë të tyre.

Për të përcaktuar marrëdhënien midis dy variablave: pranimi i përgjithshëm i metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe dhe shkallës së vështirësisë së metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe u përdor koeficienti i Spearman-it, duke u nisur nga karakteri ordinal që kanë të dhënat. Ndërsa interpretimi i rezultatit është bërë duke përdorur indikatorët Davis (1971).

Nga sa duket në tabelën 2, midis nivelit të përgjithshëm të pranimi dhe shkallës së vështirësisë ekziston një lidhje mesatare negative ($p = -0.483$). Kjo do të thotë se me rritjen e shkallës së vështirësisë së mësimdhënësit, ulet niveli i pranimi të tyre nga mësuesit. Vlefshmërinë statistikore të rezultatit e tregon vlera e domethënies që është rigorozisht më e vogël se niveli 0.01 ($p < 0.01$).

Tabela 2 Korrelacioni midis nivelit të përgjithshëm të pranimit të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe dhe shkallës së vështirësisë së nxënësit

		Shkalla e vështirësisë së nxënësit
Niveli i përgjithshëm i pranimit të të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe	Spearman's Correlation	rho -.283**
	Sig. (2- drejtimesh)	.000
	N	589
**. Korrelacioni është i vlefshëm nga pikëpamja statistikore në nivelin 0.01 (2- drejtimesh)		

Tabela 3 Korrelacioni midis nivelit të përgjithshëm të pranimit të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe në klasa nga prindërit dhe shkallës së vështirësisë së nxënësit

		Shkalla e vështirësisë së nxënësit
Niveli i përgjithshëm i pranimit të të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe nga Prindërit	Spearman's Correlation	rho -.220**
	Sig. (2- drejtimesh)	.000
	N	157
**. Korrelacioni është i vlefshëm nga pikëpamja statistikore në nivelin 0.01 (e 2- anëshme)		

4.1.3. Pranimi i metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe në klasa nga ana e prindërve dhe shkallës së vështirësisë së nxënësve

Tabela 4 tregon se midis nivelit të përgjithshëm të pranimin nga ana e prindërve të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe dhe shkallës së vështirësisë të nxënësit ekziston një lidhje mesatare negative ($p = -0.038$). Kjo do të thotë se me rritjen e shkallës së vështirësisë së nxënësit, ulet niveli i pranimin të tyre nga prindërit e metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe. Korrelacioni është i vlefshëm nga pikëpamja statistikore përderisa vlera e domethënies është nën nivelin 0.01 ($p < 0.01$)

Tabela 4 Korrelacioni midis nivelit të përgjithshëm të pranimin të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe në klasa dhe shkallës së vështirësisë së nxënësit.

			Shkalla e vështirësisë së nxënësit
Niveli i përgjithshëm i pranimin të të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe	Spearman's Correlation	rho	-.219**
		Sig. (2- drejtimesh)	.000
		N	257

** . Korrelacioni është i vlefshëm nga pikëpamja statistikore në nivelin 0.01 (2- drejtimesh)

4.2. Marrëdhënia midis variablave demografikë dhe pranimit të edukimit gjithëpërfshirës

4.2.1. Marrëdhënia midis gjinisë së mësimdhënsit dhe nivelit të pranimit të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe në klasa të zakonshme

Për të hulumtuar ndonjë varësi të mundshme ndërmjet nivelit të përgjithshëm të pranimit të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe dhe gjinisë së mësimdhënsve të anketuar u përdor Testi- T për grupet e pavarura. Aplikimi i këtij testi bëhet në kushtet e homogjenitetit të variancave dhe të një shpërndarjeje normale të variablave të rastit. Plotësimi i këtyre kushteve u provua përmes testit Levene (tabela 4). Vlera e domethënies e nxjerrë nga testi rezultoi më e madhe se 0.05 ($p=0.96>0.05$), gjë që dëshmon homogjenitetin e variancave midis grupeve të pavarura meshkuj e femra. Pas këtij konfirmimi u aplikua testi i sipërpërmendur dhe nga krahasimi i vlerës së gjetur të domethënies me vlerën e nivelit të besimit ($p=0.98>0.05$) nuk rezulton të ketë një diferencë të vlefshme statistikore midis mesatareve të grupeve të pavarura meshkuj e femra. Kjo do të thotë që nga pikëpamja mesatare nuk ka dallim midis femrave e meshkujve përsa i përket nivelit të përgjithshëm të pranimit të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe.

Tabela 5. Statistikat përshkruese të gjinisë në lidhje me pranimin e metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe

Gjinia		N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
Pranimi i përgjithshëm	Mashkull	30	61.1333	18.83272	3.43837
	Femër	45	61.0215	18.31026	1.19966

Tabela 6. Krahasimi i mesatareve me anë të Testit- T për grupet e pavarura (gjinia në lidhje me pranimin e metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe

		Testi Levene për barazinë e variancave		Testi- T per barazine e mesatareve						
		F	Sig.	t	Shkallet e lirisë(df)	Sig. (2-drejtimeshe)	Diferenca e mesatareve	Gabimi standard	Intervali i besueshmërisë 95% i diferencave	
									Kufiri i sipërm	Kufiri i poshtëm
Pranimi i përgjithshëm	Barazia e supozuar e variancave	0.003	0.855	0.031	168	.975	.11187	.356338	6.90478	7.12853
	Barazia e pasupozuar e variancave			0.003	36.423	.976	.11187	.364164	7.49449	

4.2.2.1.Marrëdhënia midis moshës së mësimdhënsit dhe nivelit të pranimiit

Tabela 7 Statistika përshkruese për nivelin e përgjithshëm të pranimit të metodave bashkëkohore në mësimin e gjuhës shqipe sipas grupmoshës së mësimdhënsit

	N	Mesatarja	Devijimi standard	Gabimi standard	Intervali i besueshmërisë 95% për mesataren		Minimumi	Maksimumi
					Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm		
1-10	14	60.5769	20.5376	4.0276	52.2818	68.8721	27.00	95.00
11-20	23	63.1775	18.8882	1.7847	59.6509	66.7241	27.00	107.00
21-30	18	60.7097	16.9536	1.7580	57.2181	64.2012	27.00	100.00
31-40	20	54.8125	17.7080	3.1303	48.4281	61.1969	28.00	86.00
Total	75	61.0342	18.3355	1.1306	58.8080	63.2605	27.00	107.00

Nga kryerja e testeve të sipërpërmendura mbi mësimdhënsit pjesëmarrës, të ndarë sipas grupmoshave, u morën këto rezultate: Testi Levene mbi homogjenitetin e variancave zbuloi se variancat e grupeve nuk janë të ndryshme nga njëra –tjetra. Përkundrazi ato janë afër njëra-

tjetrës (vlera e domethënies e statistikës Levene e kalon nivelin 0.05 siç duket në tabelën 6: $0.83 > 0.05$). Kjo gjë lejon realizimin e analizës së variancave.

Nga analiza e variancave (ANOVA) nuk rezultoi të kishte një diferencë të vlefshme nga pikëpamja statistikore midis pritjeve matematike të grupmoshave të ndryshme. (Tek tabela 7 shiko vlerën e domethënies: $p=0.15 > 0.05$). Kjo do të thotë që niveli i përgjithshëm i pranimit nuk varet nga mosha e mësimitdhënësve.

4.3 Të dhëna të përgjithshme

4.3.3 Përgjigjet e mësimitdhënësve

Zbërthimi i objektivit të rezultateve nga ky studim, është pasqyrë e studimit të metodologjive të mësimitdhënësve në lëndën e Gjuhës shqipe. Nga pikëpamja e studimit teorik të temës, kjo pjesë përfshinë të dhëna të nxjerra nga një hulumtim më i detajuar që ka për synim, t'i identifikojë qoftë aspektet pozitive, dhe qoftë ato negative. Prej hipotezës kryesore, dhe pastaj hipotezave ndihmëse, ishte e domosdoshme për ta parë problemin në rrafshin praktik që lidhet me referencat e nxjerra në bashkëbisedim, me pyetësorë, anketa, statistika përmes metodologjive të caktuara.

Në këtë kapitull analizojmë të dhënat duke gjetur përgjigje për pyejtet kërkimore dhe vërtetuar hipotezat. Fillimisht, shqyrtojmë të dhënat e përfuara nga pyetësorët e zhvilluar me mësimitdhënësit dhe nxënësit.

Do të ishte e pamundur të nisnim pa analizuar të dhënat e përgjithshme mbi individët e përfshirë në kampionim.

Thekësojmë se për përpunimin e të dhënave statistikore është përdorur analiza statistikore përmes paketës SPSS, versioni 19.0 për Windows

Mësimdhësit janë më të drejtpërdrejtë në përgjigje. Fakti që ata janë kryesorët në procesin e mësimdhënies, i bënë ata më të ndjeshëm, më përgjegjës, po edhe më fleksibël. Ata shprehen lirshëm, qoftë kur kanë vërejtjet e tyre, qoftë kur duhet ta ndajnë rezultatin, qoftë kur kanë sukseset e tyre etj. Ne, po zgjedhim sipas metodës së rastësisë disa përgjigje të mësimdhënësve prej gjashtë (6) pyetjeve të parashtruara. Mësimdhënësit, janë nga pesë (5) shkolla të mesme: prej tyre, tri (3) shkolla të mesme urbane, dhe dy (2) shkolla të mesme rurale.

1. Gjina e mësimdhënësve

Prej 75 mësimdhënësve të intervistuar, (57%) i përkasin gjinisë mashkullore, kurse (43%) gjinisë femërore. Struktura e dallimit gjinorë të mësimdhënësve, është e theksuar: në zonat urbane (75.6%) e mësimdhënësve janë femra, kurse (25.4%) janë meshkuj, ndërsa në zonat rurale (80.4%) janë meshkuj, kurse (19.6%) janë femra.

Diferenca në gjini, ka shkaktarë të ndryshëm. Por ajo që është më e përafërt, lidhet me faktin se dallimi gjinorë në zonat rurale, përqindja më e vogël e femrave e pasqyron ambientin, botëkuptimet, kushtet ekonomike por edhe nepotizmin. Por, ka edhe një problem, meshkujt, janë të prirur që të orientohen më shumë në fusha të tjera të shkollimit dhe punësimit gjatë viteve të fundit, si në biznes, dhe orientimi për t'u larguar nga vendi. Dallimi në zonat urbane ku përkatësia gjinore e femrave është më e avancuar, tregon për thyerjet definitive të botëkuptimeve, kushtet me të mira ekonomike dhe emancipimin e vazhdueshëm gjinorë. Por, viteve të fundit, ka një prirje që femrat të orientohen që të punojnë më shumë në sistemin arsimorë dhe të edukimit.

Gjinia e mësimeve:




Figura 1. Të dhëna të përgjithshme mbi gjininë e mësimeve

Gjinia e mësimeve sipas zonave urbane dhe rurale jepen në figura më poshtë.




Figura 8. Të dhëna mbi gjininë e mësimeve në zonat urbane




Figura 9. Të dhëna mbi gjinia e mësimeve në zonat rurale

Më tej mësimitdhënësit u pyetën mbi nivelin e përgatitjes të tyre. Më konkretisht pyetja konsistonte: “ *Cili është niveli juaj më i lartë arsimor ?* “

Shkalla e arsimit, kryesisht është e kënaqshme. Mësimitdhënësit në sistemin e arsimit parauniversitar, kryesisht janë me përgatitje adekuate. Prej të anketuarëve, (60.5%) janë me fakultet të Gjuhës Shqipe. Edhe ata që nuk e kishin fakultetin, sepse Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe në Gjilan kishte nxjerrë në periudhat e kaluara mjaft mësimitdhënës me orientim dyvjeçarë të përgatitjes (niveli bachelor), viteve të fundit në mënyrë të përgjithshme, u janë nënshtuar përgatitjeve dhe dhënies të provimeve shtesë për t’u kualifikuar në arsimin superiorë. Kjo kategori, përfshinte (16 %) të mësimitdhënësve. Nga mësimitdhënësit e anketuar, (23.5 %) ishin me Master.

Përpjekjet e reformave, pasqyrojnë ngritjen e nivelit cilësorë të mësimitdhënies, krahasur me të kaluarën. Këta hapa, ndikojnë pozitivisht në avancimin e procesit mësimitdhënës sipas standardeve bashkëkohore.

Niveli i përgatitjes:




Figura 10. Niveli i përgatitjes së mësimitdhënësve

Mësimitdhënësit gjithashtu u pyetën edhe mbi *trajnimet profesionale mbi procesin e mësimitdhënies.*

Ndjekja e trajnimeve nga mësimitdhënësit është një tjetër pikë kyçe në formimin e mësimitdhënësve, duke ndikuar kështu në mënyrë të drejt për drejtë në një proces cilësor mësimitdhënës. Aspekti empirik i zhvillimit të procesit mësimitdhënës, nënkupton edukim dhe zhvillim më cilësor në mësimitdhënies, dhe sidomos në zbatimin e metodologjive. Trajnimi i

vazhdueshëm i mësimdhënësve, ndikon në arritjen e objektivave të shkollës në aspekt të organizimit dhe zbatimit të procesit.

Për matjen e këtij variabli i jemi referuar të dhënave të përftuara nga Drejtoria për Arsim (2018), në komunën e Gjakovës.

Në këtë kontekst mësimdhënësit e trajnuar mbi lëndën e Gjuhës shqipe në shkollat e arsimit të mesëm të ulët në komunën e Gjakovës pasqyrohen në figurën më poshtë sipas shkollave përkatëse. Trjanimet në figurën më poshtë jepen me frekuencat:

- ❖ *1- 2 herë*
- ❖ *3- 5 herë*
- ❖ *Mbi 5 herë*
- ❖ *Asnjëherë*

Kështu, referua figurës më poshtë kemi këto konstatime:

Në shkollën “ YLL MORINA”, (70 %) e mësimdhënësve deklarojnë se kanë mbi 3 (tre) trajnime të zhvilluara, ndërsa (30 %) e tyre deklarojnë se kanë 1-3 trajnime të zhvilluara. Kjo tregon që në këtë shkollë mësimdhënësit janë të trajnuar mjaftueshëm.

Nga ana tjetër kemi shkollën “MUSTAFA BAKIJA”, mësimdhënësit të cilët u morën si kampion deklaruan se nuk kanë zhvilluar asnjë trajnim.

Për sa i përket shkollave të tjera shpërndarja është në mënyrë heterogjene mes alternativave të tjera.

Trajnime




Figura 11. Frekuenca e trajnime të mësimeve në komunën e Gjakovës

Referuar këtyre të dhënave, si përmbledhje themi se nga 75 mësime të Gjuhës shqipe, 3 nuk janë trajnuar asnjëherë. Pjesa më e madhe 49 mësime apo (65.3%) e tyre janë trajnuar mbi pesë herë. Kjo tregon se mësime të tilla janë mirë të trajnuar.

Tabela 8. Të dhëna përmbledhëse mbi frekuencën e trajnimit të mësimeve

Frekuenca	1-2 herë	3- 5 herë	Mbi pesë herë	Asnjëherë	Gjithsej
Nr. i mësimeve	3	20	49	3	75

Ndërsa përgjigjet e pyetjes mbi njohuritë mbi organizimin dhe zbatimin e procesit jepen në Figuran vijues:




Figura 12. Mbi njohuritë e mësimeve mbi metodologjitë

4.4. Të dhëna mbi hipotezën e parë

Hipoteza e parë e studimit është: Metodologjitë bashkëkohore të mësimit të përdorura në mësimin e Gjuhës shqipe ndikojnë në ngritjen e cilësisë së mësimit dhe mësimnxënies.

- Si një mënyrë për të gjetur faktorët që shkaktojnë vështirësi në aplikimin e metodologjive, dhe si pasojë edhe vështirësi tek nxënësit, mësimitdhënësit u pyetën mbi praktikën motivuese. Duke iu referuar çfarë u tha më lart në kapitullin teorik mbi mosinteresimin e nxënësve në lëndën e Gjuhës Shqipe, na vjen natyrshëm edhe pyetja:
A ndikojnë metodologjitë e mësimitdhënies të përdorura në mësimin e Gjuhës Shqipe në ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies dhe mësimitnxënies?

Në pyetjen e këtillë është e rëndësishme edhe për faktin se në lëndën e Gjuhës Shqipe në Kosovë kanë filluar të vërehen dobësi të theksuara tek ata që e mbarojnë shkollimin parauniversitar.

65 mësimitdhënës apo (87%) e tyre janë treguar të sigurtë dhe nuk e fshehin faktin se në përgjithësi, një pjesë e nxënësve diktojnë mos interesim jo të bollshëm në mësim, kjo na bën të kuptojmë se në klasë nuk përdoren mjaftueshëm praktika motivuese. Vetëm një pjesë e pa konsiderueshme e mësimitdhënësve, 10 ose (13 %) e tyre përgjigjen pozitivisht në këtë pyetje.

Në tabelën më poshtë jepen të dhënat më të detajuara në lidhje me këtë çështje.




Figura 25. Të dhëna mbi interesimin e nxënësve në orën e mësimit të Gjuhës shqipe.

Më tej, në përpjekje për të gjetur përgjigje konkrete për pyetjen e tretë kërkimore mbi vështirësitë në aplikimin e metodologjive efektive në procesin mësimor, mësimitdhënësit pyetën në mënyrë të tërthortë. Kështu , atyre iu parashtrua kjo pyetje?

-Cilët janë faktorët që shkaktojnë pengesa, probleme dhe interferime negative në procesin e mësimimit?

Bazuar në të dhënat e nxjerra sipas mësimdhënëve, faktorët kryesorë që shkaktojnë mosinteresimit për mësim kontinuitiv të nxënësve, rezultojnë këta:

- (15%) e tyre mendojnë se ndikimet e ambientit të jashtëm ose humbja e kohës nga daljet e vazhdueshme në rrethet urbane
- (35.%) mendojnë për ndikimet negative të teknologjisë
- Pjesa më e madhe mësimdhënësve (45 %) mendojnë se mbingarkesa e mësimdhënësit sjell një aplikim jo efikas të metodologjive të mësimdhënës
- Një përqindje e vogël e mësimdhënësve (5 %) mendojnë se një faktor pengues në motivimin e nxënësve është humbja e besimit dhe ndikimet e nepotizimit në sferën e mundësisë së punësimit pas shkollimit ,synimet për t'u larguar nga vendi.

Kështu, (60 %) mësimdhënës listojnë një numër të theksuar faktorësh që e zbehin interesimin e nxënësve në mësim. Kurse, (20 %) e mësimdhënësve besojnë që nxënësit janë mjaftueshëm të intersuar në procesin mësimorë, dhe se faktorët relevantë, dytësorë nuk ndikojnë në procesin mësimorë. Vlen të përmendet se (10 %) e tyre nuk dhanë përgjigje.

Të dhënat e mësipërme pasqyrohen më qartë në figurë e më poshtme.




Figura 26. Faktorët që shkaktojnë pengesa në procesin e mësimimit

Nisur nga të dhënat e mësipërme, vihet re që ekzistojnë një sërë arsyesh që sjell mosinteresim dhe si pasojë edhe vështirësi tek nxënësit, por kryefjala mbetet mosaplikimi i metodologjive adekuate.

Si një përpjekje për gjetjen e zgjidhjeve më të mira për problemin në fjalë, mësime dhënësit u pyetën fillimisht kështu:

“ A pajtoheni që duhet të funksionalizohet më shumë roli dhe rëndësia e lëndës së Gjuhës shqipe? “

Në këtë pyetje, (90.9 %) e mësime dhënësitve, pajtohen që duhet të funksionalizohet më shumë roli dhe rëndësia e lëndës së gjuhës shqipe ? Ndërsa, vetëm (9.1%) mendojnë se roli i kësaj lënde, është në nivel dhe se nuk ka nevojë ndëryrje, ose qasje tjetër.

Aplikimi i shumë metodologjive ndikon në funksionalizimin e rolit të lëndës:




Figura 27. Të dhënat nga mësime dhënësit mbi nevojën e aplikimit të metodologjive

Më tej, mësime dhënësit u pyetën edhe nëse ata mendojnë se duhet të funksionalizohet më shumë roli i Gjuhës shqipe apo nuk ka nevojë për qasje të tilla. Të dhënat jepen në figurën më poshtë.




Figura 28. Të dhëna nga mësime dhënësit mbi nevojën e funksionalizimit të lëndës së Gjuhës shqipe

Siç tregohet në tabelën më sipër, vihet re qartë që pjesa më e madhe e mësimitdhënëve (90 %) e mësimitdhënësve bien dakord që roli i lëndës së Gjuhës shqipe duhet të funksionalizohet më shumë.

Kjo tregon që në lëndën e Gjuhës shqipe ka nevojë për më shumë punë dhe risi.

4.5. Të dhëna mbi hipotezën e dytë të studimit

Hipoteza e dytë e studimit është : Zbatimi jo i duhur i metodologjive bashkëkohore të mësimitdhënies në mësimin e lëndës së Gjuhës shqipe sjell vështirësi tek nxënësit.

Duhet të theksojmë se kjo hipotezë lidhet ngushtë me hipotezën e parë.

Si një përpjekje për të nxjerrë rezultate sa më konkrete konkrete në funksion të vërtetimit të kësaj hipoteze, paraqiten përgjigjet e pyetjes :

➤ *A sjellin vështirësi në mësimnxënien e nxënësve përdorimi jo i duhur i metodologjive bashkëkohore të përdorura në mësimin e Gjuhës shqipe?*

Mësimitdhënësit e konsiderojnë të rëndësishme aplikimin e metodologjive, si një mundësi reale në rritjen e efikasitetit mësimorë dhe në ndjekjen e hapit kundrejt aplikimit të standardeve. Prej tyre (74.5%) i janë përgjigjur pozitivisht aplikimit të sa më shumë metodologjive, për shkak të rolit dhe rëndësisë që kanë ato në procesin e mësimitdhënies. Ndërsa, (25.5%) janë të mendimit se është më mirë që të bëhet një kombinim i mësimitdhënies tradicionale, me mësimitdhënien moderne – bashkëkohore.

Mësimdhënësit, e pranojnë faktin se duhen aplikuar më shumë metodologji nga mësimdhënia praktike dhe e përvojës, në mënyrë që aspekti teorik i mësimit, të lidhet sa më shumë që të jetë e mundur me, aspektin praktikë.

Më konkretisht ata u pyetën se si e vlerësojnë aplikimin e metodologjive në procesin e mësimdhënies. Përgjigjet pasqyrohen si më poshtë:




Figura 18. Të dhëna mbi shkallën e aplikimit të metodologjive nga mësimdhënësit.

Më tutje, pyetjet vazhdojnë më specifikisht mbi metodologjitë e mësimdhënies.

Arsimtarët u pyetën më konkretisht:

“ A përdoren mjaft metodologji në mësimdhënien e lëndës së juhës shqipe, krahasuar me lëndët e tjera ? “

Në këtë pyetje, (80.7%) e mësimdhënësve, besojnë se aplikohen metodologji të mjaftueshme, mirëpo , ata pajtohen që duhet të gjenden vazhdimisht metodologji të reja për t’u aplikuar në proces. Shumica e mësimdhënësve, mendojnë se lënda e Gjuhës shqipe nuk zgjon interesim të duhur te nxënësit, jo për shkak të mungesës së metodologjive, por për shkak të faktorëve të tjerë. Një pjesë tjetër, (19.3%) besojnë se aplikimi i më shumë metodologjive është i rëndësishëm për shkak të rolit dhe të rëndësisë që ka lënda e Gjuhës shqipe.

Në Figurën më poshtë pasqyrohen përgjigjet e pyetjes së mësipërme: “A përdoren mjaftueshëm metodologji në mësimdhënien e lëndës së gjuhës shqipe, krahasuar me lëndët e tjera ? “




Figura 19. Përdorimi i metodologjive të mësimdhënies në krahasim me lëndët e tjera

Mësimdhënësit u pyetën gjithashtu:

Sa janë motivuese, cilësore dhe në përputhje me kriteret e mësimdhënies bashkëkohore, metodologjitë e mësimdhënies që përdoren në lëndën e Gjuhës shqipe ?

Nga numri i të anketuarve të mësimdhënësve, (90%) e tyre, konstatojnë se metodologjitë janë në përputhje me planprogramin e kësaj lënde. Kurse, (10%) e tyre, mendojnë se metodologjitë, nuk e plotësojnë “diferencën” që shkaktohet nga mos interesimi i duhur i nxënësve për këtë lëndë. Mësimdhënësit që me gjasë kanë më shumë përvojë mësimore, (17 %) e tyre, besojnë se pavarësisht se metodologjitë janë në përputhje me lëndën, mungon motivimi dhe shtytja për ta konsideruar nga të gjithë faktorët shkollorë dhe më gjerë lëndën e gjuhës, si të rëndësishme në procesin e edukimit dhe arismimit. Këta mësimdhënës, shtyten nga rrethanat e kaluara ose nga koha kur kjo lëndë, ka pasur prioritet.

Në përgjithësi, metodologjitë konsiderohen si startegjike në relacion me synimet për rezultate pozitive.

Sa janë motivuese dhe cilësore metodologjitë?




Figura 20. Përgjigjet e mësimeve mbi pyetjen: “ Sa janë motivuese metodologjitë e mësimit?”

Bazuar në atë çfarëu paraqit më lart, themi që hipoteza e dytë e studimit tonë u vërtetua. Mësuesit përdorin vazhdimisht të implementojnë metodologji të reja, por ndoshta për shkak të ndryshme, ata punojnë më së shumti me metodologji të vjetra.

Duke qenë se po folëm për motivimin, një nga metodologjitë bashkëhore, mund të themi me bindje se një nga mënyrat e motivimit të nxënësit është vlerësimi. Kur nxënësi i jepet një vlerësim pozitiv apo një çmim simbolik ai motivohet më shumë për të punuar.

Prandaj u pa e nevojshme që si mësuesit ashtu dhe nxënësit të pyeteshi mbi format e vlerësimit që përdoren në lëndën e Gjuhës shqipe. Këto të dhëna sigurisht vërtetojnë atë çfarë u tha më sipër.

Në këtë mënyrë ata u pyetën mbi frekuencën e përdorimit të këtyre metodave vlerësuese:

Testimi:

- *Test me përgjigje alternative*
- *Test me përgjigje të shkurtëra dhe me plotësim*
- *Test me përgjigje të zgjeruar*
- *Puna me shkrim (esetë)*

Vrojtimi me anë të:

- *Katalogut të pjesëmarrjes së nxënësit në grup*
- *Listës së kontrollit*
- *Shkallës vlerësuese*
- *Dosjes së nxënësit*

Ndërsa si përgjigje ofrohen alternativat:

Gjithmonë Zakonisht Ndonjëherë Asnjëherë Nuk e di

Të dhënat jepen në figurën më poshtë:




Figura 21. Të dhëna nga mësuesit mbi format e vlerësimit

Referuar figurave të mësipërme vihet re se mësuesit përdorin mjaftueshëm forma vlerësimi. Ndër format më të përdorura të testimit rezultojnë testimi me përgjigje të shkurta. Ndërsa ndër format më pak të përdorura rezultoi ajo me përgjigje të zgjeruara.

Për sa i përket formave të vrojtimit, ndër format më të përdorura rezultoi lista e kontrollit dhe katalogu i pjesëmarrjes.

-Në të njëjtën mënyrë u pyetën edhe nxënësit. Rezultatet të cilëve treguan ngjashmëri të theksuar me mësuesit, çka tregon një konstatim real të situatës.




Figura 22. Të dhëna nga nxënësit mbi format e vlerësimit

Siç jepet në dy figurat, rezultatet kanë shumë ngjashmëri. Duhet të theksojmë që figura majtas i referohet rezultateve të nxënësve mbi forma e testimit, ndërsa figura djathtas i referohet rezultateve të nxënësve mbi format e vrojtimit.

Kështu, fillimisht interpretojmë rezultatet mbi format e testimit. Pjesën më të madhe të përgjigjeve e zë puna me shkrim, e cila paraqitet me ngjyrën vjollcë në grafik. Pasuese e saj është ngjyra blu që përfaqëson testet me pyetjet me alternativa.

Edhe të dhënat mbi format e vrojtimit na japin pothuajse të njëjtat rezultate. Sërisht po t'ju referohemi më së shumti përgjigjeve *zakonisht* dhe *gjithmonë*, ajo që bie më shumë në sy është shiriti ngjyrë

-Studimi vazhdon me pyetje specifike mbi metodologjitë efikase të mësimdhënies. Një ndër metodologjitë efikase është mësimdhënia me në qendër nxënësin. Duhet të theksohet se kjo është një nga shtyllat e metodologjive moderne. Kështu mësimdhënësit u pyetën se kush duhet të jetë në qendër: mësuesi apo nxënësi? A kërkohet që mësuesit të jenë më tolerant, apo më rigoroz përgjatë mbarëvajtjes së procesit mësimor?

Mësimdhënësit, në këtë pyetje përgjigjen kështu: (69 %) gjashtëmbëdhjetë mësimdhënës u përgjigjen në favor të asaj që nxënësi, duhet të jetë në qendër, kurse (31%) shtatë prej tyre u përgjigjen se mësuesi, duhet të jetë në qendër të klasës. Ndoshta ky gjykim, e konstaton edhe këtë dallim: (30 %) e mësimdhënësve, konsiderojnë se toleranca e tepruar në shkollë me nxënësit, ndikon negativisht dhe ata janë për masa më rigorozë disiplinore, kurse (70 %) shprehen në favor të tolerancës dhe demokratizimit të shkollës.

Gjykimi ynë është se, mësimdhënësit në këtë pyetje aprovojnë në favor të tyre idenë tradicionale që mësuesi të jetë në qendër. Diferenca në përgjigje të këtyre në favor të rigorozitetit, pra aplikim më pak i tolerancës, gjykojmë që shkaktohet nga mungesa e vërejtshme e disiplinës që shfaqet në shkollë. Nxënësit, janë të prirur më shumë që të flasin gjatë orës së mësim, të jenë më pak të koncentruar etj.

Cili duhet të jetë në qendër: mësuesi apo nxënësi?




Figura 23. Përgjigjet e mësimdhënësve mbi pyetjen: Kush duhet të jetë në qendër, mësuesi apo nxënësi ?“

Në lidhje me metodologjinë e vlerësimit, mësimdhënësit u pyetën në këtë mënyrë:

” A është në përputhje me procesin bashkëkohor të zhvillimit shkalla e vlerësimit të nxënësit ? “

Lidhur me këtë metodë, (73 %) e mësimdhënësve preferojnë formën e notimit sipas sistemit të përcjelljes së vazhdueshme të nxënësit gjatë vijueshmërisë së mësim. Notimi, bëhet në etapa në një fletore të posaqme, dhe jo si në të kaluarën në ditar. Nxënësi, notohet 3 herë përgjatë një gjysme të vitit. Mënyra e përcjelljes së aktivitetit të vazhdueshëm të nxënësit dhe

në këtë mënyrë vlerësimi i tij, në secilën shkollë e ka tejkaluar vlerësimin tradicional. Ky sistem i vlerësimit, konsiderohet si bashkëkohor. Ndërsa , vetëm (27 %) e mësimdhënësve, mendojnë që forma e vlerësimit aktual, nuk është deri në fund dëshmuese për sukses të sigurtë të nxënësit.




Figura 24. Të dhëna nga mësimdhënësi mbi pyetjen: "A është në përputhje me procesin bashkëkohor të zhvillimit shkalla e vlerësimit të nxënësit?"

Të gjitha këto të dhëna tregojnë një përparim të dukshëm në metodologjinë bashkëkohore të mësimdhënies së lëndës së Gjuhës Shqipe, por mbetet akoma punë për t'u bërë drejt rrugës së avancimit apo modernizimit të mësimdhënies bashkëkohore.

4.6. Të dhëna në funksion të hipotezës së tretë të studimit

Hipoteza e tretë e studimit është : Lënda e gjuhës, për vetë specifikën që ka në kurrikulën e arsimit parauniversitar, kërkon aplikimin e metodave bashkëkohore nga mësimdhënësit.

Mbi të gjitha, është me rëndësi të evidentojmë metodologjitë që përdoren në procesin e mësimdhënies së lëndës së Gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët në Kosovë.

Për këtë, mësimdhënësit janë pyetur në mënyrë indirekte në këtë mënyrë: Pohoni ose mohoni, shprehjet e mëposhtme me një nga këto shprehje:

X. Po X. Jo X.Ndonjëherë X.Asnjëherë X.Nuk e di X.Rrallë

Gjatë orës së mësimt në përdor këto metoda :




Figura 13. Të dhëna nga mësimdhënës mbi nivelin e përdorimit të disa prej metodologjive adekuatë në orën e mësimt.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, paraqitur në figurën 7, vihet re se përdorimi i metodologjive nuk është në nivel të kënaqshëm. Kështu, në lidhje me përdorimin e metodës së Brainstormingu-t, kllasterit apo parashikimit, metoda këto që përdoren në fillim të orës së

mësimit, vetem (35 %) e mësimdhënësve u shprehën me pohimin PO, ndërsa (25%) e tyre u shprehën ndonjëherë dhe (10 %) JO. Pjesa e tjetër e përgjigjeve u nda mes Rrallë dhe Nuk e di.

Për sa i përket metodave që përdoren gjatë orës së mësimit, të paraqitura në grafikun e dytë, të tilla si: Inserti, Dua të di, leximi i orientuar etj. Një shifër akoma më e vogël e mësimdhënësve (25 %) zgjodhën përgjigjen PO, (30%) e tyre u shprehën JO, (25 %) u shprehën Rrallë, e kështu me radhë.

Metodologji tjera të rëndësishme janë ato metodologji që përdoren në fund të orës së mësimit, thënë ndryshe në etapën e reflektimit. Këto metodologji janë paraqitur në kolonën e tretë dhe konsistojnë në këto metoda: shkrimi i lirë, puna në dyshe, rrjeti i diskutimeve, shqyrtimi kategorizues etj. Siç shfaqen edhe në grafik, pjesa më e madhe e mësimdhënësve (30 %) u shprehën JO, (20 %) e tyre u shprehën RRALLË, pothuajse e njëjta shifër (25 %) u shprehën NDONJËHERË.

Një metodë tjetër e rëndësishme është metoda e kur nxënësit kanë mundësi të marrin vendime. Në lidhje me këto metodologji përgjigjet e mësimdhënësit tregojnë se është ndër praktikatat më pak të përdorura, kjo pasi vetëm (20 %) e tyre u shprehën PO, dhe është më rëndësi të themi se një shifër relativisht e lartë (40 %) u shprehën JO. Pjesa e tjetër e përgjigjeve ndahet mes përgjigjeve NDONJËHERË, RRALLË, NUK E DI.

Mardhënia ndërvepruese mësues-nxënës, apo nxënës – nxënës, është një tjetër metodë e rëndësishme, që për hirë të së vërtetës rezulton të jetë relativisht mirë nga mësimdhënësit.

Kështu (40 %) e mësimdhënësve u shprehën PO, një shifër kjo relativisht e lartë duke marrë dhe parasysh (20 %) që dhanë përgjigjen JO. Ndërsa (25 %) dhanë përgjigjen RRALLË, dhe (15%) NUK E DI.

Mendo, puno në dyshe, thuaja grupit... është metoda tjetër për përdorimin e të cilës u pyetën mësimdhënësit. Në këtë mënyrë ata dhanë këto përgjigje: pjesa më e madhe (30%) dhanë përgjigjen JO, (30 %) dhanë përgjigjen NDONJËHERË, (25 %) RRALLË). Pjesa tjetër u nda mes përgjigjeve të tjera.

Metoda e pesëvargësh-it është një tjetër metodë që luhet në pothuajse të njëjtin nivel si metoda e mësipërme. Një shifër e njëjtë mësimdhënësish (20 %) dhanë përgjigjen PO dhe JO.

Ndërsa *shkrimi i lirë* është një metodë e përdorur mjaft nga mësimdhënësit. Në këtë mënyrë (35 %) e tyre dhanë përgjigjen PO, (20%) e tyre dhanë përgjigjen NDONJËHERË.

Konstatimi i situatës në lidhje me nivelin e përdorimit të këtyre metodologjive do të ishte i pamundur pa matur edhe këndvështrimin e nxënësve.

Kështu, nxënësit u pyetën ë të njëjtën mënyrë si edhe mësimdhënësit. Më konkretisht atyre iu parashtrua kjo pyetje:

Sa i njihni metodat e mëposhtme në lëndën e Gjuhës shqipe në shkollën tuaj?

- Brainstormingu, kllasteri, parashikimi me terma paraprake, tryeza rrethore etj.
- Inserti, di/dua të di/ të mësoj, leximi i orientuar, mësimdhënia reciproke, të nxënit në bashkëpunim etj.
- Puna në dyshe, rrjeti i diskutimeve, shqyrtimi kategorizues etj.
- Dhënia e mundësisë nxënësve për të marrë vendime
- Marrëdhënia ndërvepruese
- Pesëvargëshi
- Shkrimi i lirë/ese

Të dhënat në mënyrë më të detajuar në përqindje për secilën nga metodologjitë e mësipërme jepen në figurën në faqen vijuese.




Figura 14. Të dhëna nga nxënësit mbi nivelin e përdorimit të disa prej metodologjive adekuate në orën e mësimet.

Në lidhje me metodën e parë, mbi metodat që përdoren në fillim të orës së mësimit, si Brainstormingu apo Klasteri, nxënësit dhanë këto rezultate. (25%) dhanë përgjigjen PO, dhe NDONJËHERË. Ndërsa përqindjet e tjera ndahen mes alternativave të tjera.

Ndërsa në lidhje me metodat e përdorura gjatë procesit mësues, si Inserti apo leximi i orientuar, të dhënat nga nxënësit tregojnë rezultate edhe më të ulëta. Vetëm (15 %) e tyre e pohun këtë gjë me përgjigjen PO. Pjesa më e madhe (30%) u përgjigjën RRALLË DHE (20%) dhanë përgjigjen JO. Në këtë mënyrë themi që kjo metodë përdoret jo mjaftueshëm.

Një tjetër fazë e rëndësishme në procesin mësues është ajo e fundit, faza përmbyllëse. Të dhënat nga nxënësit treguan se metodat në këtë fazë të tilla si: Puna në dyshe, rrjeti i diskutimeve, shqyrtimi kategorizues etj. përdoren jo mjaftueshëm. Kështu (25 %) e tyre deklaruan PO, e ndërsa (30 %) deklaruan JO. Ndërkohë që (20 %) deklaruan NUK E DI.

Ndër praktikatat më të suksesshme si ajo e mundësisë së nxënësit për të marrë vendime vetë, rezultoi të jetë më pak e përdorura. Vetëm (10 %) e nxënësve deklaruan PO, dhe një shifer relativisht e lartë (40 %) deklaruan JO. Shifra këto të konsiderueshme për të arritur në përfundimin se kjo është një ndër praktikatat më pak të përdorura.

Mardhënia ndërvepruese është një metodë që rezultoi të ketë këtë nivel përdorim: (20%) u shprehën PO, (30%) e tyre u shprehën JO dhe (25 %) e tyre u shprehën RRALLË. Pjesa tjetër u nda mes përgjigjeve NDONJËHERË dhe NUK E DI.

Puna në grupe apo në dyshe, një metodë kjo bashkëhore e aq shumë folur në rrethet shkencore është një ndër metodat më pak të përdorura ku vetëm një shifër gati e pa përfillshme e nxënësve (10 %) u shprehën PO, dhe ajo çfarë është më e rëndësishme është shifra më e lartë (40 %) e tyre që u shprehën JO. Kjo tregon që kjo metodë është pothuajse e pa njohur për nxënësit.

Metoda e Pesëvargëshit, ndonëse me shifra më të larta në përgjigjet PO (20%) dhe (30%) NDONJËHERË, mbetet në ritme jo të kënaqshme.

Një ndër metodat më të përdorura, referuar rezultateve të nxënësve, rezultoi metoda e shkrimit të lirë dhe esesë. Për këtë metodë (40%) e nxënësve dhanë përgjigjen PO, (20 %)

dhanë përgjigen JO, ndërsa përqindja e mbetur u ndanë në mënyrë të barabartë mes opsioneve të tjera.

Bazuar në të dhënat e të dy palëve, konkludojmë që niveli i përdorimit të metodologjive adekuate në orën e mësimit nuk është në ritme të kënaqshme

Përdorimi i mjeteve mësimore

Mjetet mësimore përbëjnë shtyllën apo bazën për aplikimin e metodologjive. Pasur parasysh këtë rol, u pa me rëndësi studimi i tyre. Në këtë mënyrë mësimit dhe nxënësit u pyetën për frekuencën e përdorimit të tyre në orën e mësimit të Gjuhës shqipe në shkollat e komunës së Gjakovës.

Fillimisht pasqyrojmë të dhënat e përfituara nga mësimit, të cilat pasqyrohen në figurën më poshtë. Atyre iu drejtua pyetja “ Sa shpesh i përdorni këto mjete mësimore (të cilat jepn në një listë), duke qarkuar përgjigjet:

X. Po X. Jo X.Ndonjëherë X.Asnjëherë X.Nuk e di X.Rrallë

Kështu në lidhje me *mjetet dydimensionale*, kemi këto të dhëna : (25%) e tyre dhanë përgjigjen PO, dhe po e njëjta shifër dhanë përgjigjen NDONJËHERË. Në shifra të barabarta qëndrojnë përgjigjet e tjera, RRALLË, NDONJËHERË dhe (10%) përgjigja NUK E DI.

Në lidhje me përdorimin e mjeteve tridimensionale përgjigjet janë në nivele më të ulëta. (15%) e tyre u shprehën PO, (20%) u shprehën JO. Ndërsa pjesa më e madhe (35%) e mësimit u shprehën RRALLË. Kjo tregon se këto mjete përdoren shumë pak, pothuajse asnjëherë.

Mjetet audiovizive kanë një nivel përdorimi më të lartë. Pjesa më e madhe e mësimit (35 %) shprehen PO, dhe (15 %) e tyre shprehen ndonjëherë. Edhe pse këto shifra janë pak poshtë mesatares, në krahasim me mjetet e tjera ka një nivel më të lartë përdorimi. Pjesa tjetër e përqindjes ndahet mes përgjigjeve negative.

Mjetet e komunikimit masiv, të dhënat rezultuan kështu: (30 %) u shprehën PO, (20%) u shprehën NDONJËHERË. Ndërsa pjesa tjetër ishin tek përgjigjet negative, përgjigja jo (10%), RRALLË (20 %) dhe përgjigja NUK E DI (20 %).

Mësimdhënësit, gjithashtu, u pyetën mbi mjetet ndihmëse-teknike mësimore dhe orenditë shkollore, mjete këto bazë për zhvillimin e një procesi normal mësimor, që fatmirësisht është në nivel të kënaqshëm.

(50%) e mësimdhënëve deklaruan PO, që këto mjete ofrohen në shkollën e tyre. (20%) u shprehën JO, (25 %) NUK E DI dhe (15 %) RRALLË.

Të dhënat në mënyrë të detajuar jepen në figurën më poshtë.




Figura 15. Të dhëna nga mësimdhënësit mbi përdorimin e mjeteve mësimore

Për të marrë një këndvështrim sa më të saktë të situatës, edhe në këtë rast u pyetën nxënësit po ashtu si mësimdhënësit.

Të dhënat nga nxënësit pasqyrohen në figurën 9.




Figura 16. Të dhëna nga nxënësit mbi përdorimin e mjeteve mësimore

Referuar figurës së mësipërme mjetet dydimensionale kanë shumë pak përdorim në shkollat e komunës së Gjakovës. (15%) e nxënësve u shprehën PO. (20%) u shprehën JO, (20%) u shprehën RRALË dhe po e njëjta shifër u shpreh NUK E DI. Ndërsa pjesa më e madhe e tyre (35%) e tyre u shprehën NDONJËHERË.

Një situatë akoma më e keqe është edhe për mjetet tridimensionale. Vetëm (5%) e nxënësve zgjedhën alternativën PO. Ndërsa pjesa më e madhe e tyre (35%) zgjedhën përgjigjen

NDONJËHERË. Pothuajse e njëjta shifër (30 %) dhanë përgjigjen JO. Pjesa tjetër ishin mes përgjigjes RRALLË dhe NUK E DI.

Mjetet audiovizive janë një lloj tjetër mjetesh që kanë një rol të rëndësishëm në procesin mësimor. Në lidhje me këtë të dhënat nga nxënësit rezultuan kështu: (15 %) e tyre u shprehën PO, (30 %) u shprehën JO, (35%) u shprehën RRALLË, (20 %) NDONJËHERË dhe (10 %) zgjodhën përgjigjen NUK E DI.

Në lidhje me mjetet e komunikimit masiv, situatë është më pozitive. Nxënësit janë të ndarë mes përgjigjes PO (30%) dhe JO (30%). Një pjesë e konsiderueshme e nxënësve (20%) dhanë përgjigjen NDONJËHERË dhe vetëm (10%) dhanë përgjigjen NUK E DI.

Për sa i përket mjeteve bazë të mësimdhënies (Mjetet ndihmëse-teknike mësimore dhe orenditë shkollore), të dhënat e nxënësve, po ashtu si edhe të mësuesve, tregojnë një situatë të kënaqshme. (40 %) e tyre shprehen PO dhe një shifër e konsiderueshme (30%) u shprehën NDONJËHERË. Pjesa tjetër e nxënësve zgjodhën përgjigjet JO (20 %) dhe RRALLË (10 %).

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i metodologjive bashkëhore është puna në grupe.

Në lidhje me këtë metodologji mësimdhënësit dhanë këto përgjigje:




Figura 17. Të dhëna nga mësimdhënësit dhe nxënësit mbi përdorimin e punës me grupe dhe punës praktike gjatë procesit mësimor

Në figurën e mësipërme janë pasqyruar vetëm përgjigjet PO. Duhet të theksojmë që si alternativa ishin opsionale edhe përgjigjet: *JO, RRALLË, NDONJËHERË, NUK E DI*.

Në këtë mënyrë, në lidhje me punën në grup, është e rëndësishme të përmendim faktin se pjesa më e madhe e mësimdhënësve (80 %) deklaruan *PO*, ndërsa numri i nxënësve që dha këtë përgjigje ishte në shifra më të vogla (60 %).

Dallim më të theksuar mes mësimdhënësve dhe nxënësve ka në lidhje me punën praktike. Kështu (70 %) e mësimdhënësve deklaruan *PO*, dhe vetëm (30%) e nxënësve deklaruan këtë përgjigje.

Në figurë përgjigjet e mësimdhënësve pasqyrohen me ngjyrën blu, ndërsa të nxënësve pasqyrohen me ngjyrën e kuqe.

Këto të dhëna vërtetojnë më tej atë çfarë u konstatua më sipër.

4.7. Të dhënat nga intervistat e zhvilluara me drejtues shkollash në komunën e Gjakovës

Krahas pyetësorëve, në këtë studim u përdorën edhe intervista si një përpjekje për nxjerrjen e rezultateve sa më të sakta në funksion të vërtetimit të hipotezave tona.

Në këtë mënyrë, përveç mësimdhënësve dhe nxënësve, si mostër u morën dhe drejtuesit e disa shkollave të arsimit të mesëm të ulët.

Aplikimin e intervistave me përfaqësues të organeve drejtuese të shkollave, e kemi bërë me qëllim të identifikimit të disa mendimeve dhe përgjegjësive të tyre. Jemi orientuar të pyesim rreth kushteve në shkollë, rreth faktorëve që ata i konsiderojnë si pengues lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimorë. Në thellim më të detajuar, na kanë interesuar që t'i shtrojmë edhe pyetjet, sidomos që kanë të bëjnë me metodologjitë që aplikohen dhe me sjelljet e nxënësve gjatë procesit mësimorë.

1. Si i vlerësoni kushtet dhe sistemin e sotshëm shkollor?

Drejtori 1: Në rrethanat e sotshme, është e dukshme situata. Punojmë në shkolla të reja, moderne, dhe infrastruktura është solide. Nuk mund të ankojemi sa i përket edhe hapësirës, kushteve apo ambientit mësimorë që i përket një klase. Ne, respektojmë ndryshimet e reja, planprogramet e avancuara, reformat, kurrikulat dhe karakteristikat e tjera që i kërkon shkolla me standardet bashkëkohore. Nuk është se nuk kemi edhe faktorë pengues, për shembull, devijimet apo dukuritë negative që mund të shfaqen te ndonjë nxënës. Kur e përmenda hapësirën, duhet përmendur se popullimi i madh i qyteteve, ndikon në rritjen e paparashikuar të numrit të nxënësve. Kemi klasë që tejkalojnë numrin e paraparë, që zakonisht sillet në 30 – 32 nxënës. Ky numër, nganjëherë tejkalohet.

Drejtori 2 : Sistemi i arsimit, është vazhdimisht në zhvillim. Si vend i dalë nga lufta, jemi ballafaquar me mungesë të përvojës së duhur moderne që, si rrjedhojë e ndryshimeve të mëdha shoqërore e politike, na është dashur shumë përpjekje. Më shumë se një dekadë, Kosova është ballafaquar me ndërtim të objekteve të reja shkollore. Pastaj, me reforma në arsim. Me ndryshime të planprogrameve, të literaturës shkollore, po edhe të metodologjive të mësimdhënies. Ka shkolla fillore dhe të mesme, me më shumë se një mijë nxënës. Kam vërejtje se personeli drejtues, nuk mund ta përballojë situatën. Duhet të rritet numri i pedagogëve në shkollë, i psikologëve, i inspektorëve që mbikëqyrin direkt mbarëvajtjen e procesit mësimorë, zbatimin e duhur të planprogrameve, sidomos të metodologjive!

Drejtori 3: Gjendja, po të shihet si e përgjithësuar, duket e shkëlqyeshme! Por, xënësit në sistemin parauniversitar, ndikohen nga dukuri dhe fenomene të ndryshme. Ata, dinë të mos jenë të disiplinuar, dinë të jenë të zhurmshëm. Madje, deri në humbje të kontrollit dhe vëmendjes në mësim. Ambienti i jashtëm, sidomos mosha e tyre, paraqet vështirësi të caktuara. E numri i psikologëve në shkollat tona, është i vogël, dukshëm i vogël...

Drejtori 4.

Sot sistemi shkollor ka ndryshuar pothuajse rrënjësisht në krahasim me të kaluarë. Vëmendja është orientuar drejt nxënësit. Po tentojmë të aplikojmë mësimdhënien me në qendër nxënësit, ku nxënësit vepron në pothuajse 80 % të orës së mësimi.

Drejtori 5

Sot po hasemi çdo ditë e më shumë me risi në sistemin arsimo, qoftë në strukturë ashtu edhe në metodologji. Ndonjëherë mendoj që këto risi po shkaktojnë më shumë dëm se sa efikasitet. Megjithatë, ne si mësimdhënës duhet të punojmë shumë për ta bërë sa më të lehtë këtë tranzicion që nxënësit të kenë me lehtë mesimnxënien.

2. Si e vlerësoni mësimdhënien në lëndën e gjuhës shqipe??

Drejtori 1: Ndryshimet janë të mëdha në mësimdhënie, krahasuar me të kaluarën. Teoria dhe praktika, kanë pësuar ndryshime. Metodologjitë e mësimdhënies, kushtëzohen nga profili i shkollës, nga lënda, po edhe nga profesori i lëndës! Kemi mësimdhënës me përvojë, të kualifikuar në masën e duhur. Sigurisht, metodologjitë e mësimdhënies në lëndën e kimisë, të biologjisë, të muzikës etj., ndryshojnë nga metodologjia e mësimdhënies në lëndën e gjuhës shqipe. Por në këtë lëndë aplikohet më shumë teoria e mësimi, literatura dhe kuptohet, më pak puna praktike për shkak të natyrës së lëndës. Ajo që për mendimin tim është me rëndësi, duhet të përfillet korniza themelore e mësimdhënies: aplikimi i metodologjive që ndikojnë në rritjen e interesimit të nxënësit për këtë lëndë.

Drejtori 2: Mendoj që jemi ende në fazën e standardizimeve. Kemi ndryshime nga e kaluara, dhe sistemi edukativ shqiptar ka ende shumë punë për të bërë! Metodologjitë e mësimdhënies nuk mungojnë, por varet shumë edhe nga kujdesi i mësuesve, nga mënyra se si i aplikojnë ata metodologjitë, nga trajtimet që kërkohen t'i bëhen një lëndë! Kjo ka të bëjë edhe me lëndën e gjuhës shqipe. Për shembull, në mësimdhënien e lëndës së gjuhës shqipe nuk mendoj që mungojnë metodologjitë por, ndoshta mungon qasja e mësuesve dhe e nxënësve për ta konsideruar lëndën me prioritet të duhur, me respekt të duhur etj.

Drejtori 3: Vështirësitë e ndryshme, problemet që lidhen me të mësuarit permanent të nxënësit, interaktiviteti në klasë, mësimi në grup, puna praktike etj., e kanë zgjëruar sistemin e aplikimit të më shumë metodologjive në procesin e mësimdhënies. Edhe rezultatet, janë

evidente. Kur e përmenda fjalën “vështirësi”, e lidha me faktet që po shfaqen mbasi që nxënësit po e mbarojnë mësimin parauniversitar, pra shkollimin e mesëm. E ato, nuk janë impresionuese. Ta kujtojmë hulumtimin e bërë nga PISA! Po, edhe faktet që lidhen me lëndën e gjuhës shqipe. Qindra nxënës pas mbarimit të shkollës së mesme, kanë problem me shkrimin.

Drejtori 4

Në shkollën tone, kemi mësues të përgatitur në lëndën e Gjuhës shqipe. Ata janë gjithmonë të gatshëm për të përqafuar metodologjitë e reja. Por, natyrisht, kushtet e e punës e bëjnë ndonjëherë të pamundur që këto metodologji të aplikohen nëmasën e duhur.

Drejtori 5

Unë mendoj që kjo është pyetje për mësimdhënësit e lëndës së Gjuhës shqipe, por edhe për ekspertët e kësaj lënde, për faktorët e tjerë më përgjegjës të arsimit.

3.Sipas jush, çfarë metodologjish përdoren në procesin e mësimdhënies të lëndës së Gjuhës shqipe në shkollën tuaj?

Drejtuesi 1 Ne bazohemi në planprogramin mësimorë. Nuk kemi vështirësi në realizimin e programit mësimorë, sepse sot përdorim mjaft metodologji. Në fillim të vitit shkollor, një orë u flasim nxënësve për lëndën, rëndësinë e saj, sistemin e shpjegimit, të vlerësimit, pastaj ju flasim lidhur me lieteraturën, dhe mundësitë praktike që mund t’i zhvillojmë gjatë vitit. Unë, besoj që mësimdhënësit arrijnë t’i aplikoj të gjitha metodologjitë e nevojshme për këtë lëndë, në masën 90%.

Drejtori 2: Sipas planprogramit, ne zhvillojmë dy orë të mësimit të gjuhës gjatë javës mësimore. Mendoj që janë të mjaftueshme. Mësimdhënësit e zbatojnë me përpikmëri planprogramin e kësaj lënde. Por lënda e Gjuhës shqipe ka pak hapësirë për diskutime në grup, dhe dimensionin e praktikimit të kësaj lënde, është më i vështirë se plotë lëndë të tjera. Mirëpo, vë re se mësimdhënësit i kushtojnë mjaft rëndësi përsëritjes, marrjes së shembujve

adekuat, detyrave të shtëpisë etj. Jam i bindur se, mësimdhënësit shfrytëzojnë në masën 85% të attributeve që dalin nga aplikimi i metodologjive nga kjo lëndë.

Drejtori 3

Në shkollën tonë, jemi të përkushtuar që t'u përgjigjemi kërkesave të kohës. Sot, procesi mësimor është i avancuar, modernë. Përpiqemi që nxënësve t'ua bëjë sa më të qartë temën që shpjegojmë. Lënda e Gjuhës shqipe, është interesante: gramatika, morfologjia, sintaksa. Ngjajnë, sikur me një lëndë shkencore natyrore. Mësimdhënësit përpiqen që lëndën ta bëjnë sa më tërheqëse, duke i kushtuar rëndësi të madhe aktivitetit motivues, shpjegimor, përsëritjes etj. Ata janë të gatshëm gjithmonë për lëndën dhe në shërbim të nxënësit, dhe kryesisht i zbatojnë metodologjitë, por sigurisht mbetet shumë për t'u bërë në arritjen e një procesi mësimor sa më efikas.

Drejtori 4

Besoj që mësimdhënësit përdorin deri diku metodologjitë përkatëse. Si një lëndë teorike, Gjuha mbështetet në shembuj konkret. Gjatë vëzhgimeve të mia në orët mësimore, kam vënë re që mësimdhënësit perferojnë që t'i përdorë ushtrimet në klasë në fund të orës (10 minutat e fundit të orës), dhe detyrat e shtëpisë në mënyrë që ta kenë më të qartë pasqyrën e angazhimit të nxënësve.

Drejtori 5

E kam vështirë t'i përgjigjem kësaj pyetje. Megjithatë, duhet më shumë mobilizim i faktorëve shkollorë, i mësuesve, po edhe i prindërve. Të gjithë duhet ta kuptojmë rëndësinë e kësaj lënde dhe mësuesit duhet te japin maksimumin e tyre në aplikimin e metodologjive adekuate në orën e mësimi.

4.Sipas jush, cili është niveli i përdorimit të metodologjive adekuate të mësimi të Gjuhës shqipe ?

Drejtori 1.

Besoj që përdorim metodologji të bollshme, të mjaftueshme.

Drejtori 2

Besoj që ne aplikojmë metodologji të ndryshme që mësimdhënia të zhvillohet në mënyrë të kënaqshme, por duhet akoma më shumë punë.

Drejtori 3

Gjithmonë ka mundësi për të bërë më të mirën dhe për t'u përmisuar. Besoj që duhet akoma më shumë punë drejt përmisimit të situatës.

Drejtori 4

Nivel i përdorimit të metodologjive të mësimdhënies së Gjuhës shqipe, është i mjaftueshëm.

Disa shqetësime që na shfaqen, sidomos gjendja rreth gjuhës (mungesa e madhe e të folurit dhe të shkruarit standard), do të na duhej të na bënte të mendonin për shtimin e më shumë metodologjive në këtë lëndë.

Drejtori 5

Besoj nuk është në nivelin e duhur. Duhet akoma më shumë punë.

5. Pse ka rënie të interesimit të nxënësve për lëndën e gjuhës shqipe ?

Drejtori 1

Nuk mendoj që ka rënie të interesimit nga nxënësit për këtë lëndë. Unë mendoj që nxënësit, duhet shpjeguar shumë më shumë se zakonisht për ndonjë lëndë tjetër, rëndësinë e lëndës. Sepse, meqë e përdorim gjuhën shqipe si gjuhë kombëtare, ajo do të na duhet gjatë gjithë jetës.

Drejtori 2

Po, keni të drejtë. Por, ka shumë faktorë që e kanë zbehur interesimin e nxënësve për këtë lëndë. Jo se nxënësit nuk janë të përkushtuar, por ata nuk përpiqen të mbajnë asgjë mend nga kjo lëndë. Sapo notohen, nuk merren më asnjëherë më këtë lëndë!

Drejtori 3

Faktorët kryesorë që ndikon negativisht ndaj gjendjes që ekziston, sidomos në Kosovë dhe në viset e tjera (jo në Shqipëri), është të folurit dhe të shkruarit në mënyrë jo standarde. Ne, gjuhën standarde e përdorim vetëm në shkollë. Askund tjetër. Por, gjuha u nënshtrohet ndikimeve globale të “gjuhës” së internetit, asaj ekonomike, kulturore, sportive etj.

Gjuha, duhet të mbrohet me ligj. Unë besoj se, përdorim pak fjalë të gjuhës që flasim (300-400 fjalë), por edhe në këtë volum fjalësh që përdorim, jam i bindur se kemi një ndikim prej 15-20 % të fjalëve të huja. Duke jetuar në këso gjendje, është logjike të presim që interesimi i nxënësve për lëndën e gjuhës shqipe të jetë në rënie, kurse për motivim të tyre ndaj kësaj lënde, sot vështirë e kemi të diskutojmë.

Drejtori 4

Në këto rrethana të krizave të ndryshme, të gjithë e kanë frikë gjendjen materiale. Dhe, duhet ta themi hapur: me studimin e Gjuhës Shqipe në shkollimin universitar, vështirë gjendet një vend pune. Pastaj, të mos harrojmë se lënda e gjuhës shqipe, nuk është një lëndë dosido. Unë, gati e krahasoj me matematikën, pra është një lëndë goxha e vështirë për t’u mësuar dhe kërkon shumë koncentrim, ushtrime, përsëritje etj. Jo të gjithë nxënësit, kanë prirje për këtë lëndë. Por, e ndaj mendimin se është lëndë me prioritet. Dhe, duhet përkushtim më i madh, sensibilizim, rritje të interesimit, krahas lëndëve të tjera.

Drejtori 5

Ka disa faktorë që ndikojnë në humbjen e interesimit të nxënësve për mësim, në përgjithësi, por edhe për ndonjë lëndë të veçantë siç është lënda e gjuhës shqipe. Krahasimi, do të duhej bërë me faktin se, a është më i madh interesimi për lëndët e tjera se sa, për këtë lëndë! Dhe unë mendoj që ka dallime. Për shembull, shumica e nxënësve janë të prirur t’u kushtojnë më shumë rëndësi lëndëve të caktuara, sidomos atyre ekonomike dhe juridike. Kjo, lidhet me prirjet për punësim më të lehtë, për përfitim material etj.

6. Në cilat fusha shihni dobësi evidente në procesin mësimorë, dhe si do t'i tejkaloni ju këto dobësi?

Drejtori 1

Së pari, mësimdhënësit duhet t'i përgatisin përditë temat që ua shpjegojnë nxënësve. Në disa aspekte, sidomos rreth lëndëve shoqërore ku hyn edhe lënda e Gjuhës shqipe, ka rënë interesimi apo pesha e trajtimit të mësimin. Unë vlerësoj se, 60 - 70% e mësimdhënësve, **nuk i kushtojnë rëndësi përgatitjes psikologjike dhe motivimit të nxënësit ndaj lëndës.**

Drejtori 2

Nuk mund të themi se shkolla nuk ka probleme, se gjithçka shkon pa probleme. Mendoj që si dobësi e parë, është trajtimi i lëndëve. Disa lëndë trajtohen me më shumë prioritet, dhe disa jo. Nga aspekti i planprogramit dhe i procedurave të mësimin, të gjitha lëndët trajtohen njësoj. Por, është krijuar një kilmë e atillë psikologjike që, disa lëndë shoqërore nxënësit t'i duan më shumë, e disa më pak. Përshtembull, (50%) e nxënësve, mendoj që e trajtojnë shkollimin vetëm nga aspekti material. Nuk jam dakord me atë **se, nuk aplikojmë mjaftueshëm metodologji!**

Drejtori 3

Të përpigemi që nxënësit, me një fjalë të rinjtë ta përdorin më pak teknologjinë sepse, ajo është e dëmshme dhe, pengon në realizimin me sukses të mësimin. Përdorimi i pakontrolluar i mjeteve teknologjike, i rrjeteve sociale, i internetit është reflektues negativ në mësim. Janë duke u shfaqur dukuri të ndryshme negative. Nxënësit, janë të prirur gjithnjë e më shumë në përdorimin e **substancave narkotike**, dhe ky është rreziku më i madh. I kemi parë raportet e policisë që, flasin për shifra të larta të të rinjëve që përdorin drogën, dhe ata kryesisht janë të rinjë – shkollarë të mesëm.

Drejtori 4

T'i mbrojmë nxënësit nga **teknologjia**, përdorimi i telefonave në mënyrë të pakontrolluar. Ndoshtë që ndonjë nxënës, e zë gjumi në orën e mësimit! Mund të thuhet se 95% e nxënësve, meshkuj e femra, vijnë në shkollë me telefonë. Këto mjete, ndikojnë negativisht në aspekt fizik, janë pengesë e koncentrimit të nxënësit në mësim etj. Demokratizimi i shkollës, të mos kuptohet nga askush si tolerancë e domosdoshme! Nxënësit, duhet të jenë sa më të sjellshëm, të dëgjueshëm dhe të edukuar.

Jemi duke jetuar në kohëra moderne, në gjendje të ndryshimeve të mëdha globale. Besoj që jemi para sfidave të mëdha, shkolla ndodhet para këtyre sfidave. Duhet të veprojmë më shumë, t'u përkushtohemi më shumë nxënësve. Mendoj se ka ardhur koha që të kemi ndonjë lëndë lidhur me sfidat që ballafaqohen nxënësit, si pjesë e shoqërisë. Sfidat, janë shoqërore e globale. .

Drejtuesi 5.

Mendoj që nxënësit duhet të motivohen. Ne si shkollë po bëjmë maksimumin drejt kësaj por duhet më shumë punë në këtë drejtim

7.A janë në nivel të duhur kushtet mësimore, ambienti, infrastruktura ?

Drejtori 1

Po, janë në nivel në shkollën tonë. Kemi kushte relativisht të mira dhe komode.

Drejtori 2

Po. Kushtet mësimore janë shumë të mira. Ambienti dhe infrastruktura janë në kushte optimale.

Drejtori 3

Objekti ynë shkollorë, është i ndërtuar qe disa dekada. Duhet përmirësuar më shumë infrastruktura e shkollës.

Drejtori 4

Shkolla jonë është ndërtuar vitet e fundit. Është objekt i ri, modern por sigurisht mbeten gjithmonë disa aspekte për tu përmisuar.

Drejtori 5

Shkolla gëzon infrastrukturën bazë, por duhen më shumë fonde për një përfaqim teknologjik.

8.A besoni që aplikimi i më shumë metodologjive, do ta rriste përkushtimin e mësuesve, po edhe të nxënësve në relacion me këtë lëndë?

Drejtori 1

Jo, sepse gjuha fillon nga familja, mënyra se si flitet në familje, në rrethin shoqëroë, në punë etj.

Drejtori 2

Këto metodologji që përdorim, janë të mjaftueshme. Vetëm na duhet më shumë angazhim në proces të mësimdhënies.

Drejtori 3

Përdorimi i më shumë metodologjive, do ta përmirësonte gjendjen. Na duhet respektimi i standardit të gjuhës shqipe në shkolla, në familje, në media, në administratë dhe kudo tjetër.

Drejtori 4

Po, sigurisht që duhen gjithmonë më shumë metodologji.

Drejtori 5

Sigurisht që po.

Këto intervista me përfaqësues të organeve drejtuese të shkollave, u bënë me qëllim të identifikimit të disa mendimeve dhe përgjegjësive të tyre. Atyre iu drejtuan 8 (tetë) pyetje. Ata u pyetën, pikë së pari rreth rreth kushteve në shkollë, dhe për këtë shumica prej tyre e pranuan se shkollat e tyre nuk ishin në kushtet optimale të mësimdhënies. Të tjerë, edhe pse të paktë në numër, nuk e mohojnë faktin që shkollat e tyre kanë kushte të mira por sigurisht mbeten akoma disa aspekte për tu përmisuar.

Në lidhje me pyetjen e dytë : “ Si e vlerësoni mësimdhënien e lëndës së Gjuhës shqipe në shkollën tuaj? “, drejtuesit përgjithësisht shprehen pozitivë por edhe ata vetë e pranojnë se duhet më shumë punë në aplikimin e metodologjive moderne.

Ndërsa për sa i përket pyetjes së tretë: “***Sipas jush, çfarë metodologjish përdoren në procesin e mësimdhënies të lëndës së Gjuhës shqipe në shkollën tuaj?***”

Drejtuesit pranojnë që mësimdhënësit punojnë metodologji të ndryshme. Ndër metodologjitë që përdoren më së shumti rezultuan përsëritja, marrja së shembujve adekuat, detyrae e shtëpisë etj. Ndër të tjera drejtuesit shprehen se mësimdhënësit përpiqen që lëndën ta bëjnë sa më tërheqëse, duke i kushtuar rëndësi të madhe aktivitetit motivues, shpjegimor, përsëritjes etj. Ata janë të gatshëm gjithmonë për lëndën dhe në shërbim të nxënësit, dhe kryesisht i zbatojnë metodologjitë, por sigurisht mbetet shumë për t`u bërë në arritjen e një procesi mësimor sa më efikas. Vlen të theksohet se disa nga drejtuesit refuzuan të përgjigjen, me arsyetimin e kam vështirë t`i përgjigjem kësaj pyetje.

Pyetja e katërt lidhet drejt për drejt me hipotezën kryesore të stusimit tonë, mbi nivelin e aplikimit të teknologjive adekuate. Kështu bata u pyetën: “ *Sipas jush, cili është niveli i përdorimit të metodologjive adekuate të mësimin të Gjuhës shqipe?*”

Shumica e drejtuesve shprehen se përdoren metodologji por qe nuk janë mjaftueshëm për një orë ideale mësimore.

Mbi pyetjen e pestë : “*5.Pse ka rënie të interesimit të nxënësve për lëndën e gjuhës shqipe ?*”, shumica e drejtuesve shprehen :

- *Nxënësve u duhet shpjeguar rëndësia e lëndës*
- *Nuk janë të motivuar mjaftueshëm*
- *Ndikimet globale të gjuhës*
- *Faktorë ekonomiko social*
- *Mungese metodologjish motivuese*

Për sa i përket pyetjes së gjashtë: ” *Në cilat fusha shihni dobësi evidente në procesin mësimorë, dhe si do t’i tejkalonit ju këto dobësi ?*”, listojmë këto përfundime:

- nuk i kushtojnë rëndësi përgatitjes psikologjike dhe motivimit të nxënësit ndaj lëndës.
- nuk aplikojmë mjaftueshëm metodologji
- substancave narkotike
- teknologjia

Një pyetje tjetër me rëndësi është : “*A besoni që aplikimi i më shumë metodologjive, do ta nrriste përkushtimin e mësuesve, po edhe të nxënësve në relacion me këtë lëndë?*”.

Shumica e drejtuesve u shprehën me përgjigje pozitive.

Bazuar në të dhënat e detajuara më sipër, nga pyetësorët me drejtuesit e shkollave, themi që këto rezultate shërbyen plotësisht në vërtetimin e hipotezave të studimit tonë.

4.7 Përgjigje nga fokus grupi

Në vlerësimet lidhur me rëndësinë e gjuhës, kemi përzgjedhur mendime (diskutimet e shkurtëra) që nuk shkojnë në analizim të thelluar të objektivit, mirëpo janë të rëndësishme për t’i dhënë më shumë rëndësi temës. Pse kemi bërë këtë hap ?

Sikur t'i qaseshim gjerësisht temës, shumë më gjerësisht mbi hulumtime jo vetëm në shkolla por edhe në administratë, në institucione të artit dhe të kulturës, në media, do të mbeteshim të befasuar me shkallanë e ulët dhe tejet të dobët të përdorimit të gjuhës. Kemi një gjendje që, është e pazakontë. Sirtarët, arkivat, faqet e shtypit të shkruar, dokumentet, letrat, shkresat e ndryshme etj., po t'i hulumtonin, do të hasim në një trajtim të gjuhës në mënyrën më të pavëmendshme të mundshme.

Kemi një trajtim të padijshëm të gjuhës përmes shkrimit, dhe sigurisht të padinjitetshëm në përmasa. Interesimi i dobët dhe trajtimi asapak i denjë i gjuhës, mund të jetë shumë më i theksuar në publik dhe në institucionet publike se sa në shkollë. Këtë konstatim, mbase e bëjmë në formë dytësore, në kontekst dhe për ta kuptuar rëndësinë dhe përgjegjshmërinë që, gjithmonë duhet ta kemi ndaj gjuhës s'i një prej attributeve më të rëndësishme të një komuniteti.

Në formë anketimi me vetëm një pyetje, kemi përzgjedhur tre persona që japin vlerësimin e tyre për gjuhën. Kemi përzgjedhur një jurist, një gazetar dhe një studiues të gjuhës. Për të tre, kemi ofruar këtë pyetje me të njëjtën përmbajtje: “*Si e vlerësoni rolin e gjuhës?* “

Përgjigjet, janë interesante. Pavarësisht se, pasqyrojnë mënyrën e tërthortë të hulumtimit sepse, nuk do t'u bëjmë ndonjë analizë të detajuar statistikore – metodologjike si pjesë sasiore, përgjigjet përmbajnë ide të vlefshme për këtë punim:

S. Gashi – Zyrtar i administratës (Prishtinë – Ministria e Administratës Publike): Gjuha, përdorimi i saj, është parësorë për kombin që e fletë dhe që e shkruan. Nuk ka shoqëri të denjë, të zhvilluar si duhet dhe të bashkuar pa njohje themelore të gjuhës: në të folur, dhe në të shkruar! Në cdo institucion, ka ardhur koha që do të na duhet të angazhohjmë lektorë të gjuhës.

A.A. – Gazetar (Prishtinë – RTK): Gjuha, është themeli i një populli, paraqet etninë, historinë, kulturën etj. Kam vërejte sepse, ka devijime të mëdha në përdorimin e gjuhës. Edhe në media. Duhet përkushtim më i madh, gjuha duhet mbrojtur me ligj.

Xh.B. – Profesor i Gjuhës (Prishtinë – Universiteti i Prishtinës): Jemi dëshmitarë të ndikimeve të mëdha, ineterfereimeve, stërkeqjeve që gjuha e bukur shqipe, është duke i

përjetuar. Duhet përkushtim e mobilizim që këto sfida të shihen në sy, dhe të shmangen. Gjuha duhet mbrojtur me ligj, ashtu sic veprojnë shtetet e ndryshme të kulturuar, të zhvilluara, të vëmendshme. Gjuhën duhet ta flasim, ta shkruajmë dhe ta mbrojmë të gjithë, pa përjashtim.

KAPITULLI V

DISKUTIME

Në këtë kapitull jepen përmbledhtazi rezultatet e punës tonë kërkimore, duke analizuar secilën hipotezë. Gjithashtu, njëkohësisht prezantohen krahasimet me rezultatet e kërkimeve

të tjera të ngjashme apo me teoritë që u shtjelluan në kapitullin e dytë.

Natyrisht, për rezultatet e arritura jepet edhe një shpjegim për arsyet që çuan në rezultate të tilla.

5.1 Diskutimi i të dhënave mbi hipotezën e parë të studimit tonë

Kjo hipotezë u arrit të vërtetohej me anë të pyetësorëve e plotësuar nga mësimdhënësit dhe nxënësit ku në fokus ishin metodologjitë e përdorura gjatë procesit mësimor në lëndën e Gjuhës Shqipe, kryesisht në shkollat e arsimit të mesëm të ulët në komunën e Gjakovës. Për nxjerrjen e të dhënave u përdor programi SPSS.

Fillimisht u shqyrtuan të dhënat mbi mënyrat e përgjithshme, si gjina, për shembull, apo vendbanimi.

Nga të dhënat konstatohet se shumica e mësimdhënësve të lëndës së Gjuhës Shqipe janë femra. Një fakt ky i vërtetuar edhe nga studime të tjera mbi mësimdhënien. Kështu mund të themi me bindje se tashmë mësuesia është një profesioni ku dominojnë femrat. Në këtë mënyrë nga 67 mësimdhënës të intervistuar, (57%) i përkasin gjinisë femërore, kurse (43%) gjinisë mashkullore. Struktura e dallimit gjinor të mësimdhënësve është e theksuar: në zonat urbane (75.6%) e mësimdhënësve janë femra, kurse (25.4%) janë meshkuj, ndërsa në zonat rurale (80.4%) janë meshkuj, kurse (19.6%) janë femra.

Diferenca në gjini, ka shkaktarë të ndryshëm. Por ajo që është më e përafërt, lidhet me faktin se dallimi gjinorë në zonat rurale, përqindja më e vogël e femrave e pasqyron ambientin, botëkuptimet, por edhe nepotizmin. Por, ka edhe një problem, meshkujt, janë të prirur që të orientohen më shumë në fusha të tjera të shkollimit dhe punësimit, si në biznes, dhe orientimi për t'u larguar nga vendi. Dallimi në zonat urbane ku përkatësia gjinore e femrave është më e avancuar, tregon për thyerjet definitive të botëkuptimeve, dhe emancipimin e vazhdueshëm gjinorë. Por, viteve të fundit, ka një prirje që femrat të orientohen që të punojnë më shumë në sistemin arsimorë dhe të edukimit.

Gjithashtu ishte e nevojshme të analizohej formimi i mësimdhënësve ku vlen të theksohet se një shifër e konsiderueshme (60.5%) janë me fakultet të Gjuhës Shqipe. Edhe ata që nuk e kishin fakultetin, sepse Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe në Gjilan kishte nxjerrë në periudhat e kaluara mjaft mësimdhënës me orientim dyvjeçarë të përgatitjes (niveli bachelor), viteve të fundit në mënyrë të përgjithshme, u janë nënshtruar përgatitjeve dhe dhënies të provimeve shtesë për t'u kualifikuar në arsimin superiorë. Kjo kategori, përfshinte

(16 %) të mësimdhënësve. Nga mësimdhënësit e anketuar,(23.5 %) ishin me Master. Kjo tregon një formim të kënaqshëm.

Trajnimet e mësimdhënësve, gjithashtu, janë një pjesë e rëndësishme që ndikojnë në formimin e mësimdhënësve. Bazuar në studimet tona, shkolla me mësimdhënës më shumë të trajnuar, rezultoi shkolla “YLL MORINA”, ku (70 %) e mësimdhënësve deklarojnë se kanë mbi 3 (tre) trajnime të zhvilluara, ndërsa (30 %) e tyre deklarojnë se kanë 1-3 trajnime të zhvilluara. Kjo tregon që në këtë shkollë mësimdhënësit janë të trajnuar mjaftueshëm.

Nga ana tjetër kemi shkollën “MUSTAFA BAKIJA”, mësimdhënësit të cilët u morën si kampion deklaruan se nuk kanë zhvilluar asnjë trajnim.

Duhet të theksojmë shkolla “Yll Morina” është ndër shkollat më të rëndësishme në komunën e Gjakovës, e pozicionuar në zonë urbane. Kjo nxjerr një konkluzion të rëndësishëm që zonat urbane i kushtojnë më shumë rëndësi formimit të vazhdueshëm.

Mbi të gjitha është me rëndësi të diskutojmë hipotezat e studimit tonë kërkimor.

Fillimisht nisim me hipotezën e parë: H1. Metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies të përdorura në mësimin e Gjuhës shqipe ndikojnë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Bazuar në të dhënat e të dy palëve , mësimdhënësve dhe nxënësve, vihet re se përdorimi i metodologjive nuk është në nivel të kënaqshëm. Vlen të theksohet se mësimdhënësit punojnë shumë, por mbetet akoma shumë punë në arritjen e nivelit optimal.

Kështu, në lidhje me përdorimin e metodës së Brainstomingu-t, kllaseterit apo parashikimit, metoda këto që përdoren në fillim të orës së mësimin, vetem (35 %) e mësimdhënësve u shprehën me pohimin PO, ndërsa (25%) e tyre u shprehën ndonjëherë dhe (10 %) JO. Pjesa e tjetër e përgjigjeve u nda mes Rrallë dhe Nuk e di.

Për sa i përket metodave që përdoren gjatë orës së mësimin,të tilla si: Inserti, Dua të di, leximi i orientuar etj. Një shifër akoma më e vogël e mësimdhënësve (25 %) zgjodhën përgjigjen PO, (30%) e tyre u shprehën JO, (25 %) u shprehën Rrallë, e kështu me radhë.

Metodologji tjera të rëndësishme janë ato metodologji që përdoren në fund të orës së mësimit, thënë ndryshe në etapën e reflektimit, të tilla si: shkrimi i lirë, puna në dyshe, rrjeti i diskutimeve, shqyrtimi kategorizues etj. pjesa më e madhe e mësimitdhënësve (30 %) u shprehën JO, (20 %) e tyre u shprehën RRALLË, pothuajse e njëjta shifër (25 %) u shprehën NDONJËHERË.

Një metodë tjetër e rëndësishme është metoda e kur nxënësit kanë mundësi të marrin vendime. Në lidhje me këto metodologji përgjigjet e mësimitdhënësve tregojnë se është ndër praktikatat më pak të përdorura, kjo pasi vetëm (20 %) e tyre u shprehën PO, dhe është më rëndësi të themi se një shifër relativisht e lartë (40 %) u shprehën JO. Pjesa e tjetër e përgjigjeve ndahet mes përgjigjeve NDONJËHERË, RRALLË, NUK E DI.

Mardhënia ndërvepruese mësues-nxënës, apo nxënës – nxënës, është një tjetër metodë e rëndësishme, që për hirë të së vërtetës rezulton të jetë relativisht mirë nga mësimitdhënësit.

Kështu (40 %) e mësimitdhënësve u shprehën PO, një shifër kjo relativisht e lartë duke marrë dhe parasysht (20 %) që dhanë përgjigjen JO. Ndërsa (25 %) dhanë përgjigjen RRALLË, dhe (15%) NUK E DI.

Mendo, puno në dyshe, thuaja grupit... është metoda tjetër për përdorimin e të cilës u pyetën mësimitdhënësit. Në këtë mënyrë ata dhanë këto përgjigje: pjesa më e madhe (30%) dhanë përgjigjen JO, (30 %) dhanë përgjigjen NDONJËHERË, (25 %) RRALLË). Pjesa tjetër u nda mes përgjigjeve të tjera.

Metoda e pesëvargësh-it është një tjetër metodë që luhetet në pothuajse të njëjtin nivel si metoda e mësipërme. Një shifër e njëjtë mësimitdhënësish (20 %) dhanë përgjigjen PO dhe JO.

Ndërsa *shkrimi i lirë* është një metodë e përdorur mjaft nga mësimitdhënësit. Në këtë mënyrë (35 %) e tyre dhanë përgjigjen PO, (20%) e tyre dhanë përgjigjen NDONJËHERË.

Konstatimi i situatës në lidhje me nivelin e përdorimit të këtyre metodologjive do të ishte i pamundur pa matur edhe këndvështrimin e nxënësve.

Kështu, nxënësit u pyetën ë të njëjtën mënyrë si edhe mësimdhënësit. Më konkretisht atyre iu parashtrua kjo pyetje:

Sa i njihni metodat e mëposhtme në lëndën e Gjuhës shqipe në shkollën tuaj?

- Brainstormingu, kllasteri, parashikimi me terma paraprake, tryeza rrethore etj.
- Inserti, di/dua të di/ të mësoj, leximi i orientuar, mësimdhënia reciproke, të nxënit në bashkëpunim etj.
- Puna në dyshe, rrjeti i diskutimeve, shqyrtimi kategorizues etj.
- Dhënia e mundësisë nxënësve për të marrë vendime
- Marrëdhënia ndërvepruese
- Pesëvargëshi
- Shkrimi i lirë/ese

Rezultate nga të dhënat e nxënësve, nga ana tjetër, dhanë rezultate pothuase të barabarta.

Edhe pse duhet të theksojmë se në lidhje me përdorimin e disa metodologjive pati ndryshime të lehta, sërisht konkludojmë se studimi ynë nxori një konstatim real të situatës.

I njëjti konkluzion vlen edhe për përdorimin e mjeteve mësimore, të cilët sigurisht përbëjnë shtyllën apo bazën për aplikimin e metodologjive. Pasur parasysh këtë rol, u pa me rëndësi studimi i tyre. Në këtë mënyrë mësimdhënësit dhe nxënësit u pyetën për frekuencën e përdorimit të tyre në orën e mësimit të Gjuhës shqipe në shkollat e komunës së Gjakovës. Referuar të dhënave të pasqyrura në figurat përkatëse, rezultohet në këtë mënyrë:

mjetet dydimensionale, kanë këto përgjigje: (25%) e mësimdhënësve dhanë përgjigjen PO, dhe po e njëjta shifër dhanë përgjigjen NDONJEHERË. Në shifra të barabarta qëndrojnë përgjigjet e tjera, RRALLË, NDONJËHERË dhe (10%) përgjigja NUK E DI.

Për *mjetet tridimensionale* përgjigjet janë në nivele më të ulëta. (15%) e tyre u shprehën PO, (20%) u shprehën JO. Ndërsa pjesa më e madhe (35%) e mësimdhënësve u shprehën RRALLË. Kjo tregon se këto mjete përdoren shumë pak, pothuajse asnjëherë.

Mjetet audiovizive kanë një nivel përdorimi më të lartë. Pjesa më e madhe e mësimit (35 %) shprehen PO, dhe (15 %) e tyre shprehen ndonjëherë. Edhe pse këto shifra janë pak poshtë mesatares, në krahasim me mjetet e tjera ka një nivel më të lartë përdorimi. Pjesa tjetër e përqindjes ndahet mes përgjigjeve negative.

Mjetet e komunikimit masiv, të dhënat rezultuan kështu: (30 %) u shprehën PO, (20%) u shprehën NDONJËHERË. Ndërsa pjesa tjetër ishin tek përgjigjet negative, përgjigja jo (10%), RALLË (20 %) dhe përgjigja NUK E DI (20 %).

Mësimit, gjithashtu, u pyetën mbi mjetet ndihmëse-teknike mësimore dhe orënditë shkollore, mjete këto bazë për zhvillimin e një procesi normal mësimor, që fatmirësisht është në nivel të kënaqshëm.

(50%) e mësimit deklaruan PO, që këto mjete ofrohen në shkollën e tyre. (20%) u shprehën JO, (25 %) NUK E DI dhe (15 %) RRALLË.

Rezultatet e nxënësve treguan kështu:

mjetet dydimensionale kanë shumë pak përdorim në shkollat e komunës së Gjakovës. (15%) e nxënësve u shprehën PO. (20 %) u shprehën JO, (20%) u shprehën RRALLË dhe po e njëjta shifër u shpreh NUK E DI. Ndërsa pjesa më e madhe e tyre (35%) e tyre u shprehën NDONJËHERË.

Një situatë akoma më e keqe është edhe për *mjetet tridimensionale*. Vetëm (5%) e nxënësve zgjodhën alternativën PO. Ndërsa pjesa më e madhe e tyre (35%) zgjodhën përgjigjen NDONJËHERË. Pothuajse e njëjta shifër (30%) dhanë përgjigjen JO. Pjesa tjetër ishin mes përgjigjes RRALLË dhe NUK E DI.

Mjetet audiovizive janë një lloj tjetër mjeteve që kanë një rol të rëndësishëm në procesin mësimor. Në lidhje me këtë të dhënat nga nxënësit rezultuan kështu: (15 %) e tyre u shprehën PO, (30 %) u shprehën JO, (35%) u shprehën RRALLË, (20 %) NDONJËHERË dhe (10%) zgjodhën përgjigjen NUK E DI.

Në lidhje me *mjetet e komunikimit masiv*, situatë është më pozitive. Nxënësit janë të ndarë mes përgjigjes PO (30%) dhe JO (30 %). Një pjesë e konsiderueshme e nxënësve (20%) dhanë përgjigjen NDONJËHERË dhe vetëm (10%) dhanë përgjigjen NUK E DI.

Për sa i përket mjeteve bazë të mësimdhënies (Mjetet ndihmëse-teknike mësimore dhe orenditë shkollore), të dhënat e nxënësve, po ashtu si edhe të mësuesve, tregojnë një situatë të kënaqshme. (40 %) e tyre shprehen PO dhe një shifër e konsiderueshme (30%) u shprehën NDONJËHERË. Pjesa tjetër e nxënësve zgjedhën përgjigjet JO (20 %) dhe RRALLË (10 %).

Rezultatet e nxënësve ishin pak kontadiktore me atë të mësimdhënësve, kjo tregon faktin që mësimdhënësit mbase hera herës mundohen të pasqyrojnë shkollën e tyre në formën më të mirë të mundshme.

-Një tjetër aspekt i rëndësishëm i metodologjive bashkëhore është puna në grupe.

Në lidhje me punën në grup, është e rëndësishme të përmendim faktin se pjesa më e madhe e mësimdhënësve (80 %) deklaruan *PO*, ndërsa numri i nxënësve që dha këtë përgjigje ishte në shifra më të vogla (60 %).

Dallim më të theksuar mes mësimdhënësve dhe nxënësve ka në lidhje e punën praktike. Kështu (70 %) e mësimdhënësve deklaruan *PO*, dhe vetëm (30%) e nxënësve deklaruan këtë përgjigje.

Këto dy metoda janë ndërm metodat përfaqësuese të metodologjive të avancuar të mësimdhënies, referuar kështu Rama (2013). Rezultatet nga pyetësorët e të dy palëve treguan që niveli i përdorimit të tyre nuk është i kënaqshëm, cka do të thotë që duhet më shumë punë në implementimin e këtyre metodologjive.

5.2. Diskutimi i të dhënave mbi hipotezën e dytë të studimit

Në lidhje me këtë hipotezë kryesisht u pyetën mësimdhënësit. Ata u pyetën në këyë mënyrë:

“Si e vlerësoni aplikimin e metodologjive në procesin e mësimdhënies?”

Mësimdhënësit e konsiderojnë të rëndësishme aplikimin e metodologjive, si një mundësi reale në rritjen e efikasitetit mësimorë dhe në ndjekjen e hapit kundrejt aplikimit të standardeve. Prej tyre (74.5%) i janë përgjigjur pozitivisht aplikimit të sa më shumë metodologjive, për shkak të rolit dhe rëndësisë që kanë ato në procesin e mësimdhënies. Ndërsa, (25.5%) janë të mendimit se është më mirë që të bëhet një kombinim i mësimdhënies tradicionale, me mësimdhënien moderne – bashkëkohore.

Mësimdhënësit, e pranojnë faktin se duhen aplikuar më shumë metodologji nga mësimdhënia praktike dhe e përvojës, në mënyrë që aspekti teorik i mësimin, të lidhet sa më shumë që të jetë e mundur me, aspektin praktikë.

Më konkretisht ata u pyetën se si e vlerësojnë aplikimin e metodologjive në procesin e mësimdhënies.

Më tutje, pyetjet vazhdojnë më specifikisht mbi metodologjitë e mësimdhënies.

Arsimtarët u pyetën më konkretisht:

“ A përdoren mjaft metodologji në mësimdhënien e lëndës së Gjuhës shqipe, krahasuar me lëndët e tjera ? “

Në këtë pyetje, (80.7%) e mësimdhënësve, besojnë se aplikohen metodologji të mjaftueshme, mirëpo , ata pajtohen që duhet të gjenden vazhdimisht metodologji të reja për t’u aplikuar në proces. Shumica e mësimdhënësve, mendojnë se lënda e Gjuhës shqipe nuk zgjon interesim të duhur te nxënësit, jo për shkak të mungesës së metodologjive, por për shkak të faktorëve të tjerë. Një pjesë tjetër, (19.3%) besojnë se aplikimi i më shumë metodologjive është i rëndësishëm për shkak të rolit dhe të rëndësisë që ka lënda e Gjuhës shqipe.

Sa janë motivuese, cilësore dhe në përputhje me kriteret e mësimdhënies bashkëkohore, metodologjitë e mësimdhënies që përdoren në lëndën e Gjuhës shqipe ?

Nga numri i të anketuarve të mësimdhënësve, (90%) e tyre, konstatojnë se metodologjitë janë në përputhje me planprogramin e kësaj lënde. Kurse, (10%) e tyre, mendojnë se metodologjitë, nuk e plotësojnë “diferencën” që shkaktohet nga mos interesimi i duhur i nxënësve për këtë lëndë. Mësimdhënësit që me gjasë kanë më shumë përvojë mësimore, (17

%) e tyre, besojnë se pavarësisht se metodologjitë janë në përputhje me lëndën, mungon motivimi dhe shtytja për ta konsideruar nga të gjithë faktorët shkollorë dhe më gjerë lëndën e gjuhës, si të rëndësishme në procesin e edukimit dhe arismimit. Këta mësimdhënës, shtyten nga rrethanat e kaluara ose nga koha kur kjo lëndë, ka pasur prioritet.

Në përgjithësi, metodologjitë konsiderohen si strategjike në relacion me synimet për rezultate pozitive.

Prandaj u pa e nevojshme që si mësimdhënësit ashtu dhe nxënësit të pyeteshi mbi format e vlerësimit që përdoren në lëndën e Gjuhës Shqipe.

Në këtë mënyrë ata u pyetën mbi frekuencën e përdorimit të këtyre metodave vlerësuese:

Testimi:

- *Test me përgjigje alternative*
- *Test me përgjigje të shkurtëra dhe me plotësim*
- *Test me përgjigje të zgjeruar*
- *Puna me shkrim (esetë)*

Vrojtimi me anë të:

- *Katalogut të pjesëmarrjes së nxënësit në grup*
- *Listës së kontrollit*
- *Shkallës vlerësuese*
- *Dosjes së nxënësit*

Ndërsa si përgjigje ofrohen alternativat:

Gjithmonë Zakonisht Ndonjëherë Asnjëherë Nuk e di

Referua rezultatetve, vihet re se mësimdhënësit përdorin mjaftueshëm forma vlerësimi. Ndër format më të përdorura të testimit rezulton të jetë testimi me përgjigje të shkurtëra. Ndërsa ndër format më pak të përdorura rezultoi ajo me përgjigje të zgjeruarara.

Për sa i përket formave të vrojtimit, ndër format më të përdorura rezultoi lista e kontrollit dhe katalogu i pjesëmarrjes.

-Në të njëjtën mënyrë u pyetën edhe nxënësit. Rezultatet te cilëve treguan ngjashmëri të theksuar me mesimdhënësit, çka tregon një konstatim real të situatës.

-Studimi vazhdon me pyetje specifike mbi metodologjitë efikase të mesimdhënies. Një ndër metodologjitë efikase është mesimdhënia me në qendër nxënësin. Kështu mesimdhënësit u pyetën se kush duhet të jetë në qendër: mësuesi apo nxënësi ? A kërkohet që mësuesit të jenë më tolerant, apo më rigoroz përgjatë mbarëvajtjes së procesit mësimor?

Mësimdhënësit, në këtë pyetje përgjigjen kështu: (69 %) gjashtëmbëdhjetë mesimdhënës u përgjigjen në favor të asaj që nxënësi, duhet të jetë në qendër, kurse (31%) shtatë prej tyre u përgjigjen se mësuesi, duhet të jetë në qendër të klasës. Ndoshta ky gjykim, e konstaton edhe këtë dallim: (30 %) e mesimdhënësve, konsiderojnë se toleranca e tepruar në shkollë me nxënësit, ndikon negativisht dhe ata janë për masa më rigorozë disiplinore, kurse (70 %) shprehen në favor të tolerancës dhe demokratizimit të shkollës.

Gjykimi ynë është se, mesimdhënësit në këtë pyetje aprovojnë në favor të tyre idenë tradicionale që mësuesi të jetë në qendër. Diferenca në përgjigje të këtillë në favor të rigorozitetit, pra aplikim më pak i tolerancës, gjykojmë që shkaktohet nga mungesa e vërejtshme e disiplinës që shfaqet në shkolla. Nxënësit, janë të prirur më shumë që të flasin gjatë orës së mësimit, të jenë më pak të koncentruar etj.

” A është në përputhje me procesin bashkëkohor të zhvillimit shkalla e vlerësimit të nxënësit ? “

Lidhur me këtë metodë, (73 %) e mesimdhënësve preferojnë formën e notimit sipas sistemit të përcjelljes së vazhdueshme të nxënësit gjatë vijueshmërisë së mësimit. Notimi, bëhet në etapa në një fletore të posaqme, dhe jo si në të kaluarën në ditar. Nxënësi, notohet 3 herë përgjatë një gjysme të vitit. Mënyra e përcjelljes së aktivitetit të vazhdueshëm të nxënësit dhe në këtë mënyrë vlerësimi i tij, në secilën shkollë e ka tejkaluar vlerësimin tradicional. Ky sistem i vlerësimit, konsiderohet si bashkëkohor. Ndërsa , vetëm (27 %) e mesimdhënësve,

mendojnë që forma e vlerësimit aktual, nuk është deri në fund dëshmuese për sukses të sigurtë të nxënësit.

5.3 Diskutimi mbi të dhënat në funksion të vërtetimit të hipotezës së tretë

Si një mënyrë e tërthortë për të gjetur faktorët që shkaktojnë vështirësi në aplikimin e metodologjive, mësimdhënësit u pyetën mbi praktikën motivuese. Duke iu refuzuar çfarë u tha më lart në kapitullin teorik mbi mosinteresimin e nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe, na vjen natyrisht edhe pyetja: “ **A tregojnë nxënësit interes në lëndën e Gjuhës Shqipe?** “

Në pyetjen e këtillë është e rëndësishme edhe për faktin se në lëndën e Gjuhës shqipe në Kosovë kanë filluar të vërehen dobësi të theksuara tek ata që e mbarojnë shkollimin parauniversitar.

65 mësimdhënës apo (87%) e tyre janë treguar të sigurtë dhe nuk e fshehin faktin se në përgjithësi, një pjesë e nxënësve diktojnë mos interesim jo të bollshëm në mësim, kjo na bën të kuptojmë se në klasë nuk përdoren mjaftueshëm praktika motivuese. Vetëm një pjesë e pa konsiderueshme e mësimdhënësve, 10 ose (13 %) e tyre përgjigjen pozitivisht në këtë pyetje.

Më tej, në përpjekje për të gjetur përgjigje konkrete për pyetjen e tretë kërkimore mbi vështirësitë në aplikimin e metodologjive efektive në procesin mësimor, mësimdhënësit pyeten në mënyrë të tërthortë. Kështu , atyre iu parashtrua kjo pyetje?

-Cilët janë faktorët që shkaktojnë pengesa, probleme dhe interferime negative në procesin e mësimin?

Bazuar në të dhënat e nxjerra sipas mësimdhënësve, faktorët kryesorë që shkaktojnë mos-interesimit për mësim kontinuitiv të nxënësve, rezultojnë këta:

- (15%) e tyre mendojnë se ndikimet e ambientit të jashtëm ose humbja e kohës nga daljet e vazhdueshme në rrethet urbane
- (35.%) mendojnë për ndikimet negative të teknologjisë

- Pjesa më e madhe mësimitdhënësve (45 %) mendojnë se mbingarkesa e mësimitdhënësit sjell një aplikim jo efikas të metodologjive të mësimitdhënës
- Një përqindje e vogël e mësimitdhënësve (5 %) mendojnë se një faktor pengues në motivimin e nxënësve është humbja e besimit dhe ndikimet e nepotizimit në sferën e mundësisë së punësimit pas shkollimit ,synimet për t’u larguar nga vendi.

Kështu, (60 %) mësimitdhënës listojnë një numër të theksuar faktorësh që e zbehin interesimin e nxënësve në mësim. Kurse ,(20 %) e mësimitdhënësve besojnë që nxënësit janë mjaftueshëm të interesuar në procesin mësimorë, dhe se faktorët relevantë, dytësorë nuk ndikojnë në procesin mësimorë. Vlen të përmendet se (10 %) e tyre nuk dhanë përgjigje.

5.4. Diskutim mbi të dhënat e intervistave me drejtues shkollash

Një evidencë tjetër e rëndësishme e përdorur në funksion të vërtetimit të hipotezave tona është rezultati i arritur nga intervistat me mësimitdhënësit.

Këto intervista u bënë me qëllim identifikimin e disa mendimeve dhe përgjegjësive të gjatë procesit mësimor të tyre. Atyre iu drejtuan 8 (tetë) pyetje. Ata u pyetën, pikë së pari rreth rreth kushteve në shkollë, dhe për këtë shumica prej tyre e pranuan se shkollat e tyre nuk ishin në kushtet optimale të mësimitdhënies. Të tjerë, edhe pse të paktë në numër, nuk e mohojnë faktin që shkollat e tyre kanë kushte të mira por sigurisht mbeten akoma disa aspekte për tu përmisuar.

Në lidhje me pyetjen e dytë : “ Si e vlerësoni mësimitdhënien e lëndës së Gjuhës shqipe në shkollën tuaj? “, drejtuesit përgjithësisht shprehën pozitivë por edhe ata vetë e pranojnë se duhet më shumë punë në aplikimin e metodologjive bashkëkohore moderne.

Ndërsa për sa i përket pyetjes së tretë: “*Sipas jush, çfarë metodologjish përdoren në procesin e mësimitdhënies të lëndës së Gjuhës shqipe në shkollën tuaj?*”

Drejtuesit pranojnë që mësimdhënësit punojnë metodologji të ndryshme. Ndër metodologjitë që përdoren më së shumti rezultuan përsëritja, marrja së shembujve adekuat, detyra e shtëpisë etj. Ndër të tjera drejtuesit shprehen se mësimdhënësit përpiqen që lëndën ta bëjnë sa më tërheqëse, duke i kushtuar rëndësi të madhe aktivitetit motivues, shpjegimor, përsëritjes etj. Ata janë të gatshëm gjithmonë për lëndën dhe në shërbim të nxënësit, dhe kryesisht i zbatojnë metodologjitë, por sigurisht mbetet shumë për t'u bërë në arritjen e një procesi mësimor sa më efikas. Vlen të theksohet se disa nga drejtuesit refuzuan të përgjigjen, me arsyetimin e kam vështirë t'i përgjigjem kësaj pyetje.

Pyetja e katërt lidhet drejt për drejt me hipotezën kryesore të studimit tonë, mbi nivelin e aplikimit të teknologjive adekuate. Kështu bata u pyetën: “ *Sipas jush, cili është niveli i përdorimit të metodologjive adekuate të mëimit të Gjuhës shqipe?*”

Shumica e drejtuesve shprehen se përdoren metodologji por që nuk janë mjaftueshëm për një orë ideale mësimore.

Mbi pyetjen e pestë : ***“Pse ka rënie të interesimit të nxënësve për lëndën e gjuhës shqipe ?”, shumica e drejtuesve shprehen :***

- *Nxënësve u duhet shpjeguar rëndësia e lëndës*
- *Nuk janë të motivuar mjaftueshëm*
- *Ndikimet globale të gjuhës*
- *Faktorë ekonomik social*
- *Mungese metodologjish motivuese*

Për sa i përket pyetjes së gjashtë: ” ***Në cilat fusha shihni dobësi evidente në procesin mësimorë, dhe si do t'i tejkaloni ju këto dobësi ?***”, listojmë këto përfundime:

- nuk i kushtojnë rëndësi përgatitjes psikologjike dhe motivimit të nxënësit ndaj lëndës.
- nuk aplikojmë mjaftueshëm metodologji
- substancave narkotike
- teknologjia

- Një pyetje tjetër me rëndësi është : “*A besoni që aplikimi i më shumë metodologjive, do ta nrriste përkushtimin e mësuesve, po edhe të nxënësve në relacion me këtë lëndë?*”.

Shumica e drejtuesve u shprehën me përgjigje pozitive.

Bazuar në të dhënat e detajuara më sipër, nga pyetësorët me drejtuesit e shkollave, themi që këto rezultate shërbyen plotësisht në vërtetimin e hipotezave të studimit tonë.

KAPITULLI VI

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

6.1 Konkluzione

Gjuha shqipe, nuk është shkruar për shumë kohë me alfabetin e saj burimor, por është shkruar me alfabete të ndryshme. Mirëpo, ka qenë e folura shqipe ajo që i ka ruajtur dhe i ka përhapur substancat e identitetit, të kulturës, etnologjisë, letërsisë etj. Përmes së folurës arkaike shqipe, janë bartur brez pas brezi stimujt gjuhësorë, traditat e ndryshme, zakonet, elemntet kulturo-letrare etj.

Konstatohet se njohja e historisë së gjuhës nga gjeneratat që vijnë janë në dobi të secilit nxënës dhe kjo ndikon në trajtimin më konsekuent të lëndës së Gjuhës shqipe. Në këtë drejtim, vështrimi historik i gjuhës dhe i shkollës shqipe, na bën të kuptojmë se metodologjitë e mësimdhënies kanë qenë të ndryshme, varësisht prej shtrirjeve administrative-shtetërore për shkak se populli ynë ka jetuar dhe ende jeton në disa shtete. Ruajtja e substancës së

gjuhës njësoj ka konsistuar edhe me ruajtjen e substancës kombëtare. Ekuivalent me rolin e përgjithshëm që ka gjuha shqipe, ajo ka mbetur një korpus i gjerë interesimi dhe studimi jo vetëm në planin e brendshëm, por edhe në atë ndërkombëtar. Konstatojmë se falë këmbënguljes dhe përvojës së studiuesve dhe pedagogëve të shkollës shqipe, dhe në veçanti të lëndës së Gjuhës shqipe, ne kemi trashëguar një bagazh të pasur historiografik, bibliografik, leksikologjik, gramatikore etj.

Konstatojmë se unifikimi i gjuhës shqipe, ishte një detyrim arsimor dhe kombëtar për ta ndërtuar standardin e gjuhës unike, meqë shqipja përbëhet nga dy dialekte: nga dialekti toskë, dhe nga dialekti gegë. Sado që dialektet janë pasuri gjuhësore, sidomos për shkak të ndarjeve politike dhe administrativo-shtetërore, Kongresi i Drejtëshkrimit (1972), ishte një prej organizimeve me karakter kombëtar që gjeti përkrahje të gjerë kombëtare: në Shqipëri, Kosovë etj.

Konstatime mbi hipotezat e studimit bazuar në analizën e të dhënave.

Referuar të dhënave të mësipërme, nxjerrim konstatime mbi hipotezat tona.

Hipoteza e parë e studimit tonë është:

Hipotezat : H1. Metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies të përdorura në mësimin e Gjuhës Shqipe ndikojnë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

